REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:233145
Datë: 05.01.2021
Numri i dokumentit: 01387792

PKR.nr.204/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATAs THEMELOE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Sahit Krasniqi, kryetar i trupit gjykues, gjyqtarët profesionist Ibrahim Idrizi dhe Imri Sejda, anëtarë të trupit gjykues, zyrtaren ligjore Lavdije Brahimi Aliu, në çështjen penale kundër të akuzuarve: F. G. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, I. R. dhe A. K. për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 për.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të rënda, PP.I.nr.142/2017 të dt. 28.12.2017 pas përfundimeve të shqyrtimeve gjyqësore publike, më 05.11.2020 shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërkaq me datën 05.01.2021 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

Të akuzuarit:

1. F. G., i lindur me dt..... në fsh, ..., nga i ati .... dhe e ëma ...., me vendbanim në rr. "....." në Ferizaj, me profesion jurist i dip. ka punuar si Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit në komunën e Ferizajt, i martuar, babë i dy fëmijëve, me gjendje të mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës

2.A. K., i lindur me dt..... në ....., nga i ati .... dhe e ëma ....., me vendbanim në Rr. "....." në Ferizaj, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, i pa punë, i martuar, babë i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i R. Kosovës,

2019:233146

I.

I akuzuari, F. G.

Në bazë të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK ,

LIROHET NGA AKUZA

Se me datë 09.08.2017, në Ferizaj, i pandehuri, në cilësinë e personit zyrtar Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit të komunës Ferizaj, dhe si person përgjegjës i komisionit për shqyrtimin e planit Zhvillimor Komunal për rrugën "Astrit Bytyqi", në Ferizaj, ka tejkaluar kompetencat e tij zyrtare duke i'a shkelur seriozisht të drejtat e personave tjerë të dëmtuarve: I. H., B. H. dhe O. B., në atë mënyrë nuk i kane verifikuar nënshkrimet në peticionin e qytetareve të cilët kanë rezultuar të jenë të falsifikuar edhe pse i pandehuri më pare ka qenë në dijeni se nënshkrimet në peticione janë të falsifikuara dhe si pasoj është lejuar që Rr. "Astrit Bytyqi" të mbetet banim kolektiv, edhe pse qytetarët e kësaj rruge kanë qene për banim individual, ndërsa si rezultat i peticionit të falsifikuar kuvendi komunal ka aprovuar planin urbanistik .

- **Meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.**

II.

Ndaj të akuzuarit A. K., ,

Në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPRK-së

REFUZOHET AKUZA

Se në muajin Prill –Maj të vitit 2017, në Ferizaj, ka përpiluar dokument të falsifikuar me qellim të shfrytëzimit të tij si origjinal, në atë mënyrë qe ka mbledhur nënshkrime nga banoret e lagjeve tjera me qellim qe te njëjtat nënshkrime në peticion ti përdorin si origjinal kinse banoret e zonës se 8 Rr. "Astrit Bytyqi" në Ferizaj, kanë dhënë pëlqimin që kjo zone të mbetet banim kolektiv, edhe pse banoret e kësaj lagje kanë qene për banim individual .

- **Me çka kishte për të kryer veprën penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.1 te KPRK-së.**

Për arsye se prokurori i shtetit, gjatë shqyrtimit gjyqësor, në fjalën përfundimtare ka heq dorë nga aktakuza.

2019:233146

III.

Ndaj të akuzuarit I. R., konform nenit 160 të KPPK-së gjykata me aktvendim ka pushuar procedurën penale, për shkak të vdekjes së tij,

Të dëmtuarit: I. H., B. H. dhe O. B. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil,

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve.

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti për krime të rënda, me aktakuzën PP.I.nr.142/2017 të dt. 28.12.2017 ka ngarkuar të akuzuarin F. G. nga Ferizaj për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, ndërsa të akuzuarit I. R. dhe A. K., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së.

Gjykata themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datën 23.02.2018 në të cilin shqyrtim të akuzuarit u deklaruan të pafajshëm, kurse gjykata me aktvendimin e datës 12.06.2018, ka refuzuar kundërshtimin ndaj provave të caktuara në aktakuzë, përkatësisht Kërkesat për hudhjen e aktakuzës të paraqitura nga mbrojtësi i autorizuar i të akuzuarit F. G. dhe nga të akuzuarit I. R. dhe A. K.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, ka mbajtur shqyrtimet gjyqësore publike dhe prokurori i shtetit Burim Qerkini në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në fjalët përfundimtare të palëve të dhëna me dt. 03.11.2020 ka deklaruar se për te akuzuarin **F.G.** mbetet në tërësi pranë aktakuzës së ngritur dhe kualifikimit juridik të veprës penale, ku pas administrimit të provave ne shqyrtimet gjyqësore është vërtetuar në mënyrë te padyshimtë se në veprimet e te akuzuarit F. G. janë prezentë elementet e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 te KPRK-se.

2019:233146

Ka deklaruar se gjendja faktike si ne dispozitiv te kësaj aktakuze është vërtetuar nga provat materiale qe kane qene pjesë e kësaj çështje penale e qe janë administruar ne shqyrtim gjyqësor, nga dëgjimi i shume dëshmitarëve, nga dëshmitë e të dëmtuarve pjesërisht nga mbrojtja e te akuzuarit si dhe nga faktet e pakontestueshme qe janë nxjerr gjate këtij shqyrtimi gjyqësor, ka propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të i shqiptohet një sanksion penal i paraparë me ligj.

Për te akuzuarin **A. K.** për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 te KPRK-se, ka deklaruar se nga provat e administruara ne këtë shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar se veprimet e tij bien ndesh me dispozitën e nenit 398 të KPRK-së, përkatësisht nuk është vërtetuar se veprimet e tij përbejnë elementet e veprës penale për të cilën e ngarkon aktakuza dhe në mungesë të provave fajësuese, ne kuptim te nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së për të akuzuarin A. K. është tërhequr nga ndjekja penale.

Për tani të ndjerin **I. R.** ka propozuar që të pushoj procedura penale ne kuptim të nenit 160 te KPPK-se.

I **dëmtuari I. H. dhe përfaqësuesi i tij, avokati Kushtrim Palushi, fjalën përfundimtare** trupit gjykues ia kanë paraqitur në formë të shkruar, në të cilën në detaje kanë paraqitur pretendimet e tyre, për parregullsitë procedurale që janë shkaktuar gjatë aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal nga ana e Kuvendit komunal, për periudhën 2017-2025, duke pretenduar se përgjegjës kryesor për këto parregullsi është ish. Drejtori i drejtorisë së Urbanizmit F. G., për të cilin kanë propozuar që të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënimi i paraparë me ligj për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Në kuptim të nenit 465 të KPPK-së në emër të Kërkesës pasurore juridike kanë kërkuar kthimin e gjendjes së mëparshme dhe ate:

- Anulimin e vendimit të MMPH-së për dhënien e pëlqimit për miratim të Planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 i Komunës së Ferizajt, nr.4329-2/17, të date 04/09/2017;
- Anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës në Ferizaj, 01.Nr.147, të datës 25/09/2017, për miratimin e PZHK 2017-2025 të Komunës Ferizaj;
- Anulimin e vendimit MMPH nr.4789-2/17, të datës 06/10/2017;

2019:233146

- Anulimin e të gjitha lejeve ndërtimore, të lëshuara mbështetur në PZHK 2017-2025, lidhur me ndërtimet e larta në parcelën 2939-0;
- Rrënimin e objekteve të ndërtuara bazuar në këto leje ndërtimore;
- Kompensimin e shpenzimeve procedurale në vlerë simbolike totale prej 10,000.oo€ (dhjetëmijë euro).

Në alternativë, në rast dështimi për të anuluar në tërësi të gjitha aktet administrative të specifikuara më lartë, si dhe për të ndalur punimet ndërtimore në parcelën 2939-0, si pasoja që rrjedhin nga aktet e mësipërme juridike, atëherë parashtrojmë kërkesë për kompensim të dëmit material dhe jo material, në lartësi të cilën do ta precizojmë në kontest civil.

I dëmtuari B. H., në fjalën përfundimtare të cilën e ka paraqitur në formë të shkruar, ndër të tjera ka deklaruar se duke u mbështetur në provat dhe dëshmitë e administruara gjatë seancave gjyqësore, është vërtetuar se i akuzuari F. G. ka kryer veprën penale e cila I përshkruhet në aktakuzë, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqipton dënimin e paraparë me ligj. Sa i përket kërkesës pasurore juridike ka deklaruar se të njëjtën e kanë parashtruar bashkërisht përmes fjalës përfundimtare të dorëzuar nga vëllai i tij I. H. dhe tani në veçanti rithekson kërkesën e patjetërsueshme që gjendja në rrugën "Astrit Bytyqi"-Zona 8-të të kthehet siç ishte para date 09.08.2017

I dëmtuari O. B., fjalën përfundimtare trupit gjykues ia ka paraqitur në formë të shkruar, në të cilën përveç tjerash ka deklaruar se pas përfundimit të të gjitha seancave të shqyrtimeve gjyqësore, pas dëgjimit të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe provave materiale është vërtetuar se i akuzuari F. G. e ka kryer veprën penale të përshkruar në aktakuzë, ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënimi i paraparë me lig. Në emër të kërkesës pasurore juridike, si pasojë e veprës penale ka propozuar gjykatës që ta kthej gjendjen e mëparshme para dt. 09.08.2017.

Mbrojtësi i autorizuar i të akuzuarit F. G., av. Visar Musa, në fjalën përfundimtare të cilën trupit gjykues ia ka paraqitur në formë të shkruar, ndër të tjera ka deklaruar se gjatë shqyrtimeve gjyqësore, pas dëgjimit të dëshmitarëve, administrimit të provave materiale, shikimi të CD-së në të cilën është incizuar mbledhja e Kuvendit Komunal e mbajtur me dt. 21.09.2017, në të cilën mbledhje është aprovuar Plani Zhvillimor Komunal për periudhën kohore 2017-2025 dhe pas dëgjimit të akuzuarit F. G., nuk është vërtetuar me asnjë provë të

2019:233146

vetme se i akuzuari F. G. është përgjegjës për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzën e prokurorisë, andaj i propozon gjykatës që të njëjtin ta liron nga akuza në mungesë të provave.

I akuzuari F. G., në fjalën përfundimtare të cilën trupit gjykues ia ka paraqitur në formë të shkruar ka deklaruar se e përkrahë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, av. Visar Musa dhe shton si në vijim:

Procedurat për aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal duke përfshirë edhe vendimet e Kuvendit, i janë nënshtruar kontrollit nga ana e organit të shkallës së dytë, që në rastin konkret është Ministria e Administrimit të pushtetit lokal dhe Ministria e planifikimet hapësinor.

Tërheqja e prokurorit nga aktakuza për të akuzuarin A. K. për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve e rrëzon përfundimisht konstruktin edhe ashtu të pa konstrukt të aktakuzës ndaj meje, sepse absolutisht asnjë dëshmitar nuk më ka implikuar në mbledhjen e as dorëzimin e peticioneve e as për ndonjë veprim tjetër lidhur me këto peticione, që ishin bërë shkas për ngritjen e aktakuzës.

Është argumentuar dhe vërtetuar se në bazë të vendimit të kryetarit të Komunës nr.97/16 kam qenë anëtar e jo përgjegjës i Komitetit drejtues në të cilin organ përveç meje kanë marr pjesë: Kryetari, Nënkryetari i Komunës, Kryesuesi dhe të gjithë Drejtorët e Drejtorive, andaj tendenca e Prokurorisë që mua të më ngarkoj me përgjegjësinë individuale për tërë Planin Zhvillimor Komunal, është një meritë tepër e madhe që as unë e asnjë individ tjetër nuk mund ta mbaj mbi supet e veta.

Plani Zhvillimor Komunal është rezultat i punës së grupeve tematike të të gjitha Drejtorive, shumë faktorëve jashtë Komunës dhe Ministrisë, pa pëlqimin e së cilës nuk e kemi bërë asnjë hap, andaj janë absurde konstatimet se unë paskam arritur ti manipuloj: Komisionet, Komitetin për politikë dhe financa, Kuvendin dhe Ministritë dhe për të ardhur deri te një konstatim i tillë së paku duhet të ekziston ndonjë pohim nga ndonjëri prej organeve të lartpërmendura.

Nuk qëndron konstatimi se PZHK-ja është hartuar me procedura të shpejtuara, se këto procedura kanë zgjatur njëzet e një (21) muaj.

Në fund konstatoj se PZHK, është vepër e Kuvendit Komunal, i propozuar dhe i përgatitur nga të gjitha Drejtoritë e Komunës dhe si i tillë mbetet dokumenti më i mirë dhe më i kompletuar që ka pasur ndonjëherë komuna e Ferizajt.

<u>Mbrojtja e të akuzuarit</u>.

I akuzuari F. G. në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza. Në mbrojtjen e tij në mënyrë kronologjike ka shpjeguar në detaje procedurat e miratimit të Planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 duke theksuar: se deri në dhjetor të vitit 2017 ka qenë drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit në K. Ferizaj. Me Ligjin mbi pushtetin lokal drejtorët e drejtorive janë de fakto këshilltar te Kryetarit te Kuvendit Komunal. Drejtoret janë të obliguar që të i zbatojnë politikat qe i përcakton Kryetari i Komunës, ne rastin konkret jam marre me menaxhimin e Drejtorisë së Urbanizmit duke respektuar Ligjin mbi planifikimin hapësinor dhe udhëzimet administrative qe janë bazë për funksionimin e Drejtorisë së Urbanizmit. Natyrisht ne jemi marre me menaxhimin e dokumentit qe quhet Plani Zhvillimor Komunal (PZHK),i cili është hartuar ne baze te vendimit te Kuvendit Komunal. Ne i kemi përgatitur këto dokumente ne forme te propozimit për arsye se Ligji mbi planifikimin hapësinor dhe Ligji mbi administrimin e pushtetit lokal në mënyrë decitive Kuvendin e përcakton si organin i cili i aprovon apo miraton Planin Urbanistik. Gjatë hartimit te këtij plani urbanistik ne bazë të vendimit të Kryetarit te Komunës 0197/16 i dt. 15.03.2016 unë kam qenë anëtar në Komitetin drejtues së bashku me të gjithë drejtorët e drejtorive të tjera, me kryetarin e komunës dhe nënkryetarin e komunës, d.t.th. kemi qeni 12 drejtor dhe kryetari e nënkryetari, që gjithsejtë bëjnë 14. Me Ligjin për planifikimin hapësinor secila komunë është e obliguar qe ta ketë Planin Zhvillimor Komunal, meqë komuna Ferizajt e kishte nje plan zhvillimor te vitit 2008 ose 2009 që kishte afat 5 vjeçar atëherë, ne si Komunë kemi qenë të obliguar që ta bëjmë planin e ri zhvillimor me ligjin e ri te planifikimit hapësinor dhe udhëzimet e tjera administrative. PZHK-ja është një planë multi sektorial që përfshinë krejt territorin e komunës do të thotë diku 350 km^2 dhe i përfshin të gjitha çështjet duke filluar nga planifikimi i zhvillimit ekonomik, planifikimi i çështjeve te arsimit, planifikimi i çështjeve sociale, planifikimi i infrastrukturës, përcaktimi i tokës bujqësore apo kategorizimi, përcaktimi apo kategorizimi i zonave te gjelbra, përcaktimi i zonës ndërtimore ne fshatë dhe në qytet, çështjet e shëndetësisë dhe çështje të tjera për te cilat është kompetente Komuna. Për këtë arsye Kuvendi Komunal me kërkesën e Kryetarit te Komunës ka marr vendimin numër 01 nr.8 të dt. 29.01.2016 për fillimin e hartimit të PZHK-se. Me Ligjin për planifikimin hapësinor, Planin Zhvillimor Komunal Komuna është e obliguar ta bëjë me stafin e vet dhe ekspertet e vet, por komuna ka të drejtë që të angazhoj një kompani konsulentë, e cila do të jetë mbështetje për komunën, për këtë arsye janë zhvilluar procedurat e tenderimit nga ana e zyrës se prokurimit dhe është zgjedhur kompania konsulente “.....”. Pas zgjedhjes se kësaj kompanie kryetari i komunës, ka marre tre (3) vendime:

2019:233146

1. Ka formuar komitetin drejtues të planifikimit për hartimin e PZHK-së (vendimi nr. 97/16 i dt. 15.03.2016), në të cilin komitet në mesin e katërmbëdhjetë (14) anëtarëve apo drejtorëve, kam qene edhe unë;

2. Vendimi i dyte është Vendimi për formimin e grupeve tematike sektoriale (vendimi nr. 96/16 i dt. 15.03.2016), dhe

3. Vendimi i tretë i kryetarit është Vendimi për emërim të koordinatoreve të grupeve sektoriale (vendimi nr.95/16 i dt. 15.03.2016), pra janë tri vendime kolegjiale. Sipas ligjit të procedurës administrative numër 05/L -031 "organi publik kolegjial është një grup personash te caktuar sipas ligjit qe përfshihen në një procedurë administrative me kompetencat vendimmarrëse apo këshillimore." Duke pasur parasysh faktin se PZHK-në e aprovon Kuvendi Komunal, trupat e lartë cekura të formuara nga Kryetari kane pasur karakter këshillimorë.

Pasi që janë formuar këto grupe ne kemi filluar në grumbullimin e provave dhe pas një periudhë një vjeçare ne e kemi bërë draftin e pare te PZHK-së, të cilin e kemi prezantuar para një komisioni i cili ka qene i përberë nga përfaqësues te Ministrisë së Planifikimit Hapësinorë, dhe te Ministrisë së Bujqësisë dhe zhvillimit Rural, ne te cilin komision kane qene edhe përfaqësuesit e USAID-it qe kane dhënë mbështetje për Ministrinë. Pas këtij prezantimi Ministria na është drejtuar me një shkresë përmes email-it ne te cilin thuhet: " sipas procedurës me hapat që i ndërmerrni duhet të vihet deri te finalizimi i draftit të PZHK-se". Pas një periudhë dhe disa vërejtjeve qe na i kishte dhënë Ministria dhe pas eliminimit te atyre vërejtjeve drafti i PZHK-se është dashtë qe të i nënshtrohet shqyrtimit publik, ku për këtë shqyrtim duhet te marre përsëri vendim Kuvendi. Ky vendim quhet Vendimi për shqyrtimin publik te projekt planit Zhvillimor Komunal te Ferizajt për periudhën 2017-2025 (vendimi i KK-se 01 nr.25 i dt. 09.03.2017). Edhe ky vendim si te gjitha vendimet tjera shkon ne Ministri dhe verifikohet se a është në përputhje me ligjin, ku edhe ky vendim ka marre miratimin nga ana e Ministrisë. Shqyrtimin publik e kemi filluar ne afat prej 30 dite nga data 27.03.2017 deri me dt.26.04.2017 për arsye se me ligj përcaktohet ashtu, kurse ekspozimi i hartave dhe i komplet planit ka filluar ne sallën e Kuvendit Komunal prej dt. 25.03.2017 do te thotë dy dite përpara, me qëllim që qytetaret te i shohin më për së afërmi. Aty ne sallën e Kuvendit Komunal ka qëndruar një zyrtarë i cili ka pasur për obligim që të ju shpjegoj qytetarëve për çështje të cilat atyre ju kanë interesuar. Gjate periudhës së shqyrtimit publik i kemi pasur 102 kërkesa te qytetareve me shkrim qe i janë drejtuar Organeve Komunale dhe 7 peticione. Komisioni i shqyrtimit te kërkesave është përberë nga përfaqësuesit e te gjitha drejtorive te Kuvendit

2019:233146

Komunal, prej momentit kur ka përfunduar shqyrtimi publik nga data 26.04.2016 komisioni ka pasur afat prej 30 dite për të shqyrtuar te gjitha këto kërkesa, peticionet dhe me ju kthye përgjigje palëve, dhe me e përpiluar draftin final. Për këtë arsye komisioni e ka bërë publik raportin e shqyrtimit publik. Kemi qenë te obliguar ta bëjmë në web faqen e komunës faqe të cilën e mirëmban Ministria e pushtetit lokal, por ne atë kohe nuk ka qene duke funksionuar veb faqja e Ministrisë dhe atëherë ne publikimin e kemi bere ne web faqen e facebook Komunal. Pas publikimit te këtij raporti në drejtorinë e Urbanizmit ka ardhur Inspeksioni i Ministrisë së Planifikimet Hapësinor pasi qe asaj i ishte drejtuar me një ankesë një qytetar dhe ka kërkuar nga ne që atyre qe kane bere peticionet të iu kthehet përgjigjja me shkrim ne forme fizike, e jo vetëm përmes facebook-ut dhe një vërejtje tjetër ka qene se gjoja se ne draft PZHK-ne ne nuk kemi te drejtë ta bëjmë kategorizimin e ndërtimeve.

Natyrisht që komisioni është pajtuar me vërejtjen e parë të inspeksionit dhe është tubuar edhe një herë dhe i ka rishqyrtuar peticionet ne rrugën "Astrit Bytyqi" ku në përgjigje te komisionit ne mënyrë decitive është thënë: " komisioni është i mendimit se rruga "Astrit Bytyqi" e cila tash më pas lidhjes se saj me rrugën Ahmet Kaqiku dhe me magjistralen Prishtine – Shkup, ka fituar në peshë si rrugë tepër e rëndësishme ne te cilën mund te zhvillohet biznesi dhe te rritet çmimi i tokës. Një arsye tjetër është se te njëjtin kategorizim e kemi paraparë edhe në rrugët e kategorisë se njëjtë siç janë; rruga "Vëllezërit Gervalla" rr. "Rexhep Bislimi", rr." Driton Islami", rr." E Reçakut", rr." Kadri Zeka", rr." Epopeja e Jezercit", rr." Zenel Hajdini" , rr. "Enver Topalli" etj, qe për nga rëndësia nuk kane peshë më të vogël se rruga "Astrit Bytyqi". Palët i kemi njoftuar se për te njëjtën rrugë është edhe një peticion tjetër me 159 nënshkrime për ndërtim të lartë, dhe ne fund kemi thënë: " Andaj, ne e kemi refuzuar kërkesën tuaj por ne seancën e Kuvendit kur do të aprovohet plani Zhvillimor Komunal ne do ta njoftojmë Kuvendin me kërkesat e juaja sepse Kuvendi është organi i cili mund të vendos për versionin përfundimtar. Kurse për vërejtjen e dytë që kishte bërë komisioni ne e kemi adresuar një ankesë Komisionit për shqyrtimin e ankesave ne këtë Ministri. Për peticione dhe për ankesa kemi aplikuar dispozitat e udhëzimit administrativ 05/2014, në nenin 11 të këtij udhëzimi në mënyrë decidive thuhet: " nëse autoriteti i planifikimit hapësinorë gjate fazës së shqyrtimit publik pranon peticion nga pronaret e pa kënaqur te tokave dhe pronave te ndërtuara te cilët konsiderojnë që është bërë shkelje e të drejtës apo interesit të tyre përmes ndryshimit te destinimit t shfrytëzimit të tokave të tyre me draftin e dokumentit te planifikimit hapësinorë shqyrton peticionin dhe jep përgjigje të argumentuar ne kërkesat e tyre". Pra në asnjë dispozitë ligjore të këtij udhëzimi administrativ nuk thuhet se komuna ne rastin konkret të sillet ne bazë

2019:233146

të kërkesave të peticioneve. Kurse ndaj vërejtjes se dytë qe kishte thënë se nuk keni pas të drejtë të bëni kategorizimin e tokës ne kemi ushtruar një ankesë Komisionit për Shqyrtimin e ankesave pranë Ministrisë se Planifikimit Hapësinorë, me të cilën e kemi argumentuar se ne kemi vepruar drejt. Pas ushtrimit të kësaj ankese komisioni për shqyrtimin e ankesave ne MMPH-së ka marrë vendimin nr.926/17 të dt. 19.09.2017 ne të cilin vendim thuhet: " Aprovohet si e bazuar ankesa e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Ferizajt. Shfuqizohet vendimi numër 3270-2/17 i dt. 14.07.2017 i Inspektoratit të Ministrisë se Mjedisit dhe Planifikim Hapësinorë. Pas kësaj në Ministri e kemi dërguar projektin e ndikimit mjedisor të planit zhvillimor dhe e kemi marr vendimin Ref. ……, në të cilin vendim thuhet: "aprovohet kërkesa e drejtorisë së mjedisit, Komuna e Ferizajt, për raportin e vlerësimit strategjik mjedisor të planit zhvillimor të Komunës se Ferizajt, e nënshkruar nga Ministri i Planifikimit Hapësinor F. Sh.

Pasi kishim arritur këtë faze e kemi formuar një komision të përbashkët nga ana e Komunës dhe e Ministrisë se Planifikimit Hapësinor për të eliminuar të gjitha lëshimet eventuale qe i kishim bere me draftin e PZHK-se, pas eliminimit të këtyre lëshimeve procedurat kërkonin qe Komuna ti drejtohet Ministrisë për marrjen edhe të një pëlqimi – pëlqimit final, qe këtë draft të PZHK-se mund ta qesim ne Kuvend për miratim dhe natyrisht me datë 04.09.2017 e kemi marr pëlqimin numër 4329 -2/17 nga Ministria e Planifikimit Hapësinor në të cilin pëlqim thuhet: "Vendim për dhënien e pëlqimit për miratim të planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 i Komunës së Ferizajt. Ne të cilin vendim mes tjerash thuhet: Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit në kuadër të Ministrisë se Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të projekt planit Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i K. Ferizajt dhe dokumentacionit përcjellës si raporti i vlerësimit strategjik mjedisor dhe raporti nga shqyrtimi publik konstaton se ky dokument:

- I plotëson kushtet ligjore të parapara me Ligjin 04L -174 për planifikimin hapësinor mbi procedurat e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor,
- Është ne pajtim me nenin 26 të Ligjit 04/L-174 për planifikim hapësinor,
- Është ne përputhshmëri me planin hapësinor të Kosovës- strategjia e zhvillimit hapësinor 2010- 2020 +
- Është ne pajtim me Udhëzimin Administrativ të MMPH-se, 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal,
- Është ne pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor,

2019:233146

Ne baze të Ligjit 04 L-174 për Planifikim hapësinor, neni 9 par. 2 nen par. 2.3, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, merr vendim për dhënien e pëlqimit për miratim të projekt planit Zhvillimor Komunal 2017-2025 të Komunës së Ferizajt.

Pas marrjes se këtij dokumenti i akuzuari thekson se kemi caktuar seancën për të miratuar Planin Zhvillimor Komunal. Por ndërkohë Ministria e ka pranuar një kërkesë nga zoti I.H. dhe në raste të tilla Ministria detyrimisht në bazë të ligjit për procedurën administrative e pezullon këtë pëlqim deri sa të shqyrtohet ankesa e qytetareve d.m.th pezullimi nuk ka ndodh se ka pasur të meta apo vërejtje në gjithë dokumentacionin ose krejt procedurën e hartimit të PZHK–se, por ashtu e parasheh ligji i procedurës administrative. Ne arsyetimin e këtij pezullimi Ministria thotë: "duke qene se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ne afat të rregullt ka pranuar ankesën e palës me kërkesë për pezullim të vendimit është vendosur si ne dispozitiv të këtij vendimi duke u bazuar në Ligjin nr. 05 Ll/03, përkatësisht neni 130 pik.1 të këtij Ligji, ku thuhet: për veçse kur parashihet ndryshe me Ligj parashtrimi i një ankese pezullon sipas fuqisë se Ligjit prodhimin e pasojave juridike të aktit administrative deri ne njoftimin e vendimit që e zgjidh ankesa. Dhe pasi që është pezulluar përkohësisht, Ministria e ka shqyrtuar kërkesën e z. H. , dhe ka marr vendim në të cilin thuhet: shfuqizohet vendimi numër 4510 -2/17 i datës 15.09.2017 për pezullimin e dhënies se pëlqimit për miratim të planit Zhvillimor Komunal për periudhën 2017-2025 me numër 4323-2 të datës 04.09.2017, d.m.th, Ministria e ka lenë në fuqi pëlqimin numër 4323-2/17 të datës 14.09.2017,

Tani më kishin përfunduar të gjitha procedurat rreth hartimit të këtij dokumenti dhe me datë 25.09.2017 K. Komunal i Ferizajt e aprovon Planin Zhvillimor Komunal, me 20 vota pro dhe asnjë votë kundër, (Vendimi 01 nr.147 i datës 25.09.2017), natyrisht edhe ky vendim i nënshtrohet vlerësimit ligjor nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Planifikimit Hapësinor dhe ne e marrim vendimin apo shkresën nga Ministria në të cilën thuhet: vendimi i Kuvendit Komunal të Ferizaj 01 nr. 147 datë 21.09.2017, për miratimin e planit Zhvillimor Komunal 2017- 2025 i K.K. Ferizaj për periudhën tetë (8) vjeçare. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit ne fuqi dhe si i tille mund të prodhoj efekt juridik, këto pra kanë qenë procedurat e miratimit të planit hapësinor. Shton se kanë qenë gjithsejtë 7 peticione. Peticionet, përkatësisht kërkesat shqyrtohen ne bazë të ligjit për planifikimin hapësinor, por në detaje i rregullon udhëzimi administrativ 5/2014, mirëpo asnjë dispozitë ligjore e askush nuk mund të gjej se komisioni e më së paku unë si drejtor i drejtorisë se urbanizimit është i obliguar që të bëjë verifikimin e nënshkrimeve të peticioneve. Në seancën e Kuvendit Komunal unë në mënyrë decidive e kam njoftuar kuvendin se janë

gjithsejtë shtatë (7) peticione por kam thënë se dy (2) peticione janë për rrugën "Astrit Bytyqi" ku njëri është për ndërtim të lartë kurse tjetri është kundër ndërtimit të lartë dhe para Kuvendit e kam dhënë arsyetimin se pse komisioni ka vendosur për ndërtim të lartë. Unë ne detaje i kam njoftuar anëtaret e kuvendit për të gjitha peticionet duke përfshirë edhe peticionet ne rrugën "Astrit Bytyqi". Procesi i hartimit të PZHK-së, ka qenë i monitoruar në mënyrë strikte nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe ata nuk lejojnë asnjë shkelje. Ka qene një pune 20 vjeçare dhe ka qene një plan që përfshin shumë tematika dhe jo një plan që përfshinë vetëm problemin e ndërtimit të një rruge. Në komunën e Ferizajt duke përfshirë edhe fshatrat janë diku rreth 3000 rrugë, kurse vetëm në qytet janë rreth 1500 dhe të gjitha këto rrugë janë trajtuar ne kuadër të PZHK-se.

Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor.

Me provat e paraqitura në shqyrtimin publik gjyqësor dhe vlerësimin e tyre veç e veç dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së gjykata gjeti se nuk u provua se i akuzuari F.G. të ketë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Gjendjen e këtillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga prezantimi i provave në shqyrtimet e mbajtura gjyqësore dhe atë;

Pjesërisht nga mbrojtja e vetë të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor dhe gjatë procedurës hetimore,

Nga dëshmitë e të dëmtuarve: I.H., B. H. dhe O. B.,

Nga dëshmitë e dëshmitarëve: P. A., S. R., H. O., A. B., L. Sh., S.B., B. M., I. M., B. I., H. M., M. I., A. I., B. A., I. B., L. Z., E. A., M. H., I. M., A. R., F. L.,F. I., B. A. dhe F. G.

Nga provat materiale dhe atë:

- Nga raporti i oficerit me numër 20177-KE-226 i dt. 11.09.2017.
- Nga vendimi me numër 4323-3/17 i dt. 20.09.2017 për shfuqizimin e vendimit te dt. 15.09.2017 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Nga vendimi me numër KSHA-926/2017 (komisioni për shqyrtimin e ankesave) i dt. 19.09.2017 (me të cilin është aprovuar si e bazuar ankesa e drejtorisë së urbanizmit dhe mjedisit, Komuna Ferizaj) i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Nga vendimi me numër 17 i dt. 15.09.2017 i zyrës së sekretarit të përgjithshëm të Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me të cilin është aprovuar ankesa e të dëmtuarit I.H. dhe është pezulluar pëlqimi për miratimin e PZHK-së.

2019:233146

- Nga shikimi në skicat e rrugës "Astrit Bytyqi"
- Nga vendimi për dhënien e pëlqimit për miratimin e PZHK-së periudha 2017-2025 Kuvendit Komunal.
- Nga vendimi 01 numër 147 i dt. 25.09.2017 për miratimin e PZHK-së nga ana e Kuvendit Komunal.
- Nga listat e peticioneve të qytetarëve.
- Nga vendimi për leje ndërtimore me numër 04-351-52231 i dt. 30.06.2015 me të cilin i është dhënë leja ndërtimore personave F. G., A. I., K. A. dhe K. A.
- Nga pezullimi i aktit administrativ të lejes ndërtimore me numër 04-351-52231 i dt. 20.07.2015 lëshuar nga drejtoria e urbanizmit Ferizaj.
- Nga shikimi në kopjen e planit të dt. 21.04.2015.
- Nga njoftimi i dt. 22.06.2015 lëshuar nga drejtoria e Urbanizmit me të cilin njoftohet i dëmtuari B. H.
- Nga urdhëresa 01 numër 168/2015 e dt. 13.07.2015 e lëshuar nga zyra e kryetarit të Komunës në Ferizaj.
- Nga Vendimi me numër prot. 3088-3/15 i dt. 22.07.2015 lëshuar nga zyra e sekretarit të përhershëm të MMPH-së.
- Nga lista e anëtarëve të Komisionit dhe përfaqësuesve të sektorëve të Komunës.
- Nga procesverbali i dt. 09.08.2017 për shqyrtimin e peticioneve.
- Nga përgjigjja në peticion drejtuar të dëmtuarit O. B., lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit me numër 903/17 e dt. 10.08.2017.

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata vlerëson të pa kontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

I akuzuari F.G. në kohën për të cilën e ngarkon aktakuza, përkatësisht më datë 09.08.2017, ka qene drejtor në drejtorinë e urbanizmit dhe mjedisit ne Komunën e Ferizajt, e që është e nënkuptueshme se kishte cilësinë e personit zyrtar (Neni 120 par.2 nënpar.2.1 të KPRK-së "personi zgjedhur ose emëruar në një organ shtetëror")

2019:233146

Me dt. 29.01.2016 nga Kuvendi Komunal është nxjerr vendimi për fillimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal,

Për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, janë zhvilluar procedurat e tenderimit nga ana e Zyrës së Prokurimit dhe është zgjedhë Kompania profesionale konsulente “.....”

Pas caktimit të kësaj kompanie, me dt. 15.03.2016 me vendimin e Kryetarit të komunës është formuar Komiteti drejtues i planifikimit për hartimin e PZHK-së, në të cilin kanë marr pjesë të gjithë drejtorët e drejtorive komunale, në mesin e të cilëve ka qenë edhe drejtori i urbanizmit F.G., ku gjithsej kanë qenë 12 drejtori dhe kryetari i komunës si dhe nënkryetari, e që gjithsejtë kanë qenë 14 anëtarë

Pastaj Kryetari i komunës ka marr vendimin për formimin e grupeve tematike sektoriale, dhe vendimin për emërimin e koordinatorëve të grupeve sektoriale për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, në të cilin janë angazhuar të gjitha Drejtoritë Komunale, ku secila drejtori ka pasur nga 3 anëtar (nga një koordinator dha nga dy anëtar të komisioni).

Me dt. 09.03.2017 Kuvendi Komunal ka marr vendimin për shqyrtimin publik të projekt Planit Zhvillimor Komunal të Ferizajt për periudhën 2017-2025, ku sipas atij vendimi shqyrtimi publik ka zgjatur 30 ditë duke filluar prej datës 27.03.2017 deri me dt. 26.04.2017 e që palët në këtë periudhe kohore prej 30 ditëve kanë paraqitur kërkesat dhe ankesat e tyre për këtë plan.

Komisioni i shqyrtimit të kërkesave, ankesave dhe peticioneve është përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha drejtorive të Kuvendit Komunal, të cilët kanë pasur afatin prej 30 ditësh nga data e përfundimit të shqyrtimit publik me i shqyrtuar kërkesat, peticionet, me iu kthye përgjigje palëve dhe me përpiluar draftin final të PZHK-së.

Me dt. 30.05.2017 autoriteti përgjegjës për Planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit) dhe përfaqësuesit e sektorëve (drejtorive) të tjerë të Komunës ka nxjerrë Raportin e parë të shqyrtimit publik të Planit Zhvillimor Komunal të Ferizajt, për periudhën 2017-2025. Në ketë raport është konstatuar se PZHK ka qenë në diskutim publik nga data 25.04.2017 deri me dt.26.05.2017, ku gjatë kësaj periudhë vërejtje, propozime, sugjerime dhe kërkesa me shkrim në fletoren zyrtare i kanë adresuar 114 qytetarë, ku prej tyre kanë qenë 7 peticione dhe autoriteti përgjegjës i planifikimit hapësinor i është përgjigjur secilës kërkesë në formë tabelare me të gjitha të dhënat.

2019:233146

Kundër këtij raporti nga ana e palëve të dëmtuara është bërë një letër informuese, e cila është dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku në bazë të saj Ministria me vendimin e vetë, e kthen në rishqyrtim këtë raport, duke e sugjeruar komisionin që të rishqyrtoj peticionet e qytetareve.

Në baze të këtij vendimi është mbajt mbledhja e këtij komisioni me dt. 09.08.2017, ku në bazë të procesverbalit të shqyrtimit, ky komision rishqyrton edhe njëherë peticionet duke dhënë arsyetimet e tij për pranimin apo edhe refuzimin e atyre peticioneve, me arsyetimin se PZHK-ja është bazuar në arsyeshmërinë e dhënë nga gjetjet teknike si dhe numri i personave që kanë qenë pro nderimit të lartë e që është përfshirë në ato peticione, ka qenë më i madh se numri i personave qe kane qene kundër atij plani.

Pas këtij raporti me dt. 31.08.2017 materiali i kompletuar i PZHK-se është dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me qëllim që të merret pëlqimi dhe me dt. 04.09.2017 Ministria ka marr vendim për dhënien e pëlqimit.

Kundër vendimit të Ministrisë për dhënien e pëlqimit është ushtruar një ankesë nga pala e dëmtuar ku me 15.09.2017 Ministria e Planifikimit Hapësinor ka marr vendim me të cilin pezullohet pëlqimi dhe pas 5 ditë, përkatësisht me dt. 20.09.2017 Ministria merr vendim për shfuqizimin e pezullimit të pëlqimit dhe si rrjedhoje më 21.09.2017, kemi votimin e këtij plani në Kuvendin e Ferizaj

Mirëpo sipas Prokurorit të shtetit mënyra dhe procedura se si ka ardhur deri të aprovimi i këtij plani është kontestuese dhe është bërë me shkelje të dispozitave ligjore nga ana e të akuzuarit, duke pretenduar se i akuzuari si bartës apo person përgjegjës i këtij komisioni, ka marr për bazë nënshkrimet e qytetareve të cilat nuk kane qene të rrugës ”Astrit Bytyqi”, por kanë qenë të rrugëve tjera.

Pra, gjykata me përkushtim profesional maksimal në këtë çështje penale, ka bërë përpjekje që të ndriçon dy versionet e paraqitura si në procedurën hetimore, njashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor dhe atë: versionin e prokurorit të shtetit se i akuzuari e ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe versionin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij se i akuzuari nuk e ka kryer ketë vepër penale.
Andaj gjykata e ndodhur në mes këtyre versioneve tërë arsyetimin e këtij aktgjykim, do ta përqendron pikërisht në sqarimin e këtyre rrethanave.

I dëmtuari-dëshmitari I.H. ndër të tjera ka deklaruar: jam dëshmitarë në këtë gjykatë dhe njëherit jam edhe si palë e dëmtuar, për arsye se para fillimit të ndërtimit të shtëpive në rrugën "Astrit Bytyqi", disa herë kemi qenë në komunë dhe kemi pyetur se çfarë destinimi ka kjo rrugë, neve na është thënë ëe mënyre decidive se rr. "Astrit Bytyqi - zona 8-të", është parapare vetëm për ndërtim individual. Në komunë kemi qenë në mes të vitit 2013 dhe 2014, kur ka qenë pushteti i mëparshëm dhe ne kemi filluar me ndërtimin e shtëpive. Prej vitit 2012, kemi filluar ndërtimin e shtëpive dhe ajo ka zgjatur rreth 3 vjet. Diku ka viti 2015, ka pasur përpjekje që të fillojnë të rrënohen shtëpitë rreth shtëpive tona dhe ju kemi drejtuar me shkrim drejtorit të urbanizmit F.G., ku kemi kërkuar për parcelën nr. ..... dhe për parcelat e shtëpive tona nr.....,.....,.....,..... drejtori i urbanizmit me dt. 22.06.2015 na jep përgjigje me shkrim në të cilën thuhet, se parcelat e lartë shënuara janë të parapara për ndërtim individual 2-5 kate dhe në atë moment e kemi parë të arsyeshme që të vazhdojmë me ndërtimin e shtëpive.
Plani Zhvillimor Komunal në Komunën e Ferizajt, është aprovuar me dt. 21.09.2017. Para aprovimit të planit zhvillimor ka filluar të bëhet një draft propozim për plan Zhvillimor Komunal, ku të gjitha palët e interesuara kanë pasur mundësi të marrin pjesë nëpër debate për ti shprehur vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Drejtoria e urbanizmit si sponsorizuese e projektit në draftin e planit Zhvillimor Komunal, e futë edhe rrugën "Astri Bytyqi" zona 8-të për ndërtim të lartë, pa na pyetur neve si banues të kësaj zone. Gjatë debateve publike ne e kemi pyetur drejtorin e urbanizmit se si është e mundur që kjo zonë të përfshihet në ndërtimin e lartë pa na pyetur neve, i cili është përgjigjur se ky është një propozim që ne e dëshirojmë si komunë, por ju do të keni një afat një mujor për të dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e juaja. Kjo na është thënë edhe nga kryesuesi i Kuvendit F.G. si dhe nga M.Q. këshilltar komunal. Këta na kanë thënë se nëse del që mbi 50 për qind e këtyre qytetarëve deklarohen se janë për ndërtim të ulët atëherë do të mbetet ndërtim i ulët. Gjatë debatit publik ne kemi dhënë vërejtjet dhe sugjerimet tona pa ndërprerë të cilat i kemi paraqitur gojarisht por ankesat e qytetarëve nuk janë marrë për bazë, dhe gjithherë na kanë thënë se keni me pasur një afat për ti paraqitur vërejtjet me shkrim. Para se me i dorëzua peticionet, ne kemi shkuar te zyrtari që ka qenë përgjegjës për pranimin e peticioneve P.A., i cili zyrtarë ka qenë edhe anëtar i komisionit për shqyrtimin e peticioneve dhe ankesave dhe kemi pyetur në mënyrë konkrete se a pranohen edhe peticionet që nuk janë banor në rrugën "Astrit Bytyqi" në zonën e 8. Përgjigjja e tij ka qenë që nuk pranohen peticionet dhe emrat e personave që nuk i atakon problemi. Duke e ditur se si mundet me ardhë fundi i këtij procesi, unë së bashku me H.H., dhe O.B. kemi shkuar shtëpi për shtëpi në rr. "....." dhe kemi kërkuar nga ata që të deklaroheni se a janë për mbajtje të ndërtimit të ulët siç ka qenë, apo për ndërtim të lartë siç është paraqitur në draft propozimin e komunës. Peticioni ka

2019:233146

qenë shumë mirë i detajuar, emri dhe mbiemri, adresa nr. personal dhe nënshkrimi, gjatë asaj që kemi parë në teren diku rreth 3-4 familje kanë pasur vullnetin që të bëhet ndërtimi i lartë, kurse të tjerët janë shprehur kundër ndërtimit të lartë.

Nënshkruesit e këtij peticioni kanë qenë banorë të rrugës "Astrit Bytyqi" zona e 8 dhe atë banorë të parcelave ku i atakon problemi, ku 90 për qind kanë qenë kryefamiljar të shtëpive. Peticionet kanë qenë të publikuara edhe ne faqen zyrtare të Komunës, ku peticioni ynë është refuzuar mbi bazën se peticionet e kundërta kanë më shume banorë, ku kanë diku 159 nënshkrime kurse peticioni jonë diku 58 nënshkrime të kryefamiljarëve që janë deklaruar. Mbi bazën e dy peticioneve të kundërta të cilat kanë përfshi 159 nënshkrimeve, peticioni ynë i cili ka qenë më i vogël diku me 58 nënshkrime është refuzuar.

Peticionin e dorëzuar nga A.K. e kemi kuptuar nga faqja e publikuar zyrtare e Komunës. Nënshkruesit e këtij peticioni nuk janë të gjithë banor të rr. "Astrit Bytyqi", ku 6 emra të shënuar në faqen e parë të peticionit janë banor të rr. ..... e cila lidhet me rr. .... dhe "...". Kemi persona që janë të nënshkruar në këtë peticion të rr. ..... Në faqen e dytë të peticionit ka të nënshkruar edhe banor të fsh. ..... Drejtoria e Urbanizmit, na ka njoftuar me shkrim për refuzimin e peticionit tonë kinse numri i banorëve është më i vogël që kërkon ndërtim të ulët se i atyre që është për ndërtim të lartë. Thekson se kemi bërë ankesë prapë te drejtoria e urbanizmit, i kemi njoftuar edhe anëtarët e komisionit me dy letra informuese me gjithë kronologjinë se si ka shkuar puna dhe anëtarët e komisionit prej 17 anëtarëve na kanë thënë që kjo është kompetencë e drejtorisë së urbanizmit. Letrën informuese ia kemi dorëzuar të gjithë anëtarëve të komisionit, ku përveç letrës informuese kemi dorëzuar edhe ankesën dhe na është kthyer përgjigjja më dt. 20.06.2017 nga drejtori F.G. ku në përgjigje thuhet se të gjithat kërkesat, ankesat dhe sugjerimet që kanë ardhur lidhur me planin zhvillimor për periudhën 2017-25 gjatë kohës së shqyrtimit publik që ka qenë nga dt. 25.03.2017 deri më dt. 26.04.2017 janë shqyrtuar dhe përgjigjen e keni marrë në publikimin e raportit të shqyrtimit publik në faqen e komunës në Facebook dhe shton se të gjitha kërkesat dhe ankesat që arrijnë pas datës së shqyrtimit publik, siç është rasti edhe me kërkesën tuaj në bazë të ligjit për planifikimin hapësinor, nëse arrijnë pas afatit për shqyrtim publik, nuk mund të merren për shqyrtim dhe konsiderohen të pa afatshme. Pas kësaj ankese thekson kemi paraqitur ankesë edhe Ministrisë së planifikimit hapësinore dhe i kemi cekur të gjitha shkeljet të cilat kemi konsideruar se janë bërë. Ministria e planifikimit dhe inspektoratit ka dal në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë shqyrtimin e dokumentacionit, ku ata kanë marrë vendimin nr. 3270-2/2017 të dt. 08.08.2017, me të cilin i kërkohet drejtorisë së urbanizmit që të shqyrtoj edhe një herë peticionet e qytetarëve. Drejtoria e Urbanizmit pas marrjes së këtij vendimi nga ministria me dt. 09.08.2017

2019:233146

formon një komision tjetër, ku drejtori i urbanizmit ka qenë bartës i komisionit. Dallimi në mes të komisionit të parë dhe të dytë është në atë se në të parin kanë qenë 17 anëtar të komisionit kurse në të dytin kanë qenë 13 anëtarë. Në të njëjtën ditë kanë marrë vendim dhe sërish edhe ky komision thirret se nënshkruesit e peticionit për ndërtim të ulët janë 58 anëtarë ashtu që kërkesa juaj sërish refuzohet dhe për kërkesën e juaj do të bie vendim përfundimtar Kuvendi Komunal i Ferizajt. Edhe ky vendim ka qenë i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit Komunal, dhe në këtë vendim përveç që është shënuar se numri i qytetarëve që kanë paraqitur peticion është më i madhe për ndërtim të lartë, në arsyetimin e këtij vendimi është shënuar se do ti rritet vlera e pronave të pronarëve, se tani kjo rrugë ka lidhje edhe me rrugën magjistrale dhe me rrugën "Vëllezërit Gërvalla" dhe se do të ketë ndërtim të lartë në të dy anët e rrugës. Pastaj në vendimin përfundimtar për aprovimin e planit zhvillimor është shënuar se ndërtimi i lartë do të jetë në anën e djathtë të rr. "Astrit Bytyqi" shikuar nga qyteti në drejtim të rrugës magjistrale, duke përfshirë edhe parcelën me nr. .... si komplet parcelë, në të cilën parcelë janë edhe shtëpitë tona. Meqë në arsyetimin e vendimit është shënuar se kjo rrugë është me rëndësi të veçantë sikurse edhe rr. "Vëllezërit Gërvalla", "Epopeja e Jezercit" etj, atëherë shtrohet pyetja se përse në anën e majtë të rrugës është tërhequr ndërtimi i lartë. Para aprovimit të planit përfundimtar nga ana e kuvendit komunal, ne kemi ushtruar të gjitha mjetet juridike në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe me kërkesën tonë të dt. 12.09.2017 Ministria e Planifikimit Hapësinor me dt. 15.09.2017, ka lëshuar një vendim me të cilin pezullohet vendimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për dhënien e pëlqimit për miratim të planit Zhvillimor Komunal për periudhën 2017-2025 të dt. 04.09.2017, mbas këtij pezullimi dikush në emrin tim ka bërë kërkesë prapë në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor që të shfuqizohet pezullimi i vendimit nr. 4661 të dt. 20.09.2017 të I.H.. Deklaron se ne nuk kemi bërë kërkesë për shfuqizimin e vendimit me nr.4510-2/2017 të dt.15.09.2017 edhe pse në arsyetimin e vendimit të dt. 20.09.2017 me nr. 4323-3/2017 shënon në mënyrë decidive që sipas kërkesës së parashtruar nga I.H. në Ferizaj është kërkuar që të mblidhet komisioni dhe të shqyrtohet, ku sipas kësaj kërkese është mbledhur komisioni nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe vendimi lëshohet më dt. 20.09.2017 do të thotë një ditë para mbledhjes së kuvendit komunal ku nr. i vendimit është 4627/17 . Thekson se unë nuk kam paraqitur këtë kërkesë për shfuqizimin e vendimit edhe pse aty është thirrur në emrin tim , por kush e ka paraqitur këtë kërkesë në emrin tim unë nuk e di dhe pasi që është qarkulluar informata për pezullimin e vendimit ne kemi shkuar ne Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, jemi interesuar dhe nga Ministria kemi pranuar një kopje të këtij aktvendimi. Ne kemi bërë ankesë menjëherë kundër këtij vendimi mirëpo ende nuk kemi pranuar ndonjë përgjigje nga ministria e

2019:233146

planifikimit hapësinor lidhur me ankesën e ushtruar. Unë kam kërkuar informata edhe nga kryesuesja e komisionit S.R. që është edhe zyrtare ligjore në MPH dhe nga ajo na është thënë që ky vendim nuk është nënshkruar nga ne dhe thotë se askënd nuk e kemi autorizuar për vendosjen e kësaj çështje. Me dt. 18.09.2017 ka qenë e caktuar seanca e kuvendit komunal për miratimin e planit Zhvillimor Komunal, e cila seancë është mbajtur, por është hequr nga rendi i ditës aprovimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe seanca është shtyrë për 21.09.2017, ku në këtë seancë edhe është aprovuar Plani Zhvillimor Komunal nga ana e Kuvendit Komunal. Në mbledhjen e kësaj seance të kuvendit komunal ,të cilën ne e kemi përcjellë, me që ne kemi qenë si palë e dëmtuar, në këtë mbledhje fare nuk është përmendur peticioni të cilin ne e kemi paraqitur për rr. "Astrit Bytyqi". Dëshmitari thekson se peticionet e paraqitura kanë qenë bazë për aprovimin e planit zhvillimor sa i përket rr. "Astrit Bytyqi" zona 8-të, sepse edhe në arsyetimin e përgjigjes thuhet se edhe një peticion tjetër ka qenë më i madh se peticioni juaj dhe se kjo rrugë ka rëndësinë e njëjtë me rrugët "Vëllezërit Gërvalla", rr. " Rexhep Bislimi" etj. Dëshmitari deklaron unë e ndiej veten të dëmtuar me vendimet e marra nga ana e kuvendit komunal, për arsye se me dt. 15.01.2018 kemi parashtruar një kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit dhe kemi kërkuar që të na jepet shpjegim për pronat tona me nr. ....., dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis na ka njoftuar me shkresën nr. 04-16/01-0000504/18, se sipas planit Zhvillimor Komunal për periudhën 2017-2025 në ngastrat e cekura më lartë parashihet banim kolektiv me afarizëm. Pastaj thekson më dt. 09.03.2018, kemi paraqitur një kërkesë tjetër Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, ku kemi kërkuar informata nëse në parcelën me nr. ....., mund të ndërtojmë shtëpi për banim individual dhe me dt. 06.04.2018, kemi pranuar nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Urbanizmit, një njoftim me shkrim në të cilin shënohet se në qoftë se në një zonë të caktuar hartat zonale kanë paraparë ndërtime të larta, atëherë në atë zonë të caktuar nuk mund të bëhen ndërtime për banim individual, por vetëm ato për banim kolektiv.

I dëmtuari në vazhdim të dëshmisë thekson se gjatë zhvillimit të debatit publik, prezent ka qenë më së shpeshti drejtoi i urbanizmit F.G., por aty kanë marrë pjesë edhe nga ministria e planifikimit hapësinor S.G. dhe nga kompania prezantuese ".....", aty ju ka dhënë mundësia secilit qytetarë me marrë fjalën dhe me i paraqitur kërkesat vërejtjet, sugjerimet dhe ankesat e tyre lidhur me Planin Zhvillimor Komunal. Zyrtarët nga kuvendi komunal dhe ministria e planifikimit hapësinor si dhe nga kompania e cekur me lart e quajtur "....." , na kanë njoftuar se për të gjitha vërejtjet e juaja lidhur me projektin e planit zhvillimor, do të keni një afat kohor prej 30 ditëve ku do ti paraqitni vërejtjet dhe sugjerimet e juaja me shkrim. Ne i kemi paraqitur vërejtjet dhe peticionet tona me shkrim, se ne jemi kundër ndërtimit të lartë në zonën "Astrit Bytyqi", pasi ne jemi edhe banor të asaj zone, por përgjigja e zyrtareve ka qenë negative se nga

2019:233146

dy komisionet e kuvendit komunal, është refuzuar kërkesa jonë për ndërtim të ulët, kurse është aprovuar kërkesa për ndërtim të lartë me arsyetim se kërkesa për ndërtim të lartë, ka qenë me një numër më të madh të banorëve që kanë dëshiruar një ndërtim të tillë dhe me arsyetim se kjo rrugë, do të ketë një rëndësi të veçantë se kësaj rruge do ti rritet vlera sikurse rrugëve të tjera.

I dëmtuari-dëshmitari B.H. ndër të tjera deklaron: me të akuzuarin F.G., në kohën kur ai ka qenë drejtor i Urbanizmit, kam pasur takime me të në sallën e Kuvendit Komunal, në kohën kur janë mbajtur diskutimet publike për planin rregullues urban, e disa herë jam takuar edhe në zyrën e tij të drejtorit të urbanizmit. Në zyrën e tij kam qenë ndonjëherë vetë por ka pasur rast që kam qenë me vëllaun tim I.... dhe përfaqësuesin tonë me autorizim A.S.. Një herë më kujtohet rasti kur kam shkuar te kryetari i komisionit për shqyrtime publike të planit zhvillimor S.B. dhe nga ai kam kërkuar procesverbalin e mbledhjes së këtij komisioni, por ai nuk më ka treguar procesverbalin, duke më thënë se këtë mund ta shihni tek drejtori i urbanizmit, dhe pastaj kam shkuar te drejtori, kam kërkuar një procesverbal të përpiluar nga komisioni për hartimin e Projekt- planit zhvillimor, por drejtori i urbanizmit na tha se këtë mund ta shihni në web faqen zyrtare të Komunës dhe pastaj drejtori i urbanizmit F.G. na e ka ofruar një procesverbal i **dt.09.08.2017** për shqyrtimin e peticioneve. Mbledhja e këtij komisioni është mbajtur vetëm një ditë pasi Ministria e Planifikimit Hapësinor, e ka obliguar drejtorinë e Urbanizmit që të rishqyrtoj peticionet dhe të ju jep përgjigje të argumentuara paraqitësve të peticionit lidhur me aprovimin apo refuzimin e këtyre peticioneve. Ne dyshojmë se ky procesverbal është përpiluar pa u mbajtur fare mbledhja e komisionit për rishqyrtimin e peticioneve. Në një peticion që kemi organizuar në rr. “Astrit Bytyqi”, vëllau im I.H. së bashku me mua dhe me O.B., kemi shprehur vullnetin tonë kundër ndërtimeve të larta. Gjatë diskutimeve publike që janë organizuar në komunë ndonjëherë edhe në objekte shkollore, unë kam marrë pjesë në këto diskutime publike, por nuk kam dëgjuar nga pjesëmarrësit që dikush ka kërkuar që të ndryshoj destinimi nga ndërtim i ulët, në ndërtim të lartë. Në mbledhje të kuvendit komunal drejtori i urbanizmit F.G. kam dëgjuar kur anëtarëve të kuvendit komunal, përkatësisht këshilltarëve të kuvendit komunal, ju ka thënë se këto probleme të cilat s’kanë mundur të kryhen gjatë revidimit të zonave, këto do ti zgjidhim me Planin Zhvillimor Komunal, e ne e kemi ditur se cilat kanë qenë ato probleme, prandaj në debatet publike disa herë i kemi parashtruar pyetje drejtorit të urbanizmit F.G., se a do të ketë ndryshime në destinimin e sipërfaqeve. Fjala është nga destinimi i ulët në atë të lartë për tërë territorin e komunës së Ferizajt dhe në atë rast drejtori është përgjigjur, se këto destinime do të bëhen edhe në harta zonale, e jo në Planin Zhvillimor Komunal. Më 03.02.2017, ne ju kemi drejtuar

2019:233146

menaxherit të projektit të PZHK-së, S.B. me një kërkesë me shkrim nga i cili kemi kërkuar shpjegim që sipërfaqja e cila përfshinë pronat tona në rr. “Astrit Bytyqi”, si do të jenë në draftin e planit Zhvillimor Komunal, mirëpo nga ky person nuk kemi pranuar ndonjë përgjigje me shkrim lidhur me kërkesën tonë të parashtruar. Të njëjtën kërkesë e kemi përsëritur edhe tre apo katër herë, të cilën ja kemi drejtuar personit të cekur më lartë S.B., dhe pas rreth tre muajve përmes emailit tim S.B. ma ka dërguar një hartë të destinimit të sipërfaqes të territorit të qytetit të Ferizajt, ku aty përfshihen edhe pronat tona në rr. “Astrit Bytyqi” .

Unë nuk kam kërkuar hartën e tërë qytetit por kam kërkuar shpjegim në formë tekstuale dhe në hartë të platformës GIZ të parcelave me nr. ....., ..., ... dhe ....., kërkoj se si kanë qenë dhe si janë të propozuara me draft plan Zhvillimor Komunal, kjo ishte kërkesa ndërsa përgjigjja nga personi i cekur me lart S.B. nuk ishte ajo qe unë kisha kërkuar dhe për këtë unë jam takuar me S.B. në zyrën e tij, nga i cili kam kërkuar shpjegim për hartën të cilën ai ma kishte dërguar përmes emailit tim. Fillimisht me tha se vetëm ketë dokument mundem të ofroj, sepse këtë ma ka dërguar drejtoria e urbanizmit dhe kompania “.....” dhe asgjë tjetër.

Kompania “.....” ka qenë e kontraktuar jo si bartëse e projektit, por në rolin e këshill dhënies-Konsullences , sepse nga kjo kompani unë kam kërkuar një shpjegim, për kërkesën të cilën nuk ma kishte shpjeguar menaxheri S.B. , mirëpo kjo kompani më ka informuar se ne nuk jemi bartës të projektit, nuk jemi propozues të këtyre ndryshimeve dhe për këto ndryshime është përgjegjës dhe bartës drejtoria e urbanizmit ndërsa ne kemi rolin vetëm të konsulences dhe të këshill-dhënies .

Për këtë hartë që ma ka dërguar menaxheri S.B. ne kemi kërkuar përgjigje edhe nga organet tjera, konkretisht së pari kemi bërë pyetje në diskutimet publike ku aty ka qenë prezent i akuzuari F.G., ka pasur raste kur kanë qenë prezent edhe përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – departamenti për ndërtim dhe planifikim. Kërkesa jone aty ka qenë se përse po ndodhin këto ndryshime për destinimin e pronave në fjalë, ku aty unë kam pranuar dy përgjigje gojarisht, nga drejtori i urbanizmit F.G., na është thënë se ky është vetëm një draft i propozuar dhe ky nuk është një dokument final dhe ju do të keni mundësi gjatë shqyrtimit publik që do të jetë i hapur për 30 ditë, t’i ushtroni kërkesat ankesat apo edhe propozimet e juaja dhe drejtoria është e interesuar që mundësisht ti merr parasysh dhe ti realizoj të gjitha kërkesat. Ndërsa nga përfaqësuesit e Ministrisë se Planifikimit Hapësinor, konkretisht nga S.G. na është përgjigjur se Plani Zhvillimor Komunal, është plan i përgjithshëm, dhe nuk i trajton këto kërkesa që ju po i parashtroni, aty na ka sqaruar se të gjitha ndryshimet e destinimeve do të bëhen përmes hartave zonale dhe na ka këshilluar që këto ankesa të i adresojmë gjatë hartimit të hartave zonale dhe jo gjatë hartimit të PZHK. Në debatet

2019:233146

publike ka marrë pjesë drejtori i urbanizmit F.G., zyrtari nga MPH S.G., kanë marrë pjesë edhe zyrtarë tjerë të drejtorisë së urbanizmit dhe qytetarë të tjerë, përfshirë edhe të rrugës "Astrit Bytyqi". Në tubimet publike të cilat janë mbajtur para se të del drafti i PZHK, në të cilat unë kam marrë pjesë në pothuajse të gjitha, nuk kam dëgjuar ndonjë qytetarë të ketë kërkuar që të bëhet ndonjë ndryshim nga ndërtimi i ulët në të lartë, ndërsa unë dhe disa të tjerë kemi kërkuar edhe me shkrim, por edhe gjatë diskutimit që të mos ndryshohet destinimi i sipërfaqeve dhe rr. "Astrit Bytyqi", të mbetet siç ka qenë në planet rregulluese të mëhershme. Më 05.10.2016, në dëgjimin publik i cili është mbajtur ne shkollën "Astrit Bytyqi", unë kamë dhënë komentet e mija me shkrim, sepse kemi pasur para vetës një formular të përgatitur nga vetë drejtoria, në të cilën kemi pasur mundësi të japim komentet tona lidhur me hartimin e planit Zhvillimor Komunal, kemi kërkuar që mos të na ndryshohet destinimi i sipërfaqes, edhe pse kam qenë i vetëdijshëm se me plan zhvillimor nuk mund të bëhen këto, mirëpo duke dëgjuar deklarimet publike te drejtorit F.G. se me Planin Zhvillimor Komunal, do ti zgjidhim te gjitha problemet të cilat nuk kanë arritur të zgjidhen përmes revidimit të zonave urbane dhe unë e kam ditur cilat ishin ato probleme të revidimit të pronave, pra ishin pikërisht mos mundësia e këtyre ndryshimeve të destinimeve përmes revidimeve të planeve rregulluese, sepse këto revidime me vone ishin kthyer si të kundërligjshme dhe përpjekjet për të ndodhur këto revidime, edhe pse nuk kishin bazë ligjore, kanë vazhduar përplot një vit dhe kishim njëmijë e një arsye se këto ndryshime do të ndodhnin në PZHK. Në fakt, këto debate janë mbajtur sa për sy e faqe, sa për tu plotësuar një kriter ligjor i cili kërkohet nga autoritetet e planifikimit që të zhvillohen këto procedura, mirëpo këto debate asnjëherë nuk kanë shërbyer që të pranojnë dhe aprovojnë ndonjë propozim të qytetarëve, përkundrazi edhe pse debatet mbahen që të jetë një transparence më e hapur, nga drejtori i urbanizmit çdoherë është fshehur se çka në fakt është duke planifikuar ne ato dokumente, këtë e themë sepse drejtori i urbanizmit në mënyrë që të na pamundësoj të japim komente, na ka mashtruar gjatë tërë debateve publike se plani Zhvillimor Komunal është një planë multi - sektorial dhe merret me projekte shumë më madhore dhe nuk i trajton destinimet se çfarë lloj ndërtimi mund të ndërtohet, të njëjtat për të na mashtruar na ka thënë edhe zyrtarja nga ministria S.G., ku ajo enkas ka ardhur në komunën e Ferizajt që ti del në ndihmë drejtorisë së urbanizmit. Asnjë pakënaqësi nuk është shprehur nga dikush se pronën e tyre dëshirojnë ta shndërrojnë ne ndërtim të lartë. Në këto tubime unë nuk kam vërejtur se është mbajtur procesverbal. Në tubimet publike nga rruga "Astrit Bytyqi" kanë marrë pjesë rreth 20 qytetarë, vërejtje nga këta qytetarë nuk ka pasur shume që janë dhënë sepse shpjegimet nga ana e drejtorisë së urbanizmit kanë qenë të tilla që qytetarëve nuk ju ka interesuar me që nuk i ka prekur interesat e tyre. Në debatet publike nuk është diskutuar ndryshimi i destinimit,

2019:233146

por pavarësisht kësaj ne kemi dhënë vërejtje se çka do të ndodhë, por diskutimet kanë qenë të tilla, se plani zhvillimor do ti trajtoj zonat ekonomike, zonat bujqësore, statistikat e shkollave, ku do të ketë ujë, çfarë pasurie gjendet në secilën parcelë dhe ju do të keni mundësi që vetëm me një klik të informoheni saktë se çka do të parashihet në atë parcelë, çfarë pasurie nëntokësore ka në atë parcelë, por gjithmonë duke i ikur destinimit. Rruga "Astrit Bytyqi" zona 8-të, ka gjithsej rreth 80 shtëpi, ndërsa pjesa tjetër e rr. "Astrit Bytyqi", është zona 1, ka rreth 20 shtëpi. Në debate publike kanë qenë gjithsej rreth 20 persona kur është mbajtur tubimi publik nga ajo rrethin në shkollën "Astrit Bytyqi", por kjo nuk do të thotë se të gjithë këta persona kanë qenë nga rr. "Astrit Bytyqi", ku nga kjo rrugë kanë mundur me qenë rreth 30 për qind e pjesëmarrësve, kurse kur është mbajtur ne kuvendin komunal kanë marrë pjesë edhe nga lagje të tjera. 80 shtëpitë e cekura ne rrugën "Astrit Bytyqi", përfshinë të dy anët e rrugës "Astrit Bytyqi" ne zonën e 8. kryefamiljarët e këtyre shtëpive nuk kanë dhënë pëlqim për destinimin e lartë, këtë e bazoj sepse pas draftit të planit Zhvillimor Komunal, në draft na është ndërruar destinimi i tëre rrugës "Astrit Bytyqi", atëherë ne banorët e lagjes kem pasur komunikime dhe jem pajtuar që ta hartojmë një peticion në mënyre që ta kundërshtojmë këtë. Ne nuk kemi pranuar një përgjigje me shkrim se ndryshimi destinimit nga ndërtimi i ulet në ndërtim të lart tani më është propozuar përmes draftit Zhvillimor Komunal, se drejtori në debat publik na ka shpjeguar se pavarësisht draftin, ju do të keni mundësi të adresoheni me shkrim dhe ti paraqitni kërkesat e juaja. Kjo parcelë kufizohet me tre rruge: me rr. "Astrit Bytyqi", "Enver Hadri" dhe rrugën "7 Shtatori", dhe është parcelë e vetme në rrugën "Astrit Bytyqi", e cila në projekt draftin është përfshirë si tërësi në ndërtimin e lartë. Ka qenë një komision për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve për të cilën jemi informuar gjatë dëgjimeve publike, se ankesat mund ti drejtojmë te ky komision ne formë të shkruar qoftë përmes ankesave apo shkresave të ndryshme. Me të filluar shqyrtimi publik i këtij drafti, diku në mars të vitit 2017 kundër këtij draft-propozimi ne banoret e rr. "Astrit Bytyqi" kemi organizuar një peticion kundër ndërtimeve të larta, të cilat ishin paraparë ne atë draft, këtë peticion e kemi dorëzuar në komune të Ferizajt ku ju kemi adresuar kryetari të komunës M.S., Kryesuesit të kuvendit F.G.1., drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit F.G. dhe drejtorit të administratës F.H., ndërsa ky peticion është dërguar komisionit për shqyrtimin e ankesave të PZHK. Në vazhdim dëshmitari deklaron se peticionin kundër ndërtimit të lartë e kanë nënshkruar 60 qytetar, që të gjithë kryefamiljarë dhe banore të rr. "Astrit Bytyqi", këto peticione i kemi mbledhur bashkërisht me banoret e lagjes, mirëpo më së shumti për sigurimin e këtyre nënshkrimeve kemi punuar unë, vëllau im I.H. dhe O.B., mirëpo ka pasur edhe qytetarë të tjerë të cilët na kanë ndihmuar që të sigurohen këto nënshkrime. Nënshkrimet janë mbledhur në atë mënyrë që

2019:233146

kemi shkuar shtëpi për shtëpi, duke ia prezantuar dokumentin e peticionit se për çfarë peticioni bëhet fjalë, p.sh. unë kam shkuar të një fqinjë ja kam prezantuar peticionin, ja kam shpjeguar qëllimin dhe kam kërkuar nëse edhe ata janë të gatshëm të nënshkruajnë dhe nëse ju pengon edhe atyre një ndërtim i tillë dhe kam kërkuar që të gjithë të angazhohemi që të ja propozojmë edhe fqinjëve tjerë këtë peticion, në mënyrë që të marrim mendimin e sa ma shumë banorëve të kësaj lagje. Shumicën absolute të këtyre nënshkrimeve i kemi mbledhur ne personat e cekur më lartë, ku të gjithëve ju kemi shpjeguar që të mos nënshkruajnë më tepër se një anëtarë për një familje dhe kemi kërkuar që nënshkrimin ta jap kryefamiljari nëse ai ka qenë prezent. Ketë peticion e kemi dorëzuar në komunë dhe zyrtaret e komunës këtë peticion ia kane dorëzuar komisionit për shqyrtimin e ankesave për planin zhvillimor. Në peticionin e kemi dorëzuar një ditë para se të përfundoj afati për dhënien e komenteve për PZHK dhe deri atëherë nuk kemi qenë në njohuri se ka pasur ndonjë peticion tjetër. Sa i përket rr. "Astrit Bytyqi", ne kemi menduar që ky proces ka përfunduar sepse një ditë para se të përfundon afati për komente rreth 70 për qind tani më kishim dorëzuar peticion me shkrim me të cilin kemi kërkuar që rr. "Astrit Bytyqi" të mbetet sië ka qenë, banim individual, pra deri në ditën e dorëzimit nuk ka pasur peticion tjetër, por këtë e kam mësuar në faqen zyrtare të komunës në Facebook dhe aty kam parë që ka pasur rrethe 7 peticione, ku për rr. "Astrit Bytyqi", kam parë se ka pasur edhe një peticion tjetër dhe një kërkesë tjetër. Në Facebook të komunës kam vërejtur se këtë peticion e ka dorëzuar A.K., ku në këtë peticion kam vërejtur se janë rrethe 130 nënshkrime e më tepër, por nuk kam hyr në detaje të këtij peticioni, sepse posa e kam parë numrin e këtyre qytetarëve unë menjëherë e kam ditur se këta persona nuk mund të jenë të rr. "Astrit Bytyqi", këtë e bazoj sepse unë personalisht përmes google map kamë numëruar që rruga "Astrit Bytyqi", ka rreth 80 shtëpi nga këto nënshkrime i kisha marrë 60 shtëpi, që janë nënshkrime kundër ndërtimit të lartë, gjithashtu rreth 10 shtëpi kanë qenë të pabanuara, jashtë shtetit të Kosovës, rrjedhimisht maksimumi i mundur i nënshkrimeve të peticionit tjetër ka qenë 10 familjarë të rr. "Astrit Bytyqi", pra kjo ka qenë maksimumi i mundshëm i familjarëve që kanë mundur të nënshkruajnë e të cilët nuk kanë pasur mundësi, pasi që nuk kanë qenë duke banuar në shtëpitë e tyre, e prej tyre 10, 3 apo 4 kanë mundur me qenë për ndërtim të lartë, ndërsa 5 apo 6 neutral Në raport të shqyrtimit publik kam vërejtur se në rr. "Astrit Bytyqi", peticioni jonë është refuzuar ndërsa është aprovuar peticioni i dorëzuar nga A.K. në të cilin ceket se ka 159 qytetarë, pra këtu mendoj se janë përfshirë qytetarët e nënshkruar në peticionin e dorëzuar nga A.K. dhe qytetarët apo familjarët e I.Z., të cilin e kishin dorëzuar një kërkesë. Nuk e di arsyen pse është përpiluar peticioni i kundërt nga ai që e kemi dorëzuar ne, sepse drafti ka qenë ashtu siç kanë kërkuar këta në peticionin e tyre, pra për ndërtim të lartë po mendoj pikërisht peticioni

2019:233146

i dorëzuar nga pala tjetër ka qenë bazë për aprovimin e PZHK-së. Aty përmendet se një peticion tjetër nga një numër me i madh i qytetareve kanë qenë për ndërtim të lartë, prandaj edhe është marrë për bazë, edhe një arsye tjetër është përmendur në përgjigjen refuzimit të peticionit të dhënë nga komisioni i planit zhvillimor dhe nga drejtori i urbanizmit, i cili ka qenë bartës i komisionit, dhe kjo arsye e tyre është se tani rr. "Astrit Bytyqi", lidhet me magjistralen Prishtinë- Shkup. Në përgjigjen e tyre është përmendur se rr. Rexhep Bislimi" dhe rr. "Vëllezërit Gërvalla" është paraparë me destinim të njëjtë, pra për ndërtim të lartë, ashtu që edhe kjo rrugë kemi paraparë të jetë e të njëjtit tretman. Unë mendoj se nuk ka asnjë analogji rruga "Astrit Bytyqi" me rrugën "Vëllezërit Gërvalla" dhe "Rexhep Bislimi". Gjithashtu përmendet se me lidhjen e re të rr. "Astrit Bytyqi" me rr. Magjistrale Prishtinë – Shkup, do të rritet vlera e tokës dhe do të ketë nevojë për ndërtime të larta, çka unë mendoj se kjo është e kundërta, sepse në aspektin profesional një rrugë në të cilën parashihet qarkullim i madh i automjeteve nuk duhet të rritet dendësia e banimit, sepse qarkullimi i madh vetëm sa e vështirëson jetën e qytetarëve, prandaj arsyet e përmendura mendoj se nuk janë profesionale.

I dëmtuari-dëshmitari O.B. ndër të tjera deklaron: se në atë lagje jeton që nga lindja, rreth 28 vite, rr. "Astrit Bytyqi", ka gjithsej rrethe 80 shtëpi, në këtë rrugë ka qenë ndërtim i ulët, por tani kur kam pyetur në komunë me kanë thënë se kjo rrugë është bërë ndërtim i lart. Ndryshimi i këtij destinimi nga i ulëti në të lartë është bërë nga viti i kaluar. Unë personalisht nuk kam paraqitur ndonjë kërkesë për ndryshimin e këtij destinimi nga i ulëti në të lartë, gjithashtu as anëtarët e familjes time nuk kanë paraqitur ndonjë kërkesë të tillë. Nga unë nuk ka kërkuar askush që të jap pëlqimin për ndryshimin e destinimit nga ndërtimi i ulët në të lartë. Ndryshimi i këtij destinimi nga i ulëti në të lartë nuk është bërë vetëm për pronën time, por për tërë rrugën "Astrit Bytyqi", dhe atë në krahun e shtëpive tona që janë të ndërtuara. Unë nuk e di pronarët e shtëpive të tjera a kanë dhënë pëlqimin për ndërrimin e destinimit nga ndërtimi i ulët në ndërtim të lart. Unë ndryshimin e këtij destinimi nga i ulëti në të lartë e kam kuptuar pasi kjo ka dalë në faqe zyrtare të Komunës. Paraprakisht unë e kam ditur se kanë me u bërë këto ndryshime përmes debateve publike që janë bërë në Kuvendin Komunal, unë nuk kam marrë pjesë në debate publike, por këtë e kam kuptuar përmes mjeteve të informimit-televizionit. Për mos ndryshimin nga destinimi i ulët në të lartë ne banorët e lagjes "Astrit Bytyqi", kemi paraqitur peticion. Këtë peticion e kemi mbledhur së bashku me I.H. dhe një person tjetër emri i të cilit nuk më kujtohet. Nënshkrimet i kemi mbledhur në atë mënyrë që ne kemi shkuar shtëpi për shtëpi, ka pasur edhe prej tyre që e kanë lexuar aty për aty dhe ka pas të tjerë që e kanë marrë dhe kanë hyrë brenda në shtëpi dhe janë konsultuar me familje, e pastaj e

2019:233146

kanë nënshkruar dhe ka pasur prej atyre edhe që e kanë mbajtur në shtëpi gjersa janë konsultuar me familjarët e tyre që i kanë pasur në shtetet e jashtme, këtë peticion e ka nënshkruar ndonjëri nga anëtarët e familjes dhe me rastin e nënshkrimit në peticion është shënuar edhe numri personal i tij. Ne kemi qenë në të gjitha shtëpitë që gjenden në rr. "Astrit Bytyqi", ku prej tyre, 60 shtëpi kanë arritur me lexuar dhe nënshkruar peticionin, kurse 20 shtëpi kanë qenë në vendet e jashtme dhe nuk ka pasur se kush të nënshkruaj. Nënshkrimet që janë mbledhur nga këto 60 shtëpi kanë qenë kundër ndërtimit të lartë. Këtë peticion në komunë e kam dorëzuar unë së bashku me I.H.. Në komunë ka pasur të dorëzuar edhe peticion tjetër këtë e kemi kuptuar më vonë pasi që është shpallur në faqen zyrtare të komunës dhe personi i cili e kishte dorëzuar këtë peticion ishte me emrin A..., mbiemri i të cilit nuk me kujtohet. Në këtë peticion kishin qenë të shënuara rreth 150 nënshkrime dhe kishin qenë të shënuara emri, mbiemri, numri personal dhe nënshkrimi, kurse vendbanimi nuk kishte qenë i shënuar. Kur i kemi shikuar emrat që janë shënuar në këtë peticion kemi vërejtur se disa prej tyre nuk kanë qenë banor të kësaj lagje. Nuk më kujtohet numri i saktë se sa persona kanë qenë të regjistruar në peticionin tonë kundër ndërtimit të lartë. Peticionin tonë nuk e ka marrë për bazë Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Zhvillimor e Kuvendit Komunal në Ferizaj, që ne kemi qenë kundër ndërtimit të lartë. Lidhur me ndryshimin e destinimit nga ndërtimi i ulët në ndërtim të lartë ne jemi dëmtuar.

Me rastin e vlerësimit të dëshmive të dëmtuarve: I.H., B.H. dhe O.B. gjykata konstaton se në kohën e ndërtimit të shtëpive, në zonën e 8-të, në Rrugën "Astrit Bytyqi", në parcelën ku ata i kanë ndërtuar shtëpitë, me planin e mëparshëm urban ka qenë i paraparë ndërtimi individual i ulët, e pastaj në Planin Zhvillimor Komunal, të aprovuar nga ana e Kuvendit Komunal me 21.09.2017 është bërë ndryshimi i këtij destinimi nga ndërtimi i ulët në ndërtim të lartë. Për mos me ndodhë ky ndryshim i destinimit, të dëmtuarit para aprovimit të PZHK-së, kanë mbledhur një numër të konsiderueshëm të nënshkrimeve nga banorët e kësaj lagje, të cilët kanë qenë për ndërtim individual të ulët dhe e kanë përpiluar një peticion, të cilin me 25.04.2017 përmes të dëmtuarit O.B., ia kanë dorëzuar Komisionit për hartimin e PZHK dhe Komisioni në mbledhjen e mbajtur me dt. 09.08.2017, ka refuzuar peticionin e dorëzuar nga O.B., të cilin e kanë nënshkruar 58 qytetar, kurse kanë aprovuar Peticionin e dorëzuar nga A.K. dhe I.Z. (tani i ndjerë) me gjithsej 159 nënshkrime ,të cilët kanë qenë për ndërtim të lartë. Sipas të dëmtuarve nënshkrimet e paraqitura në peticionin e dorëzuar nga A.K. nuk janë të gjitha nga banorët të cilët jetojnë në rr,"Astrit Bytyqi", por janë edhe nga banorët që jetojnë në rrugë të tjera, ashtu që sipas tyre ndryshimi i destinimit të ndërtimit të asaj rruge nga ndërtimi i

2019:233146

ulët në ndërtim të lartë, është bërë kundër vullnetit të banorëve të asaj rruge dhe se përgjegjës për ketë ndryshim konsiderojnë se është i akuzuari F.G., i cili ka qenë drejtor i urbanizmit.

Mirëpo **trupi gjykues vlerëson** se vendimi për refuzimin e peticionit të paraqitur nga i dëmtuari O.B. është marr nga një organ kolegjial siç është Komisioni për hartimin e projektit të Planit Zhvillimor Komunal, ku gjithsejtë kanë qenë 13 anëtarë të cilët të gjithë edhe e kanë nënshkruar procesverbalin dhe i kanë dhënë arsyet se përse këtë pjesë të rrugës "Astrit Bytyqi", e kanë paraparë për ndërtim të lartë, ku si kriter për këtë destinim të kësaj rruge komisioni e ka marr për bazë më tepër vlerësimin e vetë profesional, e jo peticionet e paraqitura nga qytetarët, siç pretendojnë të dëmtuarit, të cilat arsye janë të shënuara në procesverbalin e mbledhjes së komisionit të dt. 09.08.2017 siç vijon:

" *Komisioni pasi rishqyrtoj kërkesat tuaja është i mendimit se në ketë rrugë, e cila tash pas lidhjes së saj me rrugën "Ahmet Kaqiku" dhe me magjistralen Prishtinë Shkup, ka fituar në peshë si rrugë tepër e rëndësishme, në të cilën mund të zhvillohet biznesi dhe të rritet çmimi i tokës.*

Një arsye tjetër është : se të njëjtin kategorizim (destinim) e kemi paraparë edhe në rrugët e kategorisë së njëjtë siç është: Rr." Vëllezërot Gërvalla", rr. "Rexhep Bislimi", rr. "Driton Islami", rr. "Kadri Zeka", rr."Epopeja e Jezercit", rr,"Zenel Hajdini", rr,"Enver Topalli" etj. të cilat për nga rëndësia nuk kanë peshë më të madhe se sa rruga "Astrit Bytyqi".

Në fund të procesverbalit thuhet: *Andaj, ne i kemi refuzuar kërkesat tuaja, por në seancën e Kuvendit, kur të aprovohet PZHK, do ta njoftojmë kuvendin me kërkesat e juaja, sepse Kuvendi është organi që vendos për versionin përfundimtar.*

Dëshmitari P.A. ndër të tjera deklaron: Gjatë vitit 2017 në kuvendin komunal në Ferizaj, së pari kam punuar ne cilësi të praktikantit e pastaj kam themeluar marrëdhënie pune sipas kontratës në vepër, në kohëzgjatje prej 3 muajve e cila pastaj më është vazhduar gjerë në dhjetor të vitit 2017. Kam punuar në drejtori të urbanizmit, ku drejtor i kësaj drejtorie ka qenë F.G.. Detyrat e mija të punës sipas kontratës mbi vepër kanë qenë: që të paraqes para qytetarëve draft Planin Zhvillimor Komunalë, të marrë nga qytetarët komentet, sugjerimet, kërkesat e tyre gjatë fazës së shqyrtimit publik të draft planit Zhvillimor Komunal, gjithashtu mbledhjes së tyre dhe paraqitjes para komisionit për shqyrtimin e ankesave.

Ka pasur interesim nga ana e qytetarëve për shikimin e planit Zhvillimor Komunal, ka pasur prej hapësirave të ndryshme, pasi që plani e ka përfshirë tërë territorin e komunës. Ka pasur raste edhe kur banorët e lagjes "Astrit Bytyqi" kanë ardhur për ta shikuar Planin Zhvillimor

2019:233146

Komunal, ku në mesin e tyre kanë ardhur zotëria I.H. etj. Forma që unë e kam prezantuar Planin Zhvillimor Komunal, ka qenë përmes programeve kompjuterike ku secili ka pasur mundësinë në nivel të parcelës se çka është e planifikuar ne Planin Zhvillimor Komunal.
Thekson se i kujtohet kur I.H. ka bërë vërejtje duke e paraqitur një peticion për ta kundërshtuar destinimin që ka qenë në atë moment, ku në atë moment ka qenë i paraparë destinimi për ndërtim kolektiv. Para këtij momenti nuk e din se a ka qenë plani për ndërtim të lart apo të ulët- individual. Ankesat dhe sugjerimet e palëve që i kanë paraqitur kanë qenë me shkrim mirëpo ka qenë një libër i vendosur në zyrën time ku në atë libër, përkatësisht fletore qytetarët kanë mundur të shënojnë kërkesat e tyre.
Ankesat e paraqitura të qytetarëve janë shqyrtuar nga ana e komisionit për ankesa në atë mënyrë që përmes programeve të njëjta siç janë paraqitur para qytetarëve, janë paraqitur edhe para komisionit dhe janë shqyrtuar përmes numrit rendor.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave nuk e din saktësisht se sa anëtar i ka pasur, por në këtë komision kanë marr pjesë përfaqësuesit e të gjitha drejtorive të komunës së Ferizajt për të dhënë kontributin e tyre profesional. Me vet faktin që kam pasur me i prezantuar kërkesat sugjerimet dhe ankesat e qytetarëve edhe unë kam qenë anëtar i këtij komisioni, përveç kërkesave dhe ankesave ne kemi pranuar edhe peticione nga ana e qytetarëve për dhe kundër planit Zhvillimor Komunal. Më kujtohet se ka pasur edhe peticione nga banoret e lagjes "Astrit Bytyqi", ku kanë qenë 3 peticione, të cilat i ka dorëzuar I.Z., A.K. dhe I.H.. Në momentin që i kam pranuar peticionet unë para komisionit i kam paraqitur për shqyrtim, kurse nuk i kam shikuar se a janë pro ndërtimit të lartë apo kundër. Unë nuk e kam pasur obligim me i shikuar peticionet se a janë pro apo kundër ndërtimit të lartë, gjithashtu nuk kam pasur për obligim me i shikuar se nënshkruesit e peticionit a janë banues të lagjes "Astrit Bytyqi" apo nuk janë, kurse sa i përket komisionit nuk e di se a ka pasur një obligim të tillë. Unë nuk e di se komisioni a i ka shikuar, përkatësisht a ka bërë verifikimin se nënshkruesit e këtyre peticioneve a janë banues të lagjes "Astrit Bytyqi". Për aprovimin e planit Zhvillimor Komunal me vetë faktin që ka qenë diskutimi publik në kohëzgjatje prej 30 ditëve, mendoj se ka qenë dashtë me u marrë parasysh kërkesat, vërejtjet dhe ankesat e qytetarëve por nuk ka qenë obligative që të gjitha kërkesat dhe ankesat e qytetarëve me u aprovuar. Plani Zhvillimor Komunal është aprovuar për tërë territorin e komunës së Ferizajt, se ky plan nuk mund të aprovohet vetëm për një lagje të caktuar. Peticionet e qytetarëve me rastin e aprovimit të planit Zhvillimor Komunal kanë një peshë të caktuar, por nuk janë bazament për tu marrë një vendim vetëm në bazë të këtyre peticioneve, se me rastin e aprovimit të planit Zhvillimor Komunal në rend të parë është marr për bazë profesionalizmi.

2019:233146

Dëshmitarja S.R. ndër të tjera deklaron: Gjatë vitit 2017 kam qenë duke punuar ne drejtorinë e urbanizmit në komunën e Ferizaj, në sektorin e lejeve ndërtimore të ulëta dhe të larta, sipas kërkesave të qytetarëve. Detyrat dhe përgjegjësitë e mija kanë qenë, me pranuar lëndën, me kompletuar, verifikuar dhe me e përcjellë. Lëndën e kompletuar e dorëzojmë te juristi. Në rast se nuk është lënda e kompletuar i kthehet palës për në plotësim. Në vitin 2017 nuk më kujtohet se kush ka qenë aty duke punuar si jurist, pasi që janë ndërruar tre apo katër juristë dhe nuk më kujtohet se cili ka qenë gjatë vitit 2017. Vendimin përfundimtar lidhur me lejen e ndërtimit e nënshkruan drejtori i urbanizmit. Unë nuk e di a ka pasur përgjegjësi drejtori i urbanizmit për të kontrolluar dokumentet të cilat i dorëzohen atij.

Përveç detyrave të mija të cilat më takojnë sipas vendit të punës, unë kam qenë e caktuar edhe në komisionin për Planin Zhvillimor Komunal. Detyrat dhe përgjegjësitë e mija në këtë komision kanë qenë nga ana ime profesionale pasi që me profesion unë jam arkitekte, në komision nuk e di saktësisht se sa anëtar kanë qenë por e di se kanë qenë përfaqësues nga të gjitha drejtoritë komunale. Përfaqësues të drejtorive tjera komunale nuk e di saktësisht se mundem edhe të gaboj, por mendoj se ata kanë qenë të caktuar nga drejtorët e drejtorive përkatëse, kurse unë kam marrë pjesë pasi që punoj në drejtorinë e urbanizmit dhe planit dhe hartat zonale hartohen në drejtorinë tone- sektori i planifikimit.

Në vitin 2017 nuk e di saktësisht se sa mbledhje i kemi mbajte të komisionit për planifikim zhvillimor. Komisionin për planifikimin zhvillimor gjatë mbledhjeve e ka udhëheq menagjeri S.B., nganjëherë në mbledhje të këtij komisioni ka prezantuar edhe drejtori i urbanizmit F.G.. Gjatë mbledhjeve të komisionit është mbajtur edhe procesverbali. Në mbledhjet e këtij komisioni, është diskutuar për zhvillimin e procedurave të planit zhvillimor, rrethe hartimit të planit e më vonë pas debatit publik janë shqyrtuar edhe kërkesat, ankesat dhe peticionet e paraqitura nga qytetarët.

Në Planin Zhvillimor Komunal, ka qenë objekt edhe rruga "Astrit Bytyqi", ku gjatë kohës së shqyrtimit publik në këtë komision na kanë arritur edhe peticione të qytetarëve, ku nuk jam shumë e sigurt por më duket se kanë qenë rreth 3 peticione. Rruga "Astrit Bytyqi", duke filluar nga rr. "Tiranës", ka qenë në fillim e destinuar për ndërtim të ulët, kurse në Planin Zhvillimor Komunal pjesa rreth rrugës "Astrit Bytyqi", është paraparë për ndërtim kolektiv. Kjo është paraparë në të dy anët e rrugës, me përjashtim të një pjese që përfshinë anën e majtë prej pjesës së qytetit përkatësisht prej rr. "Tiranës", e nuk e di saktësisht se deri ku e përfshinë kjo zonë, ka mbetur për ndërtim individual.

Për ndryshimin e destinimit të pronave nuk është e thënë me u marrë për bazë pëlqimi i pronarëve të atyre pronave, por më tepër për bazë merret ana profesionale. Rruga "Astrit

2019:233146

Bytyqi", është lidhur me rrugën magjistrale Prishtinë-Hani i Elezit dhe në bazë të asaj, kjo rrugë është kategorizuar me rrugët e tjera kryesore sië janë: rr. "Vëllezërit Gërvalla", rr. "Rexhep Bislimi", rr. "Reçakut" , "Driton Islami", "Epopeja e Jezercit", "Naim Beka" etj.

Komisioni për planifikim zhvillimorë rrugën "Astrit Bytyqi", e ka cilësuar, përkatësisht e ka kategorizuar me rrugët e cekura më lartë në bazë të asaj që theksova, se lidhet me rrugët magjistrale, pastaj është një rrugë me profil më të gjerë e lidhë qendrën e qytetit me rrugën magjistrale. Ka edhe rrugë të tjera që ndërlidhen njëra me tjetrën, por janë të kategorive më të ulëta. Unë nuk e di se nga kush janë dorëzuar peticionet. Peticionet na e kanë dorëzuar si numër për tu bërë ndërtimi i lartë ose me mbet ashtu siç kanë qenë për ndërtim të ulët. Në mbledhjen e komisionit janë prezantuar edhe numrat e paraqitësve të peticionit por këtë ne nuk e kemi marrë për bazë pasi që për bazë kemi shikuar anën profesionale. Në këto peticione ka pasur për ndërtim kolektiv dhe për ndërtim individual. Peticionet së pari kanë shkuar te zyra e planifikimit, pasi që ata janë menaxhues të atij projekti, pastaj janë prezantuar para komisionit dhe atë për shkak të transparencës, se në raportin përfundimtar të shqyrtimit publik me ligj është e paraparë që duhet të përfshihen edhe kërkesat, ankesat dhe peticionet e qytetarëve dhe duhet me ju dhënë përgjigja qytetarëve lidhur me këto kërkesa, ankesa dhe peticione. Përveç tri peticioneve të rr. "Astrit Bytyqi", nuk më kujtohet që ka pasur peticione të rrugëve të tjera.

Plani Zhvillimor Komunal i shqyrtuar në mbledhjen e komisionit, për planifikim zhvillimor është aprovuar edhe nga ana e anëtarëve të Kuvendit Komunal, ashtu siç theksova me lartë që në të dy anët e rrugës është paraparë ndërtimi kolektiv, me përjashtim të atij segmenti të rrugës që e ceka më lartë, i cili ka mbetur për ndërtim individual. Ana e majtë e rrugës "Astrit Bytyqi", shikuar nga drejtimi i qytetit në drejtim të magjistrales, nga segmenti i rrugës i cekur më lartë përkatësisht nga fillimi i zonës së 8, është paraparë edhe me vendim të kuvendit komunal që të mbetet ndërtim individual, kurse pas kalimit të këtij segmenti vazhdon ndërtimi kolektiv.

Për aprovimin e planit Zhvillimor Komunal është marrë për bazë arsyeshmëria profesionale, e jo numri i qytetarëve që kanë paraqitur peticionin. Nënshkrimet e qytetarëve në peticion ne nuk i kemi verifikuar.

Dëshmitarja deklaron se për bazë është marrë edhe e mira e qytetarëve nga ana profesionale, e si të mirë të qytetarëve thekson kemi vlerësuar se ju është rritur vlera e pronave të tyre, ku aty tani mundet me u zhvillu biznesi më tepër. E di se ka pasur edhe peticione nga ana e qytetarëve kundër ndërtimit të lartë, ku me ligj është e destinuar se peticionet munden me u paraqit nga ana e qytetarëve për shkak të pakënaqësive rreth ndryshimit të destinimit të ndërtimit, por në ligj shkruan se ne jemi të obliguar që qytetarëve me ju kthyer përgjigje të argumentuar për

2019:233146

peticionet e tyre të dorëzuara, e nuk jemi të obliguar që gjithqysh ti aprovojmë peticionet e tyre.

Dëshmitarja H.O. ndër të tjera deklaron: se ka punuar në Komunën e Ferizajt nga viti 2005 deri në vitin 2015, si inxhinierë në zyrën e prokurimit, e nga viti 2015-2016 ka punuar në zyrën projektuese, ndërsa në vitin 2016-2017, si hidro-inxhiniere në drejtorinë e urbanizimit ndërsa nga viti 2017 ka kaluar prapë në zyrën e prokurimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e mia gjatë viti 2016-2017, kanë qenë dhënia e lejeve për infrastrukturë konkretisht për ujësjellës, kanalizim. Përveç këtyre detyrave unë kam qenë e angazhuar edhe në komisionin për hartimin e draft planit Zhvillimor Komunal, nuk e di prej kujt ka qenë vendimi që është caktuar në këtë komision.

Si anëtare e këtij komisioni detyrat dhe përgjegjësitë e mia kanë qenë në lëminë e profesionit tim, që do të thotë në lëminë e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, në këtë komision nuk e di sa anëtarë kemi qenë, nuk e di e as kush ka qenë përgjegjës i këtij komisioni, unë jam marrë me punën time profesionale të ujësjellësit dhe kanalizimit. Nuk më kujtohet se kush i ka organizua takimet e këtij komisioni, por më kujtohet se edhe unë kam qenë dy apo tri herë në mbledhjen e këtij komisioni. Rruga "Astrit Bytyqi", gjendet në zonën e dytë të planit rregullativ.

Gjatë vitit 2016 dhe 2017, rruga "Astrit Bytyqi", nuk e di a ka qenë e destinuar për ndërtim kolektiv apo individualë, meqë unë jam marrë vetëm me çështjen e ujësjellësit dhe kanalizimit, unë siç e ceka edhe në fillim se jam marrë në dy apo tri takime ku janë mbajtur, por me çështjen e ankesave nuk jam marrë dhe nuk e di se a ka pasur ankesa, e nëse ka pas nuk e di sa ankesa kanë qenë dhe nga kush kanë qenë ato ankesa.

Lidhur me zonën në Rr. "Astrit Bytyqi", nuk më kujtohet nëse është biseduar lidhur me ankesat në takimet e komisionit, nuk më kujtohet edhe nëse është mbajt procesverbal, sa më kujtohet mua mbledhjen e ka udhëhequr njësia e planifikimit hapësinor pranë Drejtorisë së Urbanizimit, nuk më kujtohet se kur është themeluar ky komision dhe sa ka zgjat puna e këtij komisioni, nuk e di se çfarë kompetenca ka pas ky komision se unë mundem me fol vetëm për lëmine time.

Shqyrtimin e ankesave e ka pas obligim menaxheri i projektit dhe arkitektët, e kur është në pyetje peticioni është obligim i organeve hetuese.

Edhe tash nuk e di nëse rruga "Astrit Bytyqi", a është e destinuar për ndërtim të lartë apo të ulët në vitin 2016-2017, nuk më kujtohet e as nuk më ka interesuar se për çfarë destinimi ka qenë kjo rrugë, pasi që jam marrë vetëm me punën time të profesionit, ndërsa kjo ka qenë përgjegjësi e arkitektëve të cilët i kanë zonat e tyre.

Dëshmitarja A.B. ndër të tjera deklaron*:* në drejtorinë e urbanizimit në komunën e Ferizajt ka filluar të punoj nga viti 2001, si zyrtare e lartë për dhënien e lejeve ndërtimore, po

2019:233146

ka marrë pjesë në shumë komisione të cilat janë formuar nga kryetari, përkatësisht drejtori. Komisioni i fundit ka qenë projekti investimeve publike, e gjatë vitit 2016-2017 ka qenë koordinatore e grupit të drejtorisë së urbanizmit, në të cilin e ka caktuar Kryetari i Komunës, dhe çdo drejtori e ka pas nga një koordinator. Gjithsejtë kanë qenë sa i kujtohet 13 anëtarë, nga secila drejtori. S.B. ka qenë udhëheqës i këtij komisioni, meqë të gjitha shënimet që i kanë grumbulluar i kanë dorëzuar tek udhëheqësi S.B., nuk i kujtohet se si është emërtuar ky komision. Nuk i kujtohet se kujt i ka dhënë llogari S.B. Pjesë e këtij komisioni nuk e din se a ka qenë edhe drejtori i urbanizmit.

Komisioni është themeluar me qëllim të grumbullimit të shënimeve secili në sektorin e vet dhe pastaj ato shënime janë dorëzuar kompanisë konsulente “.....”, komisioni ka qenë edhe për hartimin e draft planit Zhvillimor Komunal.

Puna e këtij komisioni ka qenë në atë mënyrë që të gjitha vërejtjet, sugjerimet iu kanë dorëzuar kompanisë konsulente “.....”, e pastaj kompania ato të dhëna i ka përpunuar dhe i ka prezantuar në takimet e tona të rregullta.

Si komision kemi pas obligim që të i shqyrtojmë të gjitha shkresat, ankesat, peticionet lidhur me PZHK. Procedura e shqyrtimit të ankesave ka qenë në atë mënyrë që në takimin e komisionit është prezantua nga kompania konsulente, e cila më parë i ka përpunuar, ku për disa ankesa, apo kërkesa nuk ka pasur reagime nga anëtarët e komisionit. Unë edhe pse punoj në zyrën e dhënies së lejeve ndërtimore, por nuk jam pjesë e zyrës për hartimin e planifikimit. Rruga “Astrit Bytyqi”, ka qenë pjesë e planit Zhvillimor Komunal, dhe kjo rrugë ka qenë për ndërtim të ulët, e me Planin Zhvillimor Komunal 2017-2025 është paraparë për ndërtim të lartë.

Lidhur me Planin Zhvillimor Komunal, Drejtoria e Urbanizmit ka mbajtur debate publike, ku në disa debate edhe unë kam marrë pjesë por jo në të gjitha, e debate ka pas edhe në lidhje me rrugën “Astrit Bytyqi”, por unë nuk kam mbajt shënime lidhur me zhvillimin e këtyre debateve.

Gjatë kohës sa ka qenë duke u prezantuar plani, unë kam qenë në njohuri se ka pas peticione, ku komisioni për hartimin e PZHK-së, i ka shqyrtuar të gjitha ankesat, peticionet dhe kërkesat e qytetarëve. Peticionet si numër e di që kanë qenë, mirëpo si bazë nuk kanë qenë, janë shqyrtuar dhe analizuar në aspektin profesional, por për aprovimin e planit Zhvillimor Komunal më tepër është marrë parasysh aspekti profesional. Për ndryshimin e destinimit nga ndërtimi i ulët në ndërtimin e lartë, nuk është marrë për bazë numri i nënshkruesve të peticionit por është marrë për bazë aspekti profesional. Nuk e dinë numrin e saktë se sa peticione janë

2019:233146

bërë nga qytetarët, por si informatë e din që ka qenë peticioni për ndërtim kolektiv, mirëpo numrin e nënshkruesve të peticionit nuk e din.

Thekson se duke marrë parasysh se edhe rruga "Astrit Bytyqi", është një rrugë e rangut të lartë që lidhet me rrugën magjistrale, është paraparë ndërtimi kolektiv në këtë rrugë, ndërsa me planet e mëhershme kjo rrugë ka qenë ndërtim i ulët.

Unë personalisht nuk kam bërë kurrfarë verifikimi të nënshkruesve të peticionit, por nuk e di se edhe anëtarët e tjerë të komisionit a kanë bërë një gjë të tillë. Peticionet janë paraqitur në adresë të udhëheqësit të njësisë së planifikimit konkretisht në emër të S.B., por a ka qenë ky i obliguar ta bëjë verifikimin e nënshkruesve të peticionit unë nuk e di.

Ana e djathë e rrugës "Astrit Bytyqi", shikuar nga qyteti në drejtim të magjistrales, e di se është për ndërtim kolektiv, ndërsa ana e majtë është për ndërtim individual dhe atë një pjesë. Me Planin Zhvillimor Komunal ana e majtë e rrugës "Astrit Bytyqi", ka mbetur për ndërtim individual ngase ka pas zgjidhje më të drejtë urbanistike sepse kanë qenë rrugët e drejta, parcelat e formësuara mirë, objektet e ndërtuara për banim individual.

Dëshmitari L.Sh. ndër të tjera deklaron: Gjerë në mars të vitit 2018 kam punuar në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm në punët dhe detyrat e zyrtarit për hartimin dhe përpilimin e projekteve, për drejtorinë e turizmit. Gjatë vitit 2016-2017, kam qenë anëtarë i komisionit për shqyrtimin e planit zhvillimorë nga kjo drejtori, ku në këtë komision me sa e di unë më kanë caktuar ose bordi i drejtorëve ose drejtori i drejtorisë në të cilën unë kam punuar. Nuk e di a kam pranuar ndonjë vendim me shkrim për emërimin tim si anëtar i këtij komisioni. Në këtë komision kanë marrë pjesë nga një përfaqësues i secilës drejtori në kuadër të kuvendit komunal, ku gjithsej kanë qenë 11 drejtori dhe nga secila drejtori ka qenë i caktuar nga një anëtarë i komisionit, por drejtoria e urbanizmit ka pasur më tepër, e gjithsejtë sa anëtar të komisionit kanë qenë nuk e di. Përveç përfaqësuesit nga drejtoritë komunale, nuk e di se a ka pasur në këtë komision përfaqësues edhe nga shoqëritë civile apo ekspert të jashtëm. Punën e këtij komisioni e ka udhëheqë S.B. i cili na e dërgonte ftesat për takime me anëtarë tjerë të komisionit. Unë nuk e di se sa kohë ka funksionuar ky komision.

Detyrat dhe përgjegjësit e këtij komisioni, nuk e di saktësisht se cilat kanë qenë, pasi që unë kam punuar në drejtorinë e zhvillimit ekonomik dhe turizmit, dhe se puna e këtij komisioni me tepër është lidhur me arkitektët, ingjinierë të ndërtimtarisë e tjerë.

Unë në këtë komision kam punuar gjerë më dt. 29.03.2018 dhe gjerë më këtë datë unë nuk e di se a ka arritur ky komision me e përfunduar punën lidhur me hartimin e draft planit Zhvillimor Komunal. Gjatë kohës së hartimit të këtij draft plani Zhvillimor Komunal, unë kam marrë pjesë në mbledhjet e këtij komisioni, por a janë mbajtur debate publike apo jo me qytetarët unë nuk

2019:233146

e di sepse unë nuk kam qenë pjesëmarrës në tubimet me qytetarë. Si anëtar i komisionit kemi pranuar edhe ankesa, kërkesa nga qytetarët, unë e di saktë se ku gjendet rruga "Astrit Bytyqi", në Ferizaj. Ankesat, kërkesat dhe parashtresat tjera të qytetarëve, së pari kanë shkuar në Drejtorinë e Urbanizmit e pastaj të njëjtat komisioni i ka shqyrtuar. Nga rr. "Astrit Bytyqi", ka pasur peticione, por numrin e saktë të tyre nuk e di. Peticionet të cilat kanë arritur nga rruga "Astrit Bytyqi", disa kanë qenë për ndërtim të lartë e disa kundër ndërtimit të lartë. Shumica e banoreve te rrugës "Astrit Bytyqi", nuk e di se a kanë qenë pro ndërtimit të lartë apo kundër. Unë kam qenë pjesë e shqyrtimit të këtyre peticioneve, por nuk kam marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e këtij komisioni. Unë nuk besoj përkatësisht nuk e di se këto peticione a kanë qenë bazë për ndryshimin e destinimit nga ndërtimi i ulët në të lartë në rr. "Astrit Bytyqi". Komisioni për shqyrtimin e planit Zhvillimor Komunal, ka shqyrtuar te gjitha ankesat, kërkesat dhe peticionet e qytetarëve, pa marrë parasysh a kanë qenë bazë për ndryshimin e destinimit. Gjatë shqyrtimit të peticioneve në komision është zhvilluar debat lidhur me peticionet e paraqitura nga qytetarët. Si komision ne nuk e kemi bërë verifikimin e nënshkrimeve të qytetarëve, dhe nuk besoj se dikush ka pas barrë për të verifikuar nënshkrimet e qytetarëve. Unë nuk i kam parë peticionet dhe kërkesat, por të njëjtat në komision janë lexuar dhe prezantuar në sllajde. Brezi i rrugës "Astrit Bytyqi", siç e mbaj mend është vendosur të jetë ndërtim i lartë, mua nuk më kujtohet se a kanë qenë të dy anët e brezit të rrugës për ndërtim të lartë apo vetëm njëra anë.

Mua më kujtohet se ne e kemi pasur një kompani konsulente për hartimin e draft planit zhvillimor komuna dhe më kujtohet që në një punëtori që ka zgjatur 2 ditë, përveç komisionit për hartimin e draftit, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile, Policisë, FSK-së të gjitha në një përbërje shumë të gjerë. rreth 50 ose 60 pjesëmarrës, akter të ndryshëm. Po të isha edhe sot në këtë komision, do të isha i mendimit të njëjtë për ndërtim të lartë. Gjatë punës time në ketë komision kam qenë plotësisht i pavarur.

Dëshmitari S.B, ndër të tjera deklaron*:* Gjatë vitit 2016 ka qenë duke punuar ne Komunën e Ferizajt në Drejtorinë e Urbanizmit në punët dhe detyrat e hartimit të planifikimit hapësinor, dhe ka qenë i angazhuar edhe në komisionin për planifikim Zhvillimor Komunal. Komisionin për planifikimin Zhvillimor Komunal e ka themeluar kryetari i komunës, ku ky komision i ka pasur përafërsisht 30-35 anëtarë, nuk e din numrin e saktë por në komision kanë marrë pjesë nga 3 anëtar nga secila drejtori komunale e që gjithsej kanë qenë 10 drejtori, ku nga dy prej tyre kanë qenë anëtarë dhe nga një koordinatorë nga secila drejtori. kurse drejtoria e urbanizmit i ka pasur rrethe 6 ose 7 anëtarë, dhe një koordinatorë. Anëtarë të këtij komisioni

2019:233146

e ka caktuar drejtori i urbanizmit me vendim dhe meqenëse drejtoria e urbanizmit ka qenë hartuese e projektit, atëherë ky ka qenë si menaxher i këtij komisioni.

Detyrat dhe përgjegjësit e këtij komisioni kanë qenë të kontribuoj në hartimin e planit Zhvillimor Komunal duke dhënë propozimet, vërejtjet, sugjerimet për hartimin e planit Zhvillimor Komunal. Ky komision ka pasur për obligim që ti shqyrtoj edhe kërkesat, ankesat dhe peticionet e paraqitura nga qytetarët, ndërsa detyrat e mija si përgjegjës i këtij komisioni kanë qenë udhëheqja me punët e këtij komisioni, përkatësisht detyrë e imja ka qenë të caktoj takimin e mbledhjeve të këtij komisionit. Ky komision nuk ka marrë vendime por vetëm ka dhënë propozime. Gjatë mbledhjeve të këtij komisioni është përpiluar edhe procesverbali. Për mbajtjen e procesverbalit përkatësisht procesmbajtës të caktuar nuk kemi pasur por procesin e ka mbajtur zakonisht ndonjëri nga anëtarët e komisionit. Në këto mbledhje të këtij komisioni i kemi trajtuar temat që kërkohen me PZHK, në atë mënyrë që secili sektor i drejtorisë përkatësisht përfaqësuesit e drejtorive që kanë qenë në mbledhje, kanë pasur për obligim me i krijuar raportet sektoriale dhe plotësimin e tabelave-të dhënave për grumbullimin e shënimeve për drejtoritë përkatëse. Si komision kemi organizuar dhjetëra debate me qytetarët, në atë mënyrë që i kemi caktuar datën e takimit, vendin dhe temën të cilën e kemi diskutuar. Gjatë debateve publike qytetarët kanë pasur mundësi për ti paraqitur vërejtjet, kërkesat dhe sugjerimet e tyre. Ne i kemi marrë për bazë të gjitha vërejtjet, sugjerimet e qytetarëve dhe pakënaqësitë e tyre, të cilat i kemi konstatuar në procesverbalin që është mbajtur gjatë shqyrtimit publik. Unë e di se ku gjendet rr. “Astrit Bytyqi” në Ferizaj, ku gjatë debatit ka pasur edhe pakënaqësi të qytetarëve të kësaj rruge, të cilat pakënaqësi i kemi evidentuar në procesverbalin e debatit publik. Pakënaqësitë e këtyre qytetarëve janë shprehur rreth destinimit të shfrytëzimit të tokës-hapësirës së tyre, ku në mesin e këtyre qytetarëve ka pasur pro dhe kundër destinimit nga ndërtimi i ulët në ndërtim të lartë, por gjatë shqyrtimit publik nuk më kujtohet se a ka pasur më tepër pro ndërtimit të lartë apo kundër ndërtimit të lartë. Përveç shënimeve të cilat i kemi marrë nga qytetarët në debate publike, ne kemi pranuar edhe peticione dhe kërkesa me shkrim nga qytetarët e rr. “Astrit Bytyqi”, të cilat kërkesa janë dorëzuar në zyrën për shërbimin me qytetarë dhe të njëjtat janë protokolluar e pastaj janë përcjellë në drejtoritë përkatëse ku kanë qenë të adresuara, e që në rastin konkret janë përcjellë në drejtorinë e urbanizmit, pasi që kanë qenë të adresuara për në këtë drejtori. Kërkesat dhe peticionet e qytetarëve nga zyra e shërbimit të qytetarëve dërgohen në zyrën e drejtorit të drejtorisë, dhe drejtori i drejtorisë pasi që ti shikoj kërkesat, të njëjtat i dërgon tek zyrtarët përgjegjës, të cilët janë përgjegjës për trajtimin e atyre lëndëve. Unë si përgjegjës i këtij komisioni kam pranuar kërkesat, ankesat dhe peticionet e qytetarëve, ku gjatë shqyrtimit të

2019:233146

peticioneve të qytetarëve kemi vërejtur se aty kanë qenë 8 peticione, ku me këto peticione unë i kam njoftuar edhe anëtarët e komisionit, ku peticionet kanë arritur gjatë afatit të shqyrtimit publik, kurse ne i kemi trajtuar në komision pas përfundimit të afatit të shqyrtimit publik, peticionet kanë qenë të paraqitura brenda afatit të lejuar ligjor. Gjatë mbledhjeve të mbajtura me komisionin ku prezent ka qenë edhe përfaqësuesi i kompanisë konsulentë ‘ .....” e në disa takime ka qenë prezent edhe drejtori i urbanizmit, kemi bërë prezantimin e te gjitha kërkesave, ankesave dhe peticioneve të qytetarëve të cilat kanë arrit gjatë afatit të shqyrtimit publik, i cili ka përfshirë periudhën kohore pre dt. 25.03.2017 deri më dt. 26.04.2017. Procedura e trajtimit të këtyre peticioneve është zhvilluar në atë mënyrë që së pari janë lexuar peticionet në komision, përkatësisht është paraqitur përmbajtja e kërkesës, ankesës apo peticionit të palëve, përfaqësuesi i kompanisë konsulentë e ka pasur planin të cilin e ka prezantuar me projektor, ndërsa zyrtari të cilin e kemi angazhuar në kontratë mbi veprën si ekspert ose njohës i programit “GIZ”, në bashkëpunim me përfaqësuesin e kompanisë konsulentë i ka prezantuar para anëtarëve të komisionet, vërejtjet përkatësisht përmbajtjen e këtyre peticioneve të cilat i kanë propozuar, i kemi shqyrtuar dhe varësisht nga vendi se për ku ka qenë fjala, për cilën parcelë ose rrugë, zyrtari i caktuar për këtë punë e që në rastin konkret ka qenë P.A., e ka identifikuar vendin dhe pasi ne e kemi aprovuar, kompania konsulentë e ka regjistruar. Të gjitha kërkesat janë trajtuar veç e veç dhe për secilën kërkesë ose peticion është vendosur veç e veç, ku të gjithë anëtarët e komisionit kanë pasur mundësi të deklarohen për secilën kërkesë, përkatësisht peticion. Nuk më kujtohet që ndonjë anëtarë i komisionit është deklaruar kundër ndonjë kërkese apo peticioni në raport me vendimin e shumicës së anëtarëve të komisionit. Për mbajtjen e këtyre peticioneve kam mundur me i prezantuar edhe unë, por të njëjtat më tepër i ka prezantuar zyrtari P.A.. Peticioni i qytetarëve të rr. “Astrit Bytyqi”, të cilën e ka dorëzuar O.I. ka qenë që të mos të ndryshohet destinimi nga ndërtimi individual me afarizëm në ndërtimin e lartë. Peticioni tjetër i qytetarëve të rr. “Astrit Bytyqi” është dorëzuar nga A.K. të cilët kanë kërkuar që rr. “Astrit Bytyqi” dhe rr. “Hasan Prishtina” që të mbeten banim kolektiv, kurse peticioni tjetër i qytetarëve të rr. “Astrit Bytyqi” është dorëzuar nga I.Z. edhe ky ka kërkuar që ndërtimi në rr. “Astrit Bytyqi”, të jetë ndërtim kolektiv, po ashtu edhe peticioni tjetër i cili nuk është përfshirë në raportin e shqyrtimit publik ka qenë i dorëzuar nga F.Sh., ku ky peticion iu është adresuar në emër të zyrës së kryetarit të komunës M.S., kuvendit komunal dhe drejtorisë së urbanizmit i cili është paraqitur brenda afatit të shqyrtimit publik më dt. 14.04.2017. Gjatë fazës së shqyrtimit publik kjo kërkesë është trajtuar nga komisioni dhe është inkorporuar në PZHK, dhe me që ky peticion tek ne ka arritur përmes zyrës së kryetarit i cili pastaj e ka adresuar në drejtorinë e urbanizmit e nuk ka arritur në rrugën, përkatësisht në

2019:233146

mënyrën se si kanë arritur peticionet tjera përmes zyrës së shërbimit të qytetarëve, ne këtë peticion nuk kemi arritur me futur në raportin e shqyrtimit publik edhe pse të njëjtën e kemi trajtuar së bashku me të tjerat në afatin e lejuar të shqyrtimit publik. Këtë peticion ne si komision e kemi aprovuar. Ky peticion ka qenë pro ndërtimit të ulët ku qytetarët e këtij peticioni janë në rr. "Ali Asllani" por daljen e kanë në rr. "Astrit Bytyqi" të cilat rrugë lidhen në mes vete. Peticionet e A.K., I.Z. dhe O.B. ne i kemi shqyrtuar por si bazë për ndryshimin e destinimit nga ndërtimi i ulët në ndërtim të lart është marrë ana profesionale, me që rast peticionin e A.K. dhe I.Z. ne si komision e kemi aprovuar për shkak se ata kanë qenë pro idesë tonë kurse peticioni i O.B. është refuzuar për shkak se qytetarët e nënshkruar në atë peticion, kanë qenë kundër ndërtimit të lartë. Trajtimin e këtyre kërkesave e kemi bërë pasi që e kemi pasur obligim ligjor për ti trajtuar, edhe pse nuk kanë shërbyer si bazë për destinacionin e tokës nga ndërtimi i ulët në të lartë dhe anasjelltas. Kërkesat e qytetarëve të cilat i kemi pranuar brenda afatit ë shqyrtimit publik, në mënyrën siç e shpjegova më lartë, pasi i kemi shqyrtuar, i kemi njoftuar me vendimet e tona dhe ata përgjigjet i kanë marrë përmes raportit të shqyrtimit publik, i cili është publikuar në faqen zyrtare të komunës. Në shkrimet e parashtruesve të peticionit ne nuk i kemi verifikuar, dhe unë konsideroj se nuk ka qenë detyrë e jona për ta bërë verifikimin e tyre si komision i hartimit të draft planit zhvillimor. Ne na ka interesuar me tepër përmbajtja e peticioneve ose kërkesave dhe se nuk jemi lëshuar në verifikimin e të dhënave të tjera, siç janë datëlindja e tjerë, pasi që kemi pasur shumë kërkesa, rreth 114 kërkesa kanë qenë gjatë afatit të shqyrtimit publik dhe një numër i madh i kërkesave ka qenë që kanë arritur para afatit të shqyrtimit publik, ku në mesin e tyre ka qenë edhe peticioni i dorëzuar nga F.Sh. të cilin e edhe atë e kemi shqyrtuar por nuk ka hyrë në raportin e shqyrtimit publik për shkak se është ngatërruar me kërkesat të cilat kanë arritur para afatit të shqyrtimit publik.

Dëshmitari B.M. ndër të tjera deklaron: Unë në komunë në cilësinë e zyrtarit për dhënien e lejeve të ndërtimit punoj nga viti 2000. Për veç se si zyrtarë në vitin 2017 unë kamë qenë i angazhuar edhe në komisionin për mbikëqyrje të objekteve të ndërtuar nga ana e komunës. Unë kamë qenë edhe anëtar i komisionit për hartimin e draft planit Zhvillimor Komunal. Unë me sa e di nuk kam pranuar ndonjë vendim për emërimin tim në këtë komision. Unë kamë marrë pjesë në mbledhjet e këtij komisioni por nuk më kujtohet se sa herë kam marrë pjesë. Në këtë komision kanë marrë pjesë nga 1 anëtarë prej secilës drejtori të komunës, kurse nga drejtoria e urbanizmit thuajse kemi marrë pjesë të gjithë inxhinieret e arkitekturës dhe të ndërtimtarisë. Për takimet që i kemi mbajtur në komision na ka njoftuar menaxheri S.B..

2019:233146

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të këtij komisioni kanë qenë mbledhja e shënimeve në përgjithësi nga secila drejtori nga Drejtoria e Kadastrit, nga Drejtoria e Ekonomisë, nga Drejtoria e Shërbimet Socialë, nga Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Bujqësisë. Përveç mbledhjes së këtyre shënimeve komisioni për Planin Zhvillimor Komunal, ka shqyrtuar edhe disa peticione të qytetarëve. Peticionet e qytetarëve neve anëtarëve të komisionit na u kanë prezantuar gjatë mbledhjeve të komisionit. Më kujtohet që në mbledhjen e komisionit kemi shqyrtuar dy peticione ku njëri peticion me një numër të nënshkruesve prej 150 e disa personave kanë qenë për ndërtim kolektivë, kurse peticioni tjetër me numër të nënshkruesve rreth 60 persona kanë qenë për ndërtim individual. Peticionet e qytetarëve të paraqitura në mbledhjen e komisionit janë lexuar dhe në secilën seancë kemi diskutuar, ku secili anëtar i komisionit e ka dhënë mendimin e vet, por a janë marrë për bazë me rastin e hartimit të draft planit Zhvillimor Komunal unë këtë nuk po mundem me thënë se janë marrë për bazë. Unë nuk jam marrë drejtpërdrejti me planin urban, por mesa e di unë ana e djathtë e rrugës "Astrit Bytyqi", shikuar nga drejtimi i qytetit për në drejtim të magjistrales ka qenë për ndërtim kolektivë dhe mesa e di unë edhe ana e majtë tani është për ndërtim kolektivë, për shkak se kjo rrugë ka marrë prioritetin me rastin e daljes në rrugën magjistrale Ferizaj – Prishtinë. Kur kemi filluar hartimin e draft planit zhvillimorë komunal në fillim janë paraparë të dy anët e brezit të rrugës "Astrit Bytyqi" për banim kolektivë, pasi që u konsiderua si rrugë me prioritet, siç theksova më lartë për shkak të daljes në rrugën magjistrale Ferizaj – Prishtinë. Nënshkrimet e këtyre personave nuk i kemi verifikuar, pasi që anëtaret e komisionit kanë deklaruar se na nuk jemi hetues, andaj dhe ne nuk jemi lëshuar në verifikimin e këtyre nënshkrimeve dhe se nuk e kemi ditur se nënshkruesit e këtij peticioni a janë të gjithë të rrugës "Astrit Bytyqi" apo ka pasur edhe banues të rrugëve tjera. Nuk ka qenë lehtë të bëhet verifikimi i pronave të banuesve të asaj rruge, për shkak se ekziston mundësia që disa prona të mos jenë në emër të tyre. Unë personalisht nuk kamë kërkuar që të bëhet ndonjë verifikim. Gjatë punës sime në këtë komision kam qenë plotësisht i pa varur.

Dëshmitari I.M. ndër të tjera deklaron: Kam qene i angazhuar ne PZHK por jo 100%, për arsye se kam pas edhe obligime tjera në drejtorinë ku unë kam punuar. Vendimet në komision janë marrë me unanimitet, unë me profesion jam profesor i gjuhës frënge, dhe me këtë lëmi më tepër është marr kompania ..... Në mbledhjen e komisionit për shqyrtimin e peticioneve të qytetareve kam marr pjesë edhe unë. Unë në çdo mbledhje të komisionit kam marr pjesë me përjashtim të një rasti kur kam qenë në teren dhe jam vonuar për nja 10-15 minua dhe kur kam hyrë në zyrën ku është mbajtur mbledhja e kam nënshkruar listën e

2019:233146

pjesëmarrësve në mbledhje. Gjatë mbajtjes së mbledhjes së komisionit për shqyrtimin e peticioneve, me kujtohet rasti kur drejtori ka paraqitur një liste te personave të nënshkruar të cilët kanë kërkuar qe ne rrugën " "Astrit Bytyqi"", të bëhet ndërtim i lartë, pasi që në rrugët tjera është mundësuar qytetareve që të lëshojnë truallit e tyre për ndërtim të lartë dhe në këtë rrugë qytetarëve duhet të ju mundësohet një gjë e tillë, kurse mua nuk me kujtohet që ka pasur ndonjë listë tjetër kundër ndërtimit të lartë. Lista është prezantuar sikur lista e banoreve të lagjes. Unë nuk kam pasur njohuri se kush është i përfshirë ne atë listë, a janë të gjithë banor të lagjes – rrugës "Astrit Bytyqi" apo ka edhe banorë të lagjeve të tjera.

Arsyeshmërinë për hartimin e PZHK-së, e kanë bërë ekspertet e lëmisë së ndërtimtarisë, konsideroj se është marr për bazë mendimi i qytetareve por edhe arsyeshmëria profesionale për lejimin e ndërtimit të lartë të paraqitur nga ana e ekspertëve.

Draftin e projektit të PZHK-së, e kemi votuar vetëm herën e fundit, por data e saktë se kur është votuar nuk i kujtohet, në verifikim të nënshkrimeve nuk ka marr pjese, e të tjerët a kane bërë ndonjë verifikim unë nuk e din.

Dëshmitari deklaron se edhe në mbledhjen e komisionit të PZHK-së, të dt. 09.08.2017 është përmendur arsyeshmëria e propozimit për hartimin e draft planit Zhvillimor Komunal, në të cilin parashihet që në rrugën "Astrit Bytyqi" të bëhet ndërtimi i lartë.

Gjatë punës sime si anëtar i komisionit nuk kam pasur asnjëherë presion nga askush, as nga drejtori i urbanizmi dhe nga asnjë anëtar i komisionit, por kemi qenë plotësisht të pavarur rreth punës.

Dëshmitari B.I. ndër të tjera ka deklaruar: Me profesion jam jurist i diplomuar dhe që nga viti 2012 punoj në Komunë, në drejtorinë e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit. Në këtë drejtori posedojmë të dhëna për pronat publike, por në kuadër të kadastrit posedojmë të dhëna edhe për pronat private. Në komisionin e PZHK-së nga çdo drejtori kanë qenë nga një koordinator dhe nga dy anëtar të komisionit, ku unë kam qenë koordinator nga kjo drejtori, të cilën e kam përfaqësuar dhe nga kjo drejtori ka pasur për detyrë të ju ofroj të dhënat se ku gjenden pronat publike dhe atë për 43 zona kadasterale të cilat i ka Ferizaj. Për datat e takimit të komisionit të PZHK-së, na ka njoftuar menaxheri i projektit S.B., përmes e-mail ose telefonit dhe zakonisht unë kam marr pjesë në mbledhjet e këtij komisioni, por nganjëherë për shkak të volumit të madh të punëve nuk kam pasur mundësi me marr pjesë, por për këtë paraprakisht e kam njoftuar menaxherin e projektit. Në mbledhjet e komisionit sa dëshmitarit i kujtohet, drejtori i urbanizmit F.G. ka marr pjesë vetëm një ose dy here. Për hartimin e Planit Zhvillimor

2019:233146

Komunal ka qenë e caktuar kompania e quajtur “.....”, Në mbledhjet e komisionit, anëtarët e komisionit fillimisht kanë nënshkruar një listë për konfirmimin e pjesëmarrjes në mbledhje, e pastaj kanë dëgjuar këshillat e kompanisë konsullente “.....”, e pastaj edhe anëtarët e komisionit kanë filluar të debatojnë dhe t’i japin propozimet e tyre për hartimin e draftit të PZHK-së, ku më tepër lidhur me këtë është marrë Drejtoria e Urbanizmit, e cila është më profesionale lidhur me këtë çështje. Të dhënat të cilat i ka kërkuar kompania “.....” koordinatorët e drejtorive kanë qenë të obliguar me ja siguruar dhe prezantuar.

Dëshmitari thekson se në mbledhjen e komisionit është punuar në atë mënyrë që pasi menaxheri i këtij komisioni S.B. dhe përfaqësuesit e kompanisë kosullente “.....” si dhe drejtoria e urbanizmit si më profesionale i kanë dhënë propozimet e tyre, ne anëtarët e komisionit pasi jemi pajtuar, pas përfundimit të mbledhjes, i kujtohet dëshmitarit kur menaxheri i projektit S.B., i cili rregullisht i ka ftuar koordinatorët e drejtorive përkatëse dhe në zyrën projektuese, në katin e IV të objektit të Komunës e ka nënshkruar dokumentin për draftin e PZHK, i cili pastaj edhe iu është prezantuar kuvendit komunal. Gjatë mbledhjeve të komisionit nuk i kujtohet se a janë shqyrtuar peticionet e qytetarëve. Thekson se nuk e ka lexuar dokumentin të cilin e ka nënshkruar, por para se me nënshkruar e ka pyetur menaxherin e projektit S.B., i cili pasi gojarisht i ka treguar se për çka bëhet fjalë, atëherë dokumentin e ofruar e ka nënshkruar. I kujtohet që ka marr pjesë në debate publike dhe i kujtohet kur në një debat publik kanë prezantuar edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Dëshmitarja H.M. ndër të tjera ka deklaruar se punon në drejtorinë e Bujqësisë që nga viti 2003. Me vendimin e kryetarit të Komunës me dt. 15.03.2016 nga drejtoria e bujqësisë jam caktuar si koordinatore për hartimin e draftit të Planit Zhvillimor Komunal. Në hartimin e draftit të PZHK në shumicën e takimeve të komisionit, nga drejtoria e bujqësisë për prezantimin e të dhënave nga kjo drejtori kam marr pjesë unë, por nganjëherë kur kam qenë shumë e ngarkuar me punë, nga kjo drejtori më kanë zëvendësuar edhe dy kolegët e mi, të cilët edhe ata me profesion janë agronom. Thekson se gjatë takimeve të komisionit nuk kam dëgjuar për kundërshtime dhe për peticione të paraqitura lidhur me hartimin e draftit të PZHK-së, meqë mua më ka interesuar vetëm lamia e bujqësisë të cilën e kam përfaqësuar. Ka ndodhur që kemi mbajtur takim vetëm për çështjen e drejtorisë së bujqësisë me qëllim të dhënies dhe prezantimit të shënimeve për hartimin e draftit të PZHK-së nga lëmia e bujqësisë, e pastaj kemi përpiluar raport Sektorial në të cilin raport e kemi dhënë mendimin tone profesional dhe në mënyrë elektronike ia kemi dorëzuar menaxherit të projektit S.B., i cili na ka ftuar në këto takime

2019:233146

përmes emailit, e pastaj çka u veprua lidhur me këto raporte nuk e dinë. Gjatë takimeve të komisionit të PZHK-së, thekson se kemi nënshkruar një listë për konfirmimin e pjesëmarrjes në këtë komision, por nuk i kujtohet se a kanë nënshkruar në fillim apo në fund të takimit, e meqë ka kaluar një kohë e gjatë dëshmitares nuk i kujtohet as çështja e peticioneve. Dëshmitarja e konfirmon nënshkrimin e saj në procesverbalin e mbledhjes së komisionit të dt.09.08.2017.

Dëshmitari M.I., ndër të tjera ka deklaruar: Gjatë vitit 2016 kam punuar në Drejtorinë e Financave të komunës së Ferizajt. Me vendim të kryetarit të komunës nga drejtoria e financave unë jam caktuar si koordinator në komisionin për Planin Zhvillimor Komunal. Thekson se në 85% të rasteve ka marr pjesë në mbledhjet e komisionit, ku në këto mbledhje ka pasur me i prezantuar të dhënat nga drejtoria e financave të cilën e ka përfaqësuar dhe në këto mbledhje janë diskutuar edhe çështje të tjera që nuk kanë të bëjnë me drejtorinë e financave. Ne kemi qenë të obliguar që menaxherit të projektit S.B. të ia ofrojmë të dhënat nga sektorët përkatës. Sa i përket shqyrtimit të peticioneve për lagjen "Astrit Bytyqi", thekson se na ka ardhur një parashtresë, por unë me atë parashtresë nuk jam marrë. E konfirmon se nënshkrimi në procesverbalin e mbledhjes së komisionit të datës 09.08.2017 është i tij.

Dëshmitari A.I. ndër të tjera deklaron: Jetoj në rrugën "Astrit Bytyqi" nr. ... në Ferizaj. Unë përveç familjes time nuk kam dalë me mbledhë nënshkrime nga personat e tjerë. A.... dhe F.... të cilin nuk e njohë nuk kanë dalë për të mbledhur nënshkrime, fletët e peticionit unë i kam pasur në dorë, por në ato fleta kur unë i kam marrë kanë qenë të nënshkruar vetëm familja ime dhe atë: unë A.I., M.I., I.I dhe M.I., kurse anëtarët tjerë nuk kanë nënshkruar se nuk kanë pasur kurorëzim. Unë nuk e di se a kanë nënshkruar edhe banorët e rrugëve tjera por nuk e di a kanë nënshkruar edhe banoret e rrugicave të rrugës "Astrit Bytyqi". Unë fare nuk kam dalë për të mbledhur nënshkrime dhe nuk kam njohuri se a kanë nënshkruar banoret e rrugicave tjera.

Kur prokurori i shtetit i prezanton dëshmitarit peticionin – listën e nënshkrimeve duke e pyetur dëshmitarin a është dukur kështu lista në të cilën ju keni nënshkruar? Dëshmitari deklaron po kjo ka qenë lista në të cilën kemi nënshkruar unë me familjen time,

Dëshmitari e pranon përmbajtjen e tekstit të peticionit të dorëzuar në Komunë dhe atë pjesën e dytë në të cilën thuhet: " duke pasur parasysh faktin se me draft planin zhvillimor në rrugën Rexhep Bislimi dhe rr. Vëllezërit Gërvalla është paraparë ndërtim i lartë nuk e shohim asnjë arsye që edhe rruga "Astrit Bytyqi" mos të ketë të njëjtin tretman në veçanti pas lidhjes që

2019:233146

është bërë me magjistralen Prishtinë Ferizaj është bërë rrugë shumë atraktive dhe interesimi i shumë ndërtuesve është shumë i madh dhe për ne është një shans e mirë për ta ngritur vlerën e pronës tonë".

Dëshmitari B.A. ndër të tjera deklaron: Peticionin të cilin e kam nënshkruar në fillim më sa më kujtohet e ka sjellë i dëmtuari I.H. dhe sa më kujtohet të njëjtin e kam nënshkruar me qëllim të kundërshtimit të ndërtimit të lartë, këtë peticion e kam nënshkruar vetëm unë, kurse anëtaret tjerë të familjes nuk e kanë nënshkruar, kurse sa i përket vëllait tim E.A. unë nuk jam në dijeni a e ka nënshkruar apo jo. Më vonë unë të njëjtin nënshkrim e kam tërheq. Tërheqjen e nënshkrimit e kam bërë për arsye se pasurinë e cila figuron në emrin tim e kam bartur në emër të fëmijëve dhe tërheqjen e kam bërë që në të ardhmen fëmijët të vendosin vetë se a janë pro ndërtimit të lartë apo të ulët dhe se fëmijët e mi nuk do të pengojnë çfarëdo ndërtimi që të bëhet. Vendimin për tërheqjen e nënshkrimit e kam bërë vetë pa imponimin e askujt. Këtë e kam bërë pasi kam biseduar me anëtaret e familjes time të cilët më kanë thënë se për neve nuk ka pengesa çfarëdo ndërtimi që të bëhet. Unë përveç anëtarëve të familjes për tërheqjen e nënshkrimit tim nuk kam biseduar me askënd tjetër. Unë e di që kam nënshkruar për tërheqjen e nënshkrimit tim i cili ka qenë kundër ndërtimit të lartë. Pas tërheqjes së nënshkrimit tek unë askush nuk ka qenë për të më thënë pse e tërheqë nënshkrimin.

Në parcelën ku e kam të vendosur shtëpinë unë edhe sot nuk e di a është i lejuar ndërtimi i lartë apo jo sepse siç theksova më lartë këtë pasuri e kam bartë në emër të fëmijëve dhe nuk merrem më me të.

Sa i përket tekstit të deklaratës që e kam nënshkruar për tërheqjen e nënshkrimit këtë e kemi përpiluar unë së bashku me vëllain tim E.... dhe tërheqjen e nënshkrimit që e kemi dhënë kundër ndërtimit të lartë unë e kam bërë pa pasur presion nga askush, pa trysnin apo detyrimin e askujt, por këtë e kemi bërë së bashku me vëllain tim E.... me iniciativën dhe vullnetin tonë për arsyet e theksuara më lartë.

Dëshmitari I.B. ndër të tjera ka deklaruar: Punon në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, drejtor i kësaj drejtorie në vitin 2016-2017 ka qenë N.F.. Kam qenë i propozuar nga drejtoria ime si anëtar i komisionit të PZHK-së dhe kamë pasur për detyrë të jem përfaqësues i trashëgimisë kulturore. ku bëhet lista e objekteve në mbrojtje, lokalitetet e trashëgimisë kulturore etj. Në mbledhjet e komisionit të Planit Zhvillimor Komunal kam marrë pjesë kur është diskutuar për lokalitetet e trashëgimisë kulturore, monumenteve etj. dhe në ato mbledhje të komisionit unë vetëm kam dhënë propozime, por a është marrë ndonjë vendim nuk jam në

2019:233146

njohuri. Në mbledhjet e komisionit të PZHK-së kam marr pjesë deri në gjysmën e prillit të vitit 2017, sepse pastaj kam qenë i angazhuar në përgatitjet e ditës ndërkombëtare të muzeut e cila është mbajte me 18 maj 2017. Mua më kujtohet një herë kur S.B. më ka ofruar një dokument të cilin e kam nënshkruar dhe kam menduar se është një dokument përmbyllës të PZHK-së, dhe listë pjesëmarrëse të anëtarëve të Komisionit të PZHK-së.

Në vazhdimin e pyetjeve dëshmitari deklaron: kam menduar se ka të bëjë vetëm me trashëgimi kulturore dhe nuk e kam ditur se do të merren vendime tjera në mbledhjen e komisionit të PZHK-së, dhe pasi e kam pranuar ftesën e policisë e kam kuptuar se nuk ka qenë nënshkrimi im vetëm në listën e pjesëmarrësve të mbledhjes së komisionit por ka qenë diçka tjetër, ku ata më kanë thënë se ka të bëjë me ndërtimet në rrugën "Astrit Bytyqi", pastaj unë kamë bërë një kërkesë zyrtare për distancim të nënshkrimit tim me arsyetim se nuk kam dashur me qenë pjesë e këtyre planeve për ndërtim. Nënshkrimin e ati dokumenti e kam bërë në zyrën e S.B. dhe atë pasi ai më ka ftuar përmes telefonit unë kam shkuar dhe e kam nënshkruar ku kemi qenë prezent vetëm unë dhe ai.

Kërkesën për tërheqjen e nënshkrimit e kam bërë me dt. 13.06.2017. Pas tërheqjes së nënshkrimit nga ana ime, më tutje në mbledhjet e komisionit për PZHK-ë asnjë herë nuk kam marrë pjesë, por as nuk kam qenë i ftuar për të marrë pjesë.

Nga Drejtoria e kulturës ka qenë i caktuar me marrë pjesë A.H., por i njëjti në atë kohë ka shkuar në Kanada atëherë unë e kam zëvendësuar me kërkesën e Drejtorit të Kulturës dhe më kujtohet në një rast që kam qenë me një takim pune që është mbajtur në Durrës, ku kanë qenë rreth 100 pjesëmarrës dhe është diskutuar për gjelbërimin, kulturën, shëndetësinë, të gjitha këto që duhet të përfshihen në PZHK-në?

Dokumentin të cilin e kam paraqitur për tërheqjen e nënshkrimit me dt. 13.06.2017 unë e kam përpiluar vetë dhe është i shënuar me laps kimik dhe kjo vlen për nënshkrimin që e kamë dhënë me datën 30.05.2017 kurse sa i përket datës 09.08.2017 në këtë listë nuk figuron nënshkrimi im për arsye se unë nuk kam marrë pjesë në këtë mbledhje.

Dëshmitarja L.Z. ndër të tjera deklaron: Që nga viti 2012 punon në Drejtori të infrastrukturës në Ferizaj në punët mbikëqyrëse infrastrukturore.

Plani Zhvillimor është bërë në vitin 2016 dhe unë si anëtare e Komisionit të PZHK-së jam emëruar në vitin 2016, nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe atë nga drejtori i kësaj Drejtorie – G.I..

2019:233146

Thekson se ka marr pjesë disa herë në mbledhjet e komisionit të PZHK-së dhe është nënshkruar në evidencën e pjesëmarrjes. Në mbledhjen e komisionit kanë qenë të obliguar të marrin pjesë të gjithë koordinatorët e drejtorive përkatëse, ku secila Drejtori ka qenë e përfaqësuar nga një koordinator, ku në këto mbledhje më tepër i ka interesuar veprimtaria e drejtorisë të cilën e ka përfaqësuar, kurse nuk i kujtohet se a ka votuar ndonjëherë për ndonjë vendim, meqë kanë kaluar tri vite dhe ka harruar.

Në mbledhjet e këtyre komisioneve gjithashtu nuk i kujtohet se a janë shqyrtuar ndonjëherë peticionet e qytetarëve. Kanë qenë vetëm dy peticione, njëri ka pas numër më të madh 159 nëse nuk gaboj, ndërsa peticioni tjetër ka pas numër 143 nëse nuk gaboj. Këto peticione janë hap nga paneli aty, ku ka qenë prezent kompania konsulentë “.....”.

Personalisht thekson nuk i ka shikuar peticionet e paraqitura nga qytetarët, por ato i ka vërejtur nga distanca të cilat kanë qenë me numra personal dhe me nënshkrime. Nuk i kujtohet se çka është bërë me këto peticione dhe nuk e din se a janë aprovuar apo janë refuzuar.

E din se ka nënshkruar njëherë një procesverbal për pjesëmarrjen në atë mbledhje, kurse herëve të tjera nuk ka nënshkruar për arsye se ka qenë në pushim vjetor.

Në muajin tetor të vitit 2016, kemi pasur një punëtori në Durrës, ku aty kemi marr pjesë të gjithë anëtarët e komisionit, numri i saktë nuk më kujtohet, por e di se kemi qenë nga të gjitha drejtoritë dhe gjatë punës në këtë punëtori secila drejtori ka paraqitur propozimet të cilat duhet të inkorporohen në PZHK.

Dëshmitari E.A. ndër të tjera deklaron: Jeton në Ferizaj në rrugën “Astrit Bytyqi”, rrugica “.....”. Në vitin 2016 e dinë që ka nënshkruar një peticion i cili ka qenë kundër ndërtimit të lartë, por kush ia ka ofruar atë peticion me e nënshkruar nuk e njehë. Peticionin e ka nënshkruar në oborrin e shtëpisë, në peticion nuk e di se çka ka pasur vetëm e din se e ka nënshkruar emrin e vetë, këtë e kam bërë me vetëdije. Pas nënshkrimit të këtij peticioni kur e ka parë që ka reagime të ndryshme, ku disa kanë qenë kundër ndërtimit të lartë por ka pasur edhe pro ndërtimit të lartë dhe mosha, e ka preferuar që të mos jetë në asnjërën anë, përkatësisht për me qenë neutral, as për ndërtim të lartë e as kundër ndërtimit të lartë, ka bërë tërheqjen e nënshkrimit që e ka vendosur në peticionin i cili ka qenë kundër ndërtimit të lartë. Tërheqjen e nënshkrimit e ka bërë në polici, së bashku me vëllain e tij B..... Thekson se nuk i ka thënë askush se në zonën ku jeton nuk do të ketë ndërtim të lartë, por as nuk është interesuar se në atë zonë a do të ketë ndërtim të lartë e as nuk ka shkuar në Komunë për të u interesuar se a do të ketë në zonën ku jeton ndërtim të lartë apo jo. Kur e ka tërhequr nënshkrimin nuk ka

2019:233146

plotësuar deklaratë, por gojarisht në polici e ka tërhequr. Në polici deklaratën e ka dhënë të njëjtën ditë së bashku me vëllain B.A..

Më tutje dëshmitari deklaron se deklaratën e ka nënshkruar vetë me vullnetin e tij pa presion dhe pa e bindur askush. Me tërheqjen e këtij nënshkrimi gjithçka ka përfunduar dhe më tutje nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim lidhur me ndërtimet e larta në rrugën "Astrit Bytyqi".

Thekson se nuk kam qenë as për ndërtim të lartë dhe as kundër ndërtimit të lartë, meqë shtëpitë në të cilat tani jetojmë janë në emër të djemve tanë dhe se unë nuk kam arsye të deklarohem pro dhe as kundër ndërtimit të lartë, dhe për këtë e kemi lënë të vendosin pasardhësit tanë, meqë edhe prona ka qenë në emër të djemve tanë edhe në kohen kur e kemi tërhequr nënshkrimin.

Dëshmitari M.H. ndër të tjera deklaron: Punon në drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit, ku këtu është një drejtori por unë jam udhëheqës i sektorit të Mjedisit. Në këtë drejtori punoj që nga viti 2000, gjatë vitit 2016 unë kam qenë pjesë e Komisionit për hartimin e planit Zhvillimor Komunal ku unë kam pasur për detyrë të kujdesem për çështjen e mjedisit, kam pasur për detyrë me e dorëzuar raportin sektorial për çështje mjedisore. Sipas nevojës kam marrë pjesë në mbledhjet e komisionit për hartimin e planit Zhvillimor Komunal, por secili përfaqësues i drejtorisë ka pasur me e dhënë kontributin në lëminë e vetë aq sa është kërkuar nga ai. Unë kam marrë pjesë në mbledhje kur janë shqyrtuar edhe ndonjë propozim. Në fillim çdo drejtori i ka dorëzuar propozimet e veta pas konsultimeve me kompaninë konsulente ".....", derisa drafti i Planit Zhvillimor Komunal ka marrë një formë të prerë, i cili draft është përcjell në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të cilët edhe ata kanë qenë të obliguar në cilësinë e eksperteve me i dhanë vërejtjet, sugjerimet dhe mendimet e veta, ku i njëjti është kthyer nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e pastaj ka kaluar në mbledhje e Kuvendit Komunal i cili edhe është aprovuar. Raportin sektorial unë e kam paraqit si tërësi për Komunë të Ferizajt e jo vetëm për ndonjë zonë të caktuar. Shumë vonë kam kuptuar që ka pasur pakënaqësi rreth Planit Zhvillimor Komunal për Zonën e 8-të, ku përfshihet rruga "Astrit Bytyqi". Unë kam marrë pjesë në shqyrtimin e peticioneve të paraqitura nga qytetarët ku disa prej tyre kanë qenë për ndërtim të lartë kurse disa kanë qenë kundër ndërtimit të lartë dhe unë kam kuptuar se më tepër kanë qenë për ndërtim të lartë. Personalisht ato peticione nuk i kam pasur në dorë, por aty në mbledhje është diskutuar lidhur me këto peticione, por nuk më kujtohet se kush ka folur në mbledhje, mirëpo është diskutuar se pjesa dërmuese e asaj lagje janë për ndërtim të lartë. Mua në detale nuk më kujtohet se si është dhënë miratimi a është votuar apo jo, veç e dijë që në çdo mbledhje ku kemi marrë pjesë kemi pasur një formë që jemi

2019:233146

nënshkruar, ashtu që edhe në kohen kur është dhënë pëlqimi për draftin e planit Zhvillimor Komunal sigurisht që kemi nënshkruar. Në Drejtorinë e Urbanizimit ka marrë pjesë edhe menaxheri i komisionit për PZHK-ë S.B. por siç theksova më lartë në mbledhjen e hartimit të PZHK-së, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të drejtorive tjera. Unë e kam paraqit gjendjen reale të komunës lidhur me çështjen e mjedisit, dhe ajo që është vendosur në PZHK-në nga ana ime është edhe si rezultat i punës time që kam zhvilluar në teren.

Dëshmitari I.M., ndër të tjera deklaron: Tash jam në pension, ndërsa gjatë vitit 2015-2017 kam punuar në Komunë në Drejtorinë për Mirëqenie Sociale. Përveç punës që e kam pas kam qenë edhe anëtar i komisionit PZHK-së, koordinator i sektorit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, detyrat e mia kanë qenë që të kem përgjegjësi vetëm për sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në drejtim të planit të PZHK-së. Parimisht ne çdoherë jemi takuar me anëtarët e sektorit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, dhe ata i kanë paraqitur nevojat për planin 8 vjeçar, nevojat e infrastrukturës për shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Kam marrë pjesë në disa takime me anëtarët e tjerë të komisionit të PZHK-së. Në takimet që kam marrë pjesë me siguri edhe jam nënshkruar si pjesëmarrës, e sigurisht e kam nënshkruar edhe raportin përfundimtar të komisionit për PZHK, i cili është dërguar për aprovim në Kuvend. Para nënshkrimit të këtij raporti unë kam paraqitur edhe raportin tim nga sektori i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në të cilin kanë qenë të përshkruara aktivitetet e ardhshme të sektorit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale për periudhën e ardhshme 8 vjeçare. E di se unë e kam nënshkruar një raport i cili më është ofruar, por nuk më kujtohet i cilës datë ka qenë. Raportin përfundimtar të cilin e kam nënshkruar i cili është dërguar për aprovim në kuvend më është dërguar përmes emailit tim, ku në atë raport unë i kam lexuar të dhënat që kanë të bëjnë lidhur me sektorin tim të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Aty në atë raport kanë qenë të përfshira të gjitha vërejtjet dhe propozimet që unë i kam dhënë në kuadër të drejtorisë sime. Sa për sqarim, shton se aty në raport kanë qenë të përfshira ndërtimi i një qendre për punë sociale, i një qendre tranzitore për fëmijët në situatë rruge, një shtëpi për të moshuarit, një qendër mjekësore në periferi të qytetit sa më kujtohet ka qenë për rrugën "Kadri Zeka", dhe gjatë hartimit të atij plani Zhvillimor Komunal sa i përket sektorit tonë ne nuk kemi pasur vërejtje, por nuk kemi pas as ankesa nga ana e qytetarëve dhe unë kam qenë i pajtimit për aprovimin e atij plani Zhvillimor Komunal të cilin edhe e kam nënshkruar.

Dëshmitari A.R. ndër të tjera deklaron: Gjatë vitit 2017 personalisht mua nuk më është dorëzuar ndonjë peticion për tu nënshkruar, ku edhe tani në ketë sallë nuk ka ndonjë person i cili ka biseduar me mua për rr. "Astrit Bytyqi".

2019:233146

Dëshmitari pas shikimit në peticionin e ofruar nga prokurori i shtetit deklaron: nënshkrimi që figuron në këtë peticion nuk është i imi por mund të jetë i dikujt nga familjarët e mi.

Thekson se prona ime ku është e ndërtuar shtëpia nuk ka dalje në rr. "Astrit Bytyqi" por lidhet me rr. "Kadri Zeka", po ashtu ka një oborr rreth 10 ari që kufizohet me rr. "Kadri Zeka" dhe "Hasan Prishtina". kurse një pronë tjetër rreth 70-80 ari është në mes pronave tona që na lidh me rrugën "Hasan Prishtina".

Pohon se këtë formë të peticionit nuk e kam parë asnjëherë dhe nuk më është ofruar asnjëherë për nënshkrim. Supozon se dikush nga familjarët e tij, ka mundur që të nënshkruaj në këtë peticion në bazë të asaj që të dhënat e mia duke përfshirë edhe numrin personal munden me i ditur vetëm anëtarët e familjes sime e askush tjetër.

Mua nuk më ka kontaktuar asnjë person, as para nënshkrimit e as pas nënshkrimit për të më informuar lidhur me peticionin, dhe unë nuk kam informata të sakta se kah ka ardhur nënshkrimi im në këtë peticion.

Deklaron se në muajin prill 2017 ka jetuar në bashkësi familjare vetëm me prindin, sepse vëllezërit i ka jashtë shtetit që 10 vite dhe ka mundur këtë peticion ta nënshkruar vetëm prindi, sepse përveç prindit të dhënat e mia personale nuk i ka ditur tjetër kush.

Unë nuk kam biseduar me ndokënd lidhur me ndërtimin e lartë apo të ulët, pra përveç me babain tim me të cilin kemi rënë në dakord që në rast se vije deri tek lejimi i ndërtimit të lartë, jemi pajtuar që pronën tonë ta japim për ndërtim të lartë.

Dëshmitari F.L., i cili është dëgjuar me propozimin e palëve të dëmtuara ndër të tjera deklaron: Personat F.G. dhe A.K. i njoh, pasi që A.... e kam fqinjë ndërsa F.... e njoh si figurë publike. Në vitin 2016 ose 2017 nuk kam pasur asnjë bashkëpunim me F.G. dhe A..... Rruga "Sterio Spase" është rrugicë e rrugës "Astrit Bytyqi" dhe në këtë vend unë jetoj që nga viti 1985 ku më parë edhe rruga "Sterio Spasse", nuk ka ekzistuar por e njëjta është quajtur "Astrit Bytyqi". Prona ime të cilën unë e posedoj gjendet në rrugicën "Sterio Spasse" e cila rrugicë lidhet me rrugën "Astrit Bytyqi", ku hyrjen dhe daljen e ka në "Astrit Bytyq". Unë në vitin 2017, nuk kam dorëzuar ndonjë peticion në komunë, kurse ankesa dhe kërkesa të miat personalë kam paraqitur në komunë.

Unë jam nënshkrues i peticionit për ndërtim të lartë për zonën e 8 të qytetit, ku aty kam nënshkruar pasi që kam llogaritur se është e drejtë kushtetuese e imja dhe e qytetarëve të tjerë

2019:233146

që të deklarohen se a janë pro apo kundër ndërtimit të lartë në atë zonë. Në zonën e 8 unë konsideroj që përfshihet edhe rruga "Astrit Bytyqi", nuk e di a është aprovuar kjo kërkesë në të cilën kam nënshkruar unë. Unë nuk kam njohuri që vendi ku gjendet shtëpia ime a është shndërruar në ndërtim të lartë apo jo. Siç theksova më lart jam nënshkrues i peticionit për ndërtim të lartë për zonën 8 në të cilën përfshihet e gjithë sipërfaqja prej rrugës së Gjilanit e gjer këtu ku jemi tash tek objekti i Gjykatës, do të thotë sipas meje zona e 8 përfshin tërë pjesën lindore të qytetit, e jo vetëm rrugën "Astrit Bytyqi" dhe se unë që nga fillimi kam qenë pro ndërtimit të lartë, dhe këtë e kam bërë për shkak të interesave të mija personale të zhvillimit të biznesit në pronat të cilat i posedoj në këtë zonë. Unë nuk jam marrë me çështjen se a janë aprovuar kërkesat e mia të cilat i kam paraqitur në komunë apo janë refuzuar. Unë nuk kam njohuri se a ka pasur peticione edhe kundër ndërtimit të lartë në zonën e 8 të qytetit.

Dëshmitari deklaron se në këtë regjistër figuron emri im F.L. në numrin rendor 25 ku dhe konfirmon se është nënshkrimi i tij dhe ka nënshkruar për zonën e 8 për ndërtimin e lartë në të cilën zonë përfshihet edhe rruga "Astrit Bytyqi".

Thekson se mbledhjen e nënshkrimeve të të tjerëve të cilët figurojnë në listën e nënshkrimeve nuk e ka bërë. Nuk i njohë të gjithë banorët në rrugën "Astrit Bytyqi", andaj për personat të cilët janë në këtë regjistër nuk mundem me u deklaruar se a janë banorë të asaj rruge apo nuk janë. Në këtë regjistër figuron emri im dhe i bashkëshortes time të cilët kemi nënshkruar. Tekstin e peticionit në falë thekson nuk e ka bërë, por gojarisht me A.K. kemi biseduar si bëhet një peticion, dhe për këtë unë nuk jam përpilues i këtij peticioni. Gjithashtu nuk kam njohuri se kush e ka përpiluar tekstin e këtij peticioni. Draft planin Komunal e kam analizuar sa i përket pronave të mia, dhe peticionin e kam nënshkruar në interesin e pronave të mia. Unë nuk i kam dorëzuar A.K. ndonjë dokumentacion të përpiluar blanko me qëllim të mbledhjes së nënshkrimeve. Nuk kam dëgjuar nga askush që ky dokumentacion është i falsifikuar apo i manipuluar. Mua nuk më kujtohet që i kam dhënë F.I. ndonjë dokument bllanko me qëllim të mbledhjes së nënshkrimeve. Gjithashtu nuk më kujtohet që F.I. ka mbledh nënshkrime dhe mi ka dorëzuar mua. Unë nuk kam pasur njohuri se peticioni i kujt është aprovuar apo peticioni i kujt është refuzuar.

Dëshmitari F.I., i cili është dëgjuar me propozimin e palëve të dëmtuara, ndër të tjera deklaron: Unë jetoj në rrugën ..... dhe nuk kam asnjë pronë timen në brezin e rrugës "Astrit Bytyqi". Unë këtë peticion nuk e kam pasur në dorë, por nënshkrimet e këtij peticioni unë i kam mbledh dhe këto kanë qenë për zonën e 8-të të qytetit e jo për rrugën "Astrit Bytyqi". Të nënshkruarit në këtë peticion janë S.F. me anëtarët e familjes së vetë, ku unë

2019:233146

bashkëshorten e S.... e kam teze dhe K.... e N..... janë fëmijët e tyre. Këta persona i kam fqinjë, vetëm megja na kufizon dhe nënshkrimet e tyre unë i kam mbledh për ndërtimin e lartë në zonën e 8, ku aty përfshihet edhe shtëpia ime dhe e këtyre personave, e jo për rrugën "Astrit Bytyqi". Personat që i ceka më lartë jetojnë në rrugën ..... Unë i kam mbledh nënshkrimet edhe te vëllai im A.I., H.I. V.I. E.I. dhe D.I., edhe këta nuk jetojnë në rrugën "Astrit Bytyqi" por janë në megjë me mua. Përveç këtyre të cekurve më lartë unë i kam mbledh nënshkrimet edhe prej këtyre personave: N.G. (bashkëshorti i tezes) M.G. (tezja ime), G.G. (djali i tezes) dhe D.G. (vajza e tezes), edhe këta persona jetojnë në rrugën "..... në një largësi 50-100 m nga shtëpia ime. Këtë listë për mbledhjen e nënshkrimeve e kam marrë nga F.L. dhe pasi i kam mbledh nënshkrimet i ja kam dorëzuar F..., unë nuk e di kush i ja ka dhanë F.....këtë regjistër. F.... unë e kam burrë të motrës. A.... e kam njohur vetëm si kojshi dhe nga ai unë nuk kam mbledhë nënshkrime. Pasi i kam mbledhë nënshkrimet këtë regjistër F... ja kam lënë në dorë. Përveç këtyre personave këtë peticion e ka nënshkruar edhe B.A. dhe babi i saj S.A., me që B... kishte qenë te prindërit e vetë dhe e ka nënshkruar peticionin pro ndërtimit të lartë. B.A. jeton në rrugën ....., te banesa e ..... kati i dytë ose i tretë. Unë për rrugën "Astrit Bytyqi" nuk kisha mbledhë nënshkrime se nuk kisha përfitua asgjë. Kur i kam dorëzuar nënshkrimet e mbledhura nuk kam ndal asnjë kopje dhe e di që F.... ja kam dhënë këtë listë tek shtëpia ime, nuk e di sa ka qenë numri i listave por unë e di që vetëm personave të cekur më lart jua kam mbledhë nënshkrimet. Pas dorëzimit të këtyre listave asnjëherë nuk jam njoftuar lidhur me vendimin rreth këtyre nënshkrimeve, nga askush po as nga F..... Unë mund të them se edhe sot jam pro ndërtimit të lartë për pronat e mia.

Dëshmitarja B.A. ndër të tjera ka deklaruar: Jetonë në rr. "...." në Ferizaj, ku aty është e martuar, por prindërit e saj vendbanimin e kanë në rrugën "Kadri Zeka", rrugica "....". I kujtohet se gjatë vitit 2017 një fqinjë i saj i quajtur F.I. i ka ofruar një letër për të nënshkruar dhe ajo për shkak të mërzisë për vdekjen e nënës nuk e ka pyetur fare dhe e ka nënshkruar dokumentin e ofruar, pa e shikuar fare se çka është duke nënshkruar. Pas dy jave, pasi ka dal me pi kafe, ka kuptuar se për çka ka qenë çështja e letrës që e ka nënshkruar, pasi është folur për ndërtime të larta dhe meqë nuk ka qenë duke banuar në adresën ku ka lindur, ka dashtë me tërheq nënshkrimin, por askund nuk ka shkuar për ta tërhequr nënshkrimin, vetëm kur e kanë thirr policia ka deklaruar se po donë me tërheqë nënshkrimin. Letrën që ia ka ofruar F.I. përveç saj, me sa i kujtohet e ka nënshkruar edhe babi i saj.

2019:233146

Dëshmitari F.G.1., i cili është dëgjuar me propozimin e palëve të dëmtuara ndër të tjera ka deklaruar: Unë kam qenë kryesues i Kuvendit Komunal nga muaji janar i vitit 2015 deri në dhjetor të vitit 2017. Detyrat dhe përgjegjësit e mia si Kryesues i KK-së kanë qenë që së bashku me kryetarin e Komunës fillimisht i kemi caktuar pikat e rendit të ditës, ashtu që secili drejtor i ka propozuar pikat, dhe pasi janë dorëzuar në kuvend, ne së bashku me kryetarin i kemi shqyrtuar dhe i kemi qitur në kuvend. Prej propozimit të paraqitur nga drejtoria deri sa i kemi qitur në kuvend këto pika, kanë zgjatur 7 ditë derisa ju kemi dërguar ftesat anëtarëve të kuvendit dhe anëtarëve të komitetit për politik dhe financa. Së bashku me ftesat anëtarëve të kuvendit ju dërgohet edhe materiali i rendit të ditës. Të gjitha vendimet e marra nga koha e emërimit tim si Kryesues i Kuvendit nuk ka pasur mundësi assesi me i nënshkruar askush përveç meje. Çdo vendim i nënshkruar nga unë e ka pasur numrin e vetë të protokollit, dhe nuk ka pasur mundësi që me një numër të protokollit të lëshohen shumë vendime.

Dëshmitari deklaron se nuk ka mundësi kurrfarë vendimi që të falsifikohet për arsye se të gjitha seancat e kuvendit monitorohen drejtpërdrejt prej Ministrisë së Pushtetit Lokal, çka do të thotë se në kohën kur është mbajt seanca, ajo është përcjellë përmes monitorit nga ana e Pushtetit Lokal dhe ka ndodhë që ai që e ka përcjellë seancën, më ka shkruar në telefon dhe më ka thënë, kryesues mos e merrni këtë vendim se është në kundërshtim me ligjin dhe unë e kam stopuar. Ministria e Pushtetit Lokal edhe tani i përcjell krejt seancat, meqë posedon edhe pajisjen për përcjellje dhe se kjo përcjellje është obligative për pushtetin lokal. Prej vitit 2014-2015 të gjitha vendimet e marra shkojnë te Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kjo ministri i shpërndan në ministri përkatëse, varësisht prej natyrës dhe llojit të vendimit psh. Ministrisë së Financave ose ndonjë Ministrie tjetër përkatëse. Andaj çdo vendim që merret në Kuvendin e Komunës kontrollohet nga Ministria përkatëse.

Të gjitha seancat e mbajtura te Kuvendit Komunal janë të incizuara dhe për këtë ekziston materiali faktik, ku këtë material e posedon edhe Ministria e Pushtetit Lokal dhe nëse dikush dyshon në ndonjë falsifikim, ekziston mundësia me i shiku incizimet e seancave. Inicimi i Planit Zhvillimor Komunal është bërë nga Drejtoria kompetente, e që në këtë rast drejtoria kompetente ka qenë Drejtoria e Urbanizmit, kurse nuk e di se kush ka qenë bartës i projektit, sepse çdo iniciativë bëhet nga drejtoritë përkatëse të KK-së të cilat janë gjithsejtë 12 drejtori. Për Planin Zhvillimor Komunal, Kuvendi Komunal ka nxjerr edhe vendim për shqyrtim publik dhe seancat e KK-së janë mbajtur ashtu siç i ka proceduar pikat e rendit të ditës secila drejtori, kurse sa i përket vendimit të cilin ma prezanton i dëmtuari 01 nr.25 i dt. 09.03.2017 për

2019:233146

shqyrtimin publik të Projekt Planit Zhvillimor Komunal për periudhën 2017-2025 sigurisht e kemi marrë këtë vendim në seancën e KK-së

Vendimet e Kuvendit pas votimit të tyre në Kuvend dërgohen në Ministrinë e Pushtetit Lokal, e pastaj kjo ministri i shpërndan vendimet nëpër Ministritë përkatëse dhe brenda 15 dite, e ka për detyrë ministria përkatëse me e kthye përgjigjen, se vendimi a është i ligjshëm apo jo, e nëse Ministritë përkatëse nuk kthejnë kurrfarë përgjigjeje, atëherë ne konsiderojmë që vendimet janë të ligjshme dhe neve na jepet mundësia të vazhdojmë implementimin e atyre vendimeve, ku për këtë edhe vetë drejtoritë interesohen se a janë kthyer vendimet nga ministritë përkatëse apo jo, me qëllim të procedimit të tyre të mëtutjeshëm.

Drejtori përkatës i secilës drejtori i kompleton pikat e rendit të ditës, i bëjnë te personeli teknik i zyrës së kryesuesit të kuvendit, e pastaj kryesuesi i Kuvendit së bashku me kryetarin e Komunës i shqyrton pikat e rendit dhe fillimisht ia dorëzon Komitetit për politik dhe financa dhe pasi komiteti të jep pëlqimin, atëherë kalon në kuvend për shqyrtim. I akuzuari F.G. asnjëherë nuk ka ndikuar që vendimet e kthyera nga Ministritë përkatëse si të kundërligjshme të mos rishqyrtohen nga Kuvendi Komunal.

Për peticionet e paraqitura nga qytetaret për PZHK-në, ka qenë i formuar një komision i përbashkët nga të gjitha drejtoritë e Kuvendit Komunal dhe ai komision ka qenë kompetentë për shqyrtimin e peticioneve, i cili ka qenë komision profesional dhe vërejtjet e tyre janë inkorporuar në Kuvend, ku secili anëtar i kuvendit ka pasur të drejtën me debatuar lidhur me peticionet. Pra shqyrtimin e peticioneve e kanë bërë anëtarët e komisionit profesional.

Dëshmitari më tutje deklaron se çdo mbledhje e seancës së kuvendit monitorohet drejtpërsëdrejti apo live nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ku edhe seanca në të cilën është aprovuar PZHK-ja është monitoruar nga kjo ministri. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, të gjitha vendimet e marra në seancat e kuvendit ia dërgon ministrive përkatëse dhe Ministria e Mjedisit apo Planifikimit Hapësinor ka shikuar se vendimi i marr në Kuvend a ka qenë në rregull apo jo, se ajo është Ministri Profesionale.

Në vazhdim dëshmitari deklaron: seanca e parë për aprovimin e planit Zhvillimor Komunal është ftuar për datën 18.09.2017, mirëpo në ketë datë nuk është votuar Plani Zhvillimor Komunal, për shkak se paraprakisht një vendim e ka lëshuar Ministria e Mjedisit Hapësinorë që e pezullon pëlqimin për miratimin e PZHK-së, dhe se ky vendim personalisht nuk më është dhënë mua, por lidhur me këtë janë njoftuar të gjithë mediat dhe njerëzit e caktuar, dhe kjo pikë është shtyrë për datën 21.09.2017 me propozimin e Kryetarit të Komunës, ku disa anëtar të kuvendit kanë qenë për me mbajt mbledhjen e kuvendit kurse disa tjerë kanë qenë që të mos

2019:233146

procedohet plani Zhvillimor Komunal dhe me propozimin e kryetarit të komunës kjo pikë është shtyrë me datën e cekur më lartë me qëllim që ti kemi sqarimet nga Ministria e Planifikimit Hapësinor se për çka e ka pezulluar dhënien e pëlqimit për aprovimin e PZHK-së. Lidhur me këtë Kryetari i Komunës e ka autorizuar drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit F.G. që të shkon në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të pyet se për çka është pezulluar dhënia e pëlqimit. Në realitet me dt. 15.09.2018 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kishte marr vendim që të pezullohet dhënia e pëlqimit për aprovimin e PZHK-së dhe kur është caktuar seanca për dt. 18.09.2017, atëherë kemi kuptuar që ekziston një vendim i tillë e që dëshmitari thekson se unë personalisht nuk e kam ditur, e as kryetari i komunës nuk e kishte ditur, por e kishin ditur disa anëtar të kuvendit dhe kur unë dhe kryetari i komunës kemi kuptuar që ekziston një vendim i tillë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, atëherë e kemi shtyrë mbledhjen e kuvendit për dt. 21.09.2017.

Pas pranimit të vendimit mbi shfuqizimin e vendimit nr. 4510-2/17 të dt. 15.09.2017 për pezullimin e dhënies së pëlqimit për miratim të planit Zhvillimor Komunal për periudhën 2017-2025, atëherë janë hapur dyert që Kuvendi Komunal të shqyrtoj Planin Zhvillimor Komunal për miratim, me dt. 21.09.2017 është mbajtur seanca e Kuvendit Komunal për aprovimin e planit Zhvillimor Komunal

Thekson se është non sens që anëtarët e Kuvendit ta kenë një vendim e Kryetari dhe Kryesuesi i kuvendit të mos e kenë, çka do të thotë se unë dhe në tërësi institucionet relevante e kemi poseduar këtë vendim të shfuqizimit të vendimit për pezullimin e dhënies së pëlqimit për miratim të planit, sepse pa një vendim të tillë nuk kemi pasur mundësi me miratuar Planin Zhvillimor Komunal.

Peticionet e qytetarëve nuk i kujtohet nëse i ka prezantuar drejtori i Urbanizmit – F.G., në kohën e mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit për miratimin e planit Zhvillimor Komunal.

Thekson se ditën kur është aprovuar plani Zhvillimor Komunal, 20 anëtarë kanë votuar pro, nuk ka pasur asnjë kundër, kurse 6 kanë abstenuar.

Me datë 21.09.2017, unë kam marrë pjesë në procesin e votimit të aprovimit të planit zhvillimor në Ferizaj, ku në këtë datë kanë marrë pjesë shumica e anëtarëve të kuvendit dhe secili anëtar i ka dhënë vërejtjet e veta lidhur me Planin Zhvillimor Komunal dhe për këtë ekziston edhe CD, ku çdo anëtarë i Kuvendit para mbledhjes për shqyrtimin e planit Zhvillimor Komunal ka poseduar nga një CD në të cilat ka qenë i përmbledhur tërë materiali për aprovimin e PZHK, me që ky plan ka qenë mjaft voluminoz rreth 300-500. Thekson se para aprovimit të Planit zhvillimor komunal në mbledhjen e kuvendit ka qenë një ekip profesionale, e cila e ka fituar tenderin nga Komuna për të na dhënë sqarime dhe për t'i ndihmuar drejtorisë

2019:233146

së urbanizimit në hartimin e projekt planit Zhvillimor Komunal. Por kjo ekip profesionale si është quajtur tani ka harruar.

Përveç kompanisë profesionale që e ka fituar tenderin për hartimin e draft projektit të PZHK-së të cilët në mbledhjen e kuvendit para aprovimit të planit e kanë sqaruar çështjen e këtij plani, në mënyrë të gjithmbarshme edhe drejtori i Urbanizmit – F.G. i ka dhënë sqarimet e tij, pasi rregull është së pari pikën e arsyeton drejtori i Drejtorisë, e pastaj hapet debati për anëtarë të Kuvendit që janë prezent.

Saktë nuk i kujtohet pasi ka kaluar kohë e gjatë, por kompania profesionale e cila e ka fituar tenderin për këtë Plan Zhvillimor Komunal në mënyrë të thukët e ka paraqitur çështjen e këtij plani duke përmendur edhe peticionet e qytetarëve.

Në bazë të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e kuvendit të dt. 21.09.2017, me dt. 25.09.2017 është përpiluar vendimi për aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal ku ka qenë i nënshkruar nga unë si kryesues.

Trupi gjykues dëshmitë e dëshmitarëve: P.A., S.R., H.O., A.B., L.Sh., S.B., B.M., I.M., B.I., H.M., M.I., I.B., L.Z., M.H. dhe I.M. i vlerësoi bashkërisht, meqë të gjithë këta dëshmitarë në dëshmitë e tyre të dhëna në shqyrtimin gjyqësor kanë theksuar se kanë qenë të caktuar në Komisionin për hartimin e PZHK-së dhe secili e ka përfaqësuar Drejtorinë në të cilën ka qenë duke punuar. Dëshmitarët gjatë dëshmisë së tyre në mënyrë kronologjike, në detaje kanë sqaruar procedurën e përpilimit të draftit të Planit Zhvillimor Komunal, ku detyrat e tyre kryesore kanë qenë që në mbledhjet e komisionit për hartimin e PZHK-së, ti prezantojnë të dhënat dhe ti japin propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet për drejtorinë përkatëse në të cilën kanë qenë duke punuar e të cilën e kanë përfaqësuar në këtë komision. Dëshmitari **S.B.** ka qenë edhe menaxher i projektit, kurse dëshmitari **P.A.** ka qenë në rolin e Ekspertit të GIS-it. Dëshmitarët gjatë dëshmisë së tyre kanë theksuar se në mbledhjet e këtij komisioni kanë shqyrtuar edhe peticionet e qytetarëve, ku në mesin e këtyre peticioneve kanë qenë edhe peticionet që kanë të bëjnë me rrugën "Astrit Bytyqi", por saktë nuk iu kujtohen se nga kush janë paraqitur këto peticione, por pothuajse të gjithë kanë deklaruar se si bazë, përkatësisht kriter për destinimin e kësaj rruge për ndërtim të lartë, është marrë arsyeshmëria, përkatësisht profesionalizmi siç është e shënuar në Raportin e shqyrtimit publik të dt. 30.05.2017 të cilin e kanë nënshkruar 17 anëtarë të komisionit të cilët kanë qenë përfaqësues të sektorëve (drejtorive) të Komunës dhe siç është shënuar në procesverbalin e mbledhjes së komisionit për rishqyrtimin e peticioneve të paraqitur nga qytetarët të datës 09.08.2017 të cilin procesverbal e

2019:233146

kanë nënshkruar 13 anëtarë të komisionit të cilët kanë marr pjesë në mbledhje, në të cilin thuhet:

"Komisioni pasi rishqyrtoj kërkesat tuaja është i mendimit se në ketë rrugë, e cila tash pas lidhjes së saj me rrugën Ahmet Kaqiku dhe me magjistralen Prishtinë Shkup, ka fituar në peshë si rrugë tepër e rëndësishme, në të cilën mund të zhvillohet biznesi dhe të rritet qmimi i tokës.

Një arsye tjetër është : se të njëjtin kategorizim (destinim) e kemi paraparë edhe në rrugët e kategorisë së njëjtë sië është: Rr."Vëllezërit Gërvalla", rr. "Rexhep Bislimi",rr."Driton Islami", rr."Kadri Zeka", rr."Epopeja e Jezercit",rr," Zenel Hajdini", rr,"Enver Topalli" etj. të cilat për nga rëndësia nuk kanë peshë më të madhe se sa rruga "Astrit Bytyqi".

Andaj ne i kemi refuzuar (kundër)ose aprovuar(pro) kërkesat tuaja, por në seancën e Kuvendit, kur të aprovohet PZHK, do ta njoftojmë kuvendin me kërkesat e juaja, sepse Kuvendi është organi që vendos për versionin përfundimtar.

Në shqyrtimet gjyqësore gjatë marrjes në pyetje të këtyre dëshmitarëve, pas leximit të kësaj pjese të shënuar më lartë nga ana e të akuzuarit, pothuajse të gjithë këta dëshmitarë kanë konfirmuar se kjo qe u lexua ka qenë e saktë.

Gjithashtu në pyetjen që iu është parashtruar dëshmitarëve se a ju ka thënë ndonjëherë i akuzuari që të veprojnë kështu ose ashtu, përkatësisht a ka ndikuar i akuzuari te këta dëshmitarë në marrjen e vendimit gjatë mbledhjes së komisionit, që të gjithë dëshmitarët kanë deklaruar se kanë qenë plotësisht të pavarur dhe nuk kanë qenë të ndikuar nga i akuzuari.

Andaj dëshmive të këtyre dëshmitarëve trupi gjykues iu shprehu besimin, meqë këto dëshmi janë identike në mes vete, në përputhshmëri me njëra tjetrën dhe përputhen edhe me mbrojtjen e të akuzuarit si dhe me provat materiale.

Trupi gjykues po ashtu me kujdes vlerësoi edhe dëshmitë e dëshmitarëve: A.I., B.A., E.A. dhe A.R., ku nga përmbajtja e këtyre dëshmive trupi gjykues ka analizuar mënyrën e paraqitjes së nënshkrimeve të këtyre dëshmitarëve në listën e ofruar për nënshkrime dhe ka konstatuar se dëshmitari **A.I.** përveç tij në listën e nënshkrimeve kanë qenë edhe anëtarët e familjes së tij dhe atë: M.I., I.I. dhe M.I. të cilët kanë nënshkruar për ndërtim të lartë, kurse sa i përket banorëve të rrugëve të tjera dhe të rrugicave të rrugës "Astrit Bytyqi", dëshmitari nuk ka njohuri se këta banorë a kanë nënshkruar në atë peticion.

2019:233146

Gjatë vlerësimit ë këtyre dëshmive trupi gjykues ka konstatuar se dëshmitarët: **B.A.** dhe **E.A.** janë vëllezër të cilët jetojnë në rrugën "Astrit Bytyqi" dhe që të dy këta dëshmitarë e kanë nënshkruar peticionin e ofruar që ka qenë kundër ndërtimit të lartë, e që pastaj i kanë tërhequr nënshkrimet e tyre, me arsyetimin se pasurinë që e kanë pasur në emër të tyre, e kanë bartur në emër të fëmijëve me qëllim që fëmijët e tyre në të ardhmen vetë të vendosin se a janë për ndërtim të lartë apo të ulët dhe kanë sqaruar se vendimin për tërheqjen e nënshkrimit e kanë marrë vetë pa imponimin e askujt.

Sa i përket vlerësimit të dëshmisë së dëshmitarit A.R. trupi gjykues i ka besuar deklaratës së tij i cili ka theksuar se atij gjatë vitit 2017 nuk iu është ofruar ndonjë peticion për të nënshkruar dhe se nënshkrimi i dhënë në emër të tij, nuk është i tij, por në emër të tij ka mundur me nënshkruar ndonjë i afërt i tij, përkatësisht prindi i tij sepse vetëm ai i ka ditur të dhënat personale të tij e askush tjetër dhe ka sqaruar se gjatë bisedave që i ka zhvilluar me prindin janë dakorduar që nëse vije deri te lejimi i ndërtimit të lartë, ta japin pronën për ndërtim të lartë.

Trupi gjykues gjithashtu me kujdes vlerësoi edhe dëshmitë e dëshmitarëve: F.L., F.I. dhe B.A., të cilët në dëshmitë e tyre të dhëna në shqyrtimin gjyqësor sqarojnë mënyrën se si i kanë mbledhur nënshkrimet për zonën e 8-të, ku dëshmitari **F.L.** ka sqaruar se si peticionin për ndërtim të lartë për ketë zone e ka nënshkruar ai dhe bashkëshortja e tij, kurse dëshmitari **F.I.** sqaron se nënshkrimet për ndërtim të lartë për në zonën e 8-të, i ka mbledhur ai pasi listën për nënshkrime e ka marrë nga F.L. dhe pasi kanë nënshkruar personat të cilët ai i ka përmendur me emra, në mesin e tyre ka nënshkruar edhe B.A., e cila kishte qenë te prindërit e saj, regjistrin me emra të nënshkruar ia ka dorëzuar F.L., ndërsa dëshmitarja **B.A.** ka sqaruar se gjersa ka qenë tek prindërit e saj, fqinj i saj F.I. ia ka ofruar një dokument për ta nënshkruar, të cilin ajo pa e shikuar fare e ka nënshkruar.

Trupi gjykues me një kujdes shumë të veçantë ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit F.G.1., i cili ne atë kohë ka qenë Kryesues i Kuvendit dhe i njëjti është dëgjuar si dëshmitar me propozimin e palës së dëmtuar, i cili në dëshminë e tij në detaje ka sqaruar se nuk ka mundësi kurrfarë vendimi që të falsifikohet për arsye se të gjitha seancat e Kuvendit monitorohen drejtpërdrejt prej Ministrisë së Pushtetit Lokal, çka do të thotë se në kohën kur është mbajtur seanca e Kuvendit komunal, në të cilën është aprovuar PZHK-ja, ajo është përcjellë përmes monitorit nga ana e Ministrisë së Pushtetit lokal, meqë posedon edhe pajisjen për përcjellje dhe se kjo përcjellje është obligative për pushtetin lokal. Prej vitit 2014-2015 të

2019:233146

gjitha vendimet e marra shkojnë te Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kjo Ministri i shpërndan në Ministri përkatëse, varësisht prej natyrës dhe llojit të vendimit dhe brenda 15 dite e ka për detyrë Ministria përkatëse me e kthye përgjigjen, se vendimi a është i ligjshëm apo jo, e nëse Ministritë përkatëse nuk kthejnë kurrfarë përgjigjeje atëherë konsiderohet se vendimet janë të ligjshme dhe jepet mundësia e implementimit të atyre vendimeve. Andaj çdo vendim që merret në Kuvendin e Komunës kontrollohet nga Ministria përkatëse.

Për peticionet e paraqitura nga qytetaret për PZHK-në, ka qenë i formuar një komision i përbashkët nga të gjitha drejtoritë e Kuvendit Komunal dhe ai komision ka qenë kompetentë për shqyrtimin e peticioneve i cili ka qenë komision profesional dhe vërejtjet e tyre janë inkorporuar në Kuvend, ku secili anëtar i kuvendit ka pasur të drejtën me debatuar lidhur me peticionet. Sqaron faktin se ditën kur është aprovuar plani Zhvillimor Komunal, 20 anëtarë kanë votuar pro aprovimit, nuk ka pasur asnjë kundër, kurse 6 kanë abstenuar.
Në bazë të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e kuvendit të dt. 21.09.2017, me dt. 25.09.2017 është përpiluar vendimi për aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal, i cili është nënshkruar nga vetë kryesuesi.

Trupi gjykues dëshminë e këtij dëshmitari, i cili në atë kohë ka qenë kryesues i Kuvendit të komunës së Ferizajt, e vlerëson si dëshmi objektive, pasi që i njëjti realisht në detaje ka treguar procedurën e aprovimit të PZHK nga ana e kuvendit komunal për periudhën 2017-2025

Gjykata ka Refuzuar kërkesën e palëve te dëmtuara për dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar në kërkesën e paraqitur me shkrim të dt. 13.01.2020, e që gjithsejtë janë 13 dëshmitar, për arsye se trupi gjykues konsideron të pa nevojshme dhe të tepërt, sepse çështja në fjalë është e njohur në vija te përgjithshme dhe se dëgjimi i këtyre dëshmitarëve nuk është relevant në këtë çështje penale, por vetëm sa do të bënte zvarritjen e procedurës penale.

Ndërsa **gjykata ka aprovuar** kërkesën e palëve te dëmtuara që në cilësi të provave materiale te administrohen edhe dokumentet e lëshuara nga ana e organeve te administratës komunale gjate periudhës kohore 2016-2017, meqë në aktakuzë është përfshi kjo periudhë kohore e cila ka të bëjë konkretisht me datën 09.08.2017. Dokumentet e administruara, të propozuara nga palët e dëmtuara janë si në vijim:

2019:233146

- Ankesa e ushtruar nga I.H. e dt. 12.09.2017 pranë MMPH-së, me kërkesë për pezullimin e vendimit për dhënien e pëlqimit,
- Vendimi i MMPH-së me numër prot. 3270-2/17 të dt. 08.08.2017.
- Përgjigjja e MMPH-së, me numër prot.2442-2/19 e dt. 22.05.2019.
- Njoftimi i dt. 02.05.2019 i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit të Komunës së Ferizajt, me te cilën njoftohet i dëmtuari I.H. se DUM pranë Komunës se Ferizajt ka pranuar nga arkivi i komunës vendimin me numër 3270-2/17 te dt. 08.08.2017 me dt. 11.08.2017.
- Pjesët nga plani Zhvillimor Komunal përkatësisht faqet 36 dhe 37 të këtij plani te cilat flasin për shqyrtime publike të dt. 16.08.2016 të mbajtura në Sallën e Kuvendit te Komunës së Ferizajt si dhe lista e pjesëmarrësve e dt. 16.08.2016.
- Lista e pjesëmarrëseve në takimin për PZHK-në, e dt. 05.10.2016 e mbajtur në shkollën fillore "Astrit Bytyqi" në Ferizaj,
- Dokumentet me numër të protokollit 3963/17 të dt. 10.08.2017.
- Dokumenti me numër te protokollit 4329/17 i dt. 31.08.2017 me të cilin është kërkuar përsëri nga MMPH-ë për dhënien e pëlqimit për miratimin e PZHK-së. i cili është vazhdimësi e dokumentit të dt. 10.08.2017.
- Libri me kërkesa dhe peticione të qytetarëve të dorëzuar gjatë periudhës së shqyrtimit publik ndërmjet datës 25.03.2017 dhe 25.04.2017.
- Raporti shqyrtimit publik për PZHK-në të dt. 30.05.2017.
- Peticioni i dt. 14.04.2017 të dorëzuar nga ana e F.Sh..
- Peticioni i dorëzuar nga ana e A.K. peticion ky i cili është dorëzuar me dt. 26.04.2017.
- Kërkesa për rishqyrtimin e refuzimit të peticionit të palës së dëmtuar O.B. e parashtruar me dt. 01.06.2017 kundër raportit të shqyrtimit publik të dt. 30.05.2017.
- Dokumenti i emërtuar përgjigje në kërkesë me numër 04-016/01-0060302/17 të dt. 20.06.2017.
- Përgjigjja në peticionin e dorëzuar për A.K. e dt. 10.08.2017 me numër 899/17 në të cilin arsyetohet se ky peticion është pranuar dhe theksohet se peticioni është dorëzuar me dt. 25.04.2017.
- Përgjigjja në peticionin dorëzuar palës së dëmtuar O.B. me dt. 10.08.2017 me numër 903/17.
- Përgjigjja në peticionin dorëzuar zotëri I.Z. e dt. 10.08.2017 me numër 904/17.
- Përgjigjja në peticionin dorëzuar zotëri B.K. të dt. 10.08.2017 me numër 901/17.

2019:233146

- Procesverbali i dt. 09.08.2017 për shqyrtimin e peticioneve i cili është nënshkruar nga 13 anëtar në mesin e të cilëve edhe nga anëtaret S.R., H.O. dhe L.Sh..
- Vendimi me numër 01 nr.25 i dt. 09.03.2017 për shqyrtimin publik të PZHK-së të Ferizajt.
- Njoftimi i dt. 21.06.2017 i nxjerrë nga drejtori i urbanizmit F.G. për fillimin e shqyrtimit publik në afat prej 7 ditëve për draftin e vlerësimit strategjik mjedisor.
- Kërkesa për rishqyrtim të peticionit të dorëzuar nga O.B. me dt. 01.06.2017.
- Letra informuese e dorëzuar nga palët e dëmtuara me dt. 05.06.2017 për anëtarët e komisionit të shqyrtimit të raportit publik të dt. 30.05.2017.
- Letra informuese shtesë e dorëzuar nga banoret e rrugës "Astrit Bytyqi" për S.B. me dt. 16.06.2017 me numër të protokollit 04-016/01-0060302/17.
- Përgjigjja nga drejtori i Urbanizmit të dt. 03.08.2017 me numër 884/17 me të cilën njofton palën e dëmtuar I.H. se qëndron prapa përgjigjes të datës 20.06.2017 me të cilën ishte refuzuar kërkesa për rishqyrtim si jashtë afatit ligjor.
- Skica e rrugës "Astrit Bytyqi" .
- Dy skicat ku gjenden pronat e palëve të dëmtuara B.H. dhe I.H. të rrethuara nga parcela .....
- Përgjigjja e MMPH-së me numër të protokollit 2841-2/17 të dt. 16.06.2017.
- Njoftimi i drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit në Ferizaj i dt.06.04.2019 me të cilin njoftohet pala e dëmtuar I.H. se në çoftë se një zonë e caktuar është paraparë për ndërtim të lartë, atëherë në atë zonë nuk do të bëhet banimi individual por vetëm kolektivë.
- Përgjigja në kërkesë të lëshuar nga S.B. me dt. 15.01.2018 me të cilën pala e dëmtuar I.H. njoftohet se në ngastrën kadastrale ku gjendet shtëpia e tij parashihet banim kolektiv me afarizëm.
- Peticioni i personit me emrin E.S. i dorëzuar me dt. 24.04.2017.
- Aktgjykimi me numër Anr.1674/2017 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Administrime i dt. 09.10.2019.
- Video incizimi nga Seanca e Kuvendit Komunal të Ferizajt e dt. 21.09.2017 e nxjerr nga "RTV Tema" ku edhe është miratuar Plani Zhvillimor Komunal.
- Vendimi i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatësisht departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Vendimi nr. 97/16 i dt. 15.03.2016, i marr nga Kryetari i Komunës së Ferizajt.
- Vendimi nr. 25 të dt. 09.03.2017 i Kuvendit Komunal për Shqyrtimin Publik të Projekt Planit Zhvillimor Komunal të Ferizajt për periudhën 2017-2025.

2019:233146

- Vendimi i Ministrisë së Planifikimit Hapësinor me numër të referencës 17/3688/1-552 DMMU i dt. 25.08.2016 i nënshkruar nga Ministri i kësaj Ministrie – F.Sh.
- Peticioni i O.B..
- Vendimi për dhënien e pëlqimit për miratim te planit Zhvillimor Komunal për vitin 2017-2025 nga MMPH me numër 4323-2/17 i dt. 04.09.2017.

Trupi gjykues vlerëson se të gjitha këto prova materiale janë prova të besueshme dhe të pakontestueshme, meqë janë nxjerrë nga organet kompetente të administratës komunale gjatë procedurës së hartimit të planit Zhvillimor Komunal, por këto prova nuk ndriçojnë ndonjë aspekt subjektiv të kësaj çështje penale, meqë aktakuza ka të bëjë pikërisht me datën **09.08.2017** kur është mbajtur mbledhja e Komisionit për shqyrtimin e Planit Zhvillimor Komunal, këtë procesverbal të këtij komisioni gjykata do ta trajton me përkushtim maksimal, kurse trajtimi i provave tjera materiale të cekura më lartë të propozuara nga prokurori dhe nga palët e dëmtuara sipas vlerësimit të gjykatës janë irelevante dhe e tepërt.

Andaj, nga kjo arsye në mesin e këtyre provave materiale gjykata vlerëson të nevojshëm analizimin e Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për shqyrtimin e Planit Zhvillimor Komunal të dt. 09.08.2017 për shqyrtimin e peticioneve i cili është edhe objekt i kësaj aktakuze.

Nga ky procesverbal konstatohet se Komisioni për shqyrtimin e ankesave (peticioneve) në përbërje prej 13 anëtarëve me dt. 09.08.2017 është mbledhur duke respektuar vendimin e Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor (MMPH) nr.prot.3270-2/17 të dt.08.08.2017 me qëllim të rishqyrtimit të peticioneve të paraqitura nga qytetarët .

Në ketë mbledhje, me rekomandim të MMPH janë rishqyrtuar 7 peticione të paraqitura nga qytetarët, por ne do ti elaborojmë vetëm dy peticione që kanë të bëjnë me rrugën "Astrit Bytyqi" e cila edhe është objekt i kësaj akuze dhe ate:

1. Peticioni nr. 04-016/01-0040725/17, të dorëzuar nga O.B. me dt. 25.04.2017, ku nënshkrues të këtij peticioni janë gjithsejtë 58 qytetar, ndërkohë pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesave, tre qytetar i kanë tërhequr nënshkrimet e tyre. Qytetarët e nënshkruar në ketë peticion kanë kërkuar që rruga "Astrit Bytyqi" të mbetet banim individual ashtu siç është paraparë me planin rregullues urban të vitit 2009, pra që mos të parashihet ndërtimi i lartë dhe

2019:233146

2. Peticioni nr.04-016/01-0041031/17 të nënshkruar nga një numër i qytetarëve të dorëzuar nga A.K. me dt.25.04.2017, të cilët kanë kërkuar që në këtë rrugë të parashihet banim kolektiv me afarizëm, përkatësisht ndërtimi i lartë dhe numri i atyre që kanë kërkuar këtë destinim është 159.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave, peticionin e parë nr.04-016/01-0040725/17, të dorëzuar nga O.B. e ka Refuzuar, kurse peticionin e dytë nr. 04-016/01-0041031/17 të dorëzuar nga A.K. e ka aprovuar, mirëpo në të dy rastet, komisioni e ka dhënë arsyetimin e njëjtë siç vijon:

" *Komisioni pasi rishqyrtoj kërkesat tuaja është i mendimit se në ketë rrugë, e cila tash pas lidhjes së saj me rrugën Ahmet Kaqiku dhe me magjistralen Prishtinë Shkup, ka fituar në peshë si rrugë tepër e rëndësishme, në të cilën mund të zhvillohet biznesi dhe të rritet çmimi i tokës.*

Një arsye tjetër është: se të njëjtin kategorizim (destinim) e kemi paraparë edhe në rrugët e kategorisë së njëjtë siç është: Rr." Vëllezërot Gërvalla",rr." Rexhep Bislimi",rr." Driton Islami", rr."Kadri Zeka",rr." Epopeja e Jezercit",rr," Zenel Hajdini",rr," Enver Topalli" etj. të cilat për nga rëndësia nuk kanë peshë më të madhe se sa rruga "Astrit Bytyqi".

Andaj, ne i kemi refuzuar (është fjala për peticionin e parë) ose aprovuar kërkesat tuaja,(është fjala për peticionin e dytë) por në seancën e Kuvendit Komunal, kur të aprovohet PZHK, do ta njoftojmë kuvendin me kërkesat e juaja, sepse Kuvendi është organi që vendos për versionin përfundimtar.

Nga kjo shihet çartë se Komisioni për hartimin e projektit të Planit Zhvillimor Komunal, si kriter që e ka marr për bazë që rruga "Astrit Bytyqi" të parashihet për ndërtim të lartë, nuk kanë qenë peticionet e paraqitura nga qytetarët, por për bazë më tepër është marrë arsyeshmëria, përkatësisht profesionalizmi siç u shënua tani më lartë, të cilat arsye janë të shënuara edhe në procesverbalin e mbledhjes së komisionit të dt. 09.08.2017

Për çështjen e peticioneve dhe të ankesave të paraqitura nga qytetarët trupi gjykues ka analizuar dispozitat e udhëzimit administrativ 05/2014, ku në nenin 11 të këtij udhëzimi në mënyrë decidive thuhet: "*nëse autoriteti i planifikimit hapësinor gjate fazës së shqyrtimit publik pranon peticion nga pronarët e pa kënaqur te tokave dhe pronave te ndërtuara te cilët konsiderojnë se është bërë shkelje e të drejtës apo interesit te tyre përmes ndryshimit te destinimit te shfrytëzimit te tokave te tyre me draftin e dokumentit të planifikimit hapësinorë shqyrton peticionin dhe jep përgjigje te argumentuar ne kërkesat e tyre".*

2019:233146

Pra në asnjë dispozitë ligjore të këtij udhëzimi administrativ nuk thuhet se Komuna në rastin konkret duhet të vepron në bazë te kërkesave dhe peticioneve të qytetarëve. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni i përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha drejtorive komunale, e ka përgatitur draftin e Planit Zhvillimor Komunal në formë të propozimit, se në bazë të Ligjit mbi planifikimin hapësinor dhe Ligjit mbi administrimin e pushtetit lokal, i vetmi organ që merr vendim për miratimin e Planit urbanistik është Kuvendi komunal, i cili edhe e ka aprovuar këtë plan pa asnjë votë kundër.

Trupi gjykues me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, në kuadrin e provave materiale ka bërë edhe **shikimin e CD-së, në të cilën është incizuar mbledhja e Kuvendit Komunal e mbajtur me dt. 21.09.2017, në të cilën mbledhje është aprovuar Plani Zhvillimor Komunal për periudhën kohore 2017-2025.**

Gjatë shikimit te CD-se, trupi gjykues konstaton se mbledhjen e Kuvendit Komunal të dt. 21.09.2017, e ka hapur kryesuesi i kuvendit F.G.1., i cili pasi ka konstatuar numrin e mjaftueshëm te këshilltareve në atë mbledhje ka lexuar rendin e ditës, ku një ndër pikat e rendit të ditës ka qenë edhe aprovimi i planit Zhvillimor Komunal për periudhën kohore 2017-2025. Kryesuesi i kuvendit e ka hapur debatin, ku në mbledhje kane diskutuar drejtori i Urbanizmit, Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, dhe një numër i konsiderueshëm i këshilltareve komunal dhe ne fund pasi janë shtjerrë diskutimet kryesuesi i Kuvendit, Planin Zhvillimor Komunal për periudhën e cekur me lart e ka qitur ne votim dhe nga video incizimi shihet se pro aprovimit te PZHK-së, kanë qenë 20 këshilltar, kundër aprovimit te këtij plani nuk ka qene asnjë kurse 6 këshilltar kane abstenuar, dhe është konstatuar se Plani Zhvillimor Komunal për periudhën 2017-2025, është aprovuar me shumicën e këshilltarëve komunal.

Andaj, trupi gjykues pasi vlerësoi dëshmitë e të dëmtuarve: I.H., B.H. dhe O.B., dëshmitë e dëshmitarëve: P.A., S.R., H.O., A.B., L.Sh., S.B., B.M., I.M., B.I., H.M., M.I., I.B., L.Z., M.H., I.M., A.I., B.A., E.A., A.R., F.L., F.I., B.A. dhe dëshminë e dëshmitarit F.G.1. si dhe mbrojtjen e të akuzuarit konstatoi se nuk është arritur që të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar se në veprimet e të akuzuarit F.G. qëndrojnë elementet e veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për të cilën tani akuzohet, meqë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarr ndonjë veprim në drejtim të kryerjes së kësaj vepre penale. Kjo nuk është vërtetuar as nga **provat materiale** të administruara në shqyrtimin gjyqësor të propozuara nga prokurori i shtetit dhe nga palët e tjera në procedurë.

2019:233146

Analiza e ligjit material, dispozitivit të akuzës, fjalës përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe konkludimet e gjykatës.

Trupi gjykues konsideron të nevojshme të bëjë një analizë të veprës penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së,** ku sipas kësaj dispozite kjo vepër penale kryhet atëherë kur:

" *personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ase që t'i shkaktoj dëm personit tjetër ose që seriozisht t' shkelë të drejtat e personit tjetër."*

Sipas kësaj dispozite, veprime të kryerjes së kësaj vepre penale janë: shfrytëzimi i pozitës zyrtare ose autorizimit zyrtar, tejkalimi i autorizimit dhe moskryerja e detyrave zyrtare. *K*eqpërdorimi i pozitës ose i autoritetit zyrtar është vepër penale vetëm kur bëhet me qëllim të sjelljes së dobisë apo shkaktimit të dëmit, pra vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, e cila përfshin edhe dijeninë e kryerësit se po e shfrytëzon pozitën e vet zyrtare, po tejkalon kompetencat e veta, ose nuk e kryen detyrën e vet, si dhe faktin se me këtë ai përfiton dobi pasurore për vete apo për tjetrin ose i shkakton dëm tjetrit.
Pretendimi i prokurorit të shtetit se në rastin konkret në veprimet e të akuzuarit F.G. qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohet sipas bindjes së trupit gjykues është hipotetik, i pa bazuar dhe i pa vërtetuar me prova. Kjo për faktin se prokurori i shtetit në pjesën më të madhe të fjalës së tij përfundimtare, ka paraqitur veprimet e palëve procedurale të cilat nuk kanë qenë kontestuese në mes tyre, kurse nuk ka paraqitur asnjë të dhënë bindëse në drejtim të kryerjes së kësaj vepre penale nga ana e të akuzuarit.

Në kontest të kësaj edhe vet përshkrimi i dispozitivit të akuzës që nga fillimi ka qenë i pa çartë dhe konfuz, ku edhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor ka mbetur ashtu siç ka qenë i përshkruar nga prokurori I shtetit, si në vijim:

"I pandehuri F.G. *me datë 09.08.2017, në Ferizaj, në cilësinë e personit zyrtar Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit të komunës Ferizaj, dhe si person përgjegjës i komisionit për shqyrtimin e planit Zhvillimor Komunal për rrugën "Astrit Bytyqi", në Ferizaj, ka tejkaluar kompetencat e tij zyrtare duke i'a shkelur seriozisht të drejtat e personave tjerë të dëmtuarve: I.H., B.H. dhe O.B., në atë mënyre nuk i kanë verifikuar nënshkrimet në peticionin e qytetarëve të cilët kanë rezultuar të jenë të falsifikuar edhe pse i pandehuri më pare ka qenë*

2019:233146

në dijeni se nënshkrimet në peticione janë të falsifikuara dhe si pasoj është lejuar që Rr. "Astrit Bytyqi" të mbetet banim kolektiv, edhe pse qytetarët e kësaj rruge kanë qene për banim individual, ndërsa si rezultat i peticionit të falsifikuar kuvendi komunal ka aprovuar planin urbanistik "

Shkojmë radhazi, konstatimi i prokurorit se *"i akuzuari si* ***person përgjegjës*** *i komisionit për shqyrtimin e planit Zhvillimor Komunal për rrugën "Astrit Bytyqi" në Ferizaj",* ky konstatim sipas trupit gjykues është i pa qëndrueshëm për arsye se: në bazë të Ligjit mbi qeverisjen lokale dhe Ligjit mbi planifikimin hapësinor, për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, Kryetari i Komunës me vendimin nr.97/16 të dt.15.03.2016, ka formuar Komitetin drejtues, në të cilin komitet përveç kryetarit të Komunës, nënkryetarit dhe kryesuesit marrin pjesë edhe të gjithë drejtorët e drejtorive komunale, duke përfshirë edhe të akuzuarin si drejtorë i drejtorisë së urbanizmit, ku në këtë vendim të kryetarit janë të përcaktuara edhe detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit drejtues të planifikimit.

Pastaj me vendimin e Kryetarit të komunës nr.95/16 të dt.15.03.2016 janë formuar grupet tematike –sektoriale punuese të planifikimit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe hartës zonale të Komunës. Se çka është grupi punues ose komisioni e definon Ligji i Procedurës Administrative, ku në nenin 37 të këtij Ligji thuhet: *organi publik kolegjial është një grup personash të caktuar sipas ligjit që përfshihen në një procedurë administrative me kompetenca vendimmarrëse apo këshillimore,* ku në rastin konkret roli i këtij komisioni ka qenë këshillimor nga fakti se PZHK-në, e aprovon Kuvendi i Komunës, e jo Drejtoria e urbanizmit e as drejtori i kësaj drejtorie, pra kemi të bëjmë me një akt (vendim)të një organi kolektiv. Vendimin për aprovimin e PZHK e ka marr Kuvendi me dt. 21.09.2017 dhe deri në marrjen e këtij vendimi, Kuvendit iu është ofruar edhe propozimi i Komisionit për hartimin e PZHK të përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha drejtorive të komunës i cili ka paraparë që rruga "Astri Bytyqi", të jetë ndërtim i lartë, çka do të thotë se ky ka qenë propozim profesional i komisionit, e jo i drejtorit të urbanizmit siç pretendon prokurori, ku kjo është konstatuar edhe në procesverbalin e dt. 09.08.2017 i nënshkruar nga 13 anëtarët e komisionit. Andaj, nga arsyet e cekura trupi gjykues vlerëson se i akuzuari nuk mundë të jetë person përgjegjës i një organi kolegjial siç është komisioni i cekur më lartë, meqë vendimet në ketë komision merren me shumicën e votave, e jo nga një individ, përkatësisht nga i akuzuari siç pretendon prokurori i shtetit.

2019:233146

Më tutje në vazhdim të dispozitivit të akuzës thuhet *"i ka tejkaluar kompetencat e tij zyrtare"*, ky pretendim i prokurorit është i pa qëndrueshëm dhe i pa qartë, sepse nuk ka specifikuar se çfarë kompetenca ka tejkaluar, dhe gjate shqyrtimit gjyqësor trupi gjykues me asnjë provë nuk ka vërtetuar se i akuzuari ka tejkaluar kompetencat, duke ia shkelur seriozisht të drejtat e personave tjerë të dëmtuarve I.H., B.H. dhe O.B., meqë nga provat e administruara është vërtetuar se i akuzuari të gjitha veprimet që i ka ndërmarrë për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, kanë qenë në suazat e autorizimeve të tija zyrtare si drejtor i drejtorisë së urbanizmit dhe si anëtar i Komitetit drejtues të planifikimit dhe i grupeve tjera punuese. Prokurori gjithashtu nuk ka specifikuar se cilat të drejta i akuzuari iu ka shkel të dëmtuarve, me cilat dispozita ligjore janë konstatuar këto shkelje.

Pastaj dispozitivi i akuzës vazhdon : *nuk i ka verifikuar nënshkrimet në peticionin e qytetarëve të cilët kanë rezultuar se janë të falsifikuar*, por prokuroria nuk potencon se si është konstatuar që nënshkrimet janë të falsifikuara pa u kryer ndonjë ekspertizë nga institucionet e autorizuara përkatëse, përmes grafologjisë ose në ndonjë mënyrë tjetër nga ndonjë organ i autorizuar, aq më tepër kur tani prokuroria ka hequr dore nga akuza me te cilën ka qenë i ngarkuar A.K. për veprën penale të falsifikimit te dokumenteve. Prokurori nuk e ka cekë asnjë dispozitë ligjore, por as trupi gjykues nuk ka mundur me gjetë ndonjë dispozitë ligjore qe e obligon Drejtorinë e urbanizmit, përkatësisht drejtorin e kësaj drejtorie me bërë verifikimin e nënshkrimeve të nënshkruesve të peticionit se a janë të falsifikuara. Peticionet, përkatësisht kërkesat shqyrtohen ne bazë të Ligjit për planifikimin hapësinor, por në detaje i rregullon udhëzimi administrative nr. 5/2014, mirëpo në asnjë dispozitë ligjore nuk ceket se organi që pranon peticionin është i obliguar që të bëj verifikimin e nënshkrimeve të peticionit.

Pastaj në dispozitiv është shënuar se: *si pasoj është lejuar qe rruga "Astrit Bytyqi" të mbetet banim kolektiv edhe pse qytetarët e kësaj rruge kanë qenë për banim individual, ndërsa si rezultat i peticionit të falsifikuar Kuvendi ka aprovuar planin urbanistik.*

Trupi gjykues vlerëson se një pretendim i tillë i prokurorit është i pa bazë dhe i pa qëndrueshëm, sepse propozimi i Komisionit që rr. "Astrit Bytyqi" të jetë ndërtim i lartë nuk është bërë në bazë të peticioneve të paraqitura nga qytetarët, por në bazë të vlerësimit profesional të komisionit, se peticionet nuk kanë karakter obligativ dhe në asnjë dispozitë ligjore nuk thuhet se gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor organi është i obliguar që të vendos ashtu siç kërkojnë nënshkruesit e një peticioni, por nga dëshmitarët e shumtë që janë dëgjuar dhe nga provat materiale është konstatuar, se kriteri kryesor që është

2019:233146

marrë për bazë ka qenë arsyeshmeria dhe profesionalizmi, ku kjo është shënuar edhe në procesverbalin e dt. 09.08.2017 i cili procesverbal është i nënshkruar nga 13 anëtarë të komisionit, ku është konstatuar se:

"*Komisioni është i mendimit se në ketë rrugë, e cila tash pas lidhjes së saj me rrugën "Ahmet Kaqiku" dhe me magjistralen Prishtinë Shkup, ka fituar në peshë si rrugë tepër e rëndësishme, në të cilën mund të zhvillohet biznesi dhe të rritet çmimi i tokës.*

Një arsye tjetër, është se të njëjtin kategorizim (destinim) e kemi paraparë edhe me rrugët e kategorisë së njejtë siq është Rr. "Vëllezërot Gërvalla",rr." Rexhep Bislimi", rr." Driton Islami", rr." Kadri Zeka", rr." Epopeja e Jezercit", rr." Zenel Hajdini", rr." Enver Topalli" etj. të cilat për nga rëndësia nuk kanë peshë më të madhe se sa rruga "Astrit Bytyqi".

Në fund, në përgjigjen e komisionit thuhet: Aandaj, ne e kemi refuzuar kërkën tuaj, por në seancën e Kuvendit komunal, kur të aprovohet PZHK, do ta njoftojmë Kuvendin me kërkesat e juaja, sepse Kuvendi është organi që vendos për verzionin përfundimtar.

Nga këto arsye të cekura më lartë rezulton se Kuvendi nuk e ka aprovuar PZHK-në, si rezultat i peticionit të falsifikuar siç është përshkruar në dispozitiv të akuzës, se falsifikimi i nënshkrimeve nuk është vërtetuar me asnjë provë gjatë shqyrtimeve gjyqësore, por edhe propozimet e Komisionit që rruga "Astrit Bytyqi", të jetë ndërtim i lartë, nuk kanë qenë rezultat i peticioneve, pavarësisht asaj se janë refuzuar apo aprovuar nga komisioni, por propozimet e komisionit kanë qenë rezultat i vlerësimit profesional të komisionit siç është konstatuar në procesverbalin e dt.09.08.2017

Me dt. 21.09.2017 Kuvendi komunal ka aprovuar Planin Zhvillimor Komunal 2017-2025, ku si prove nga trupi gjykues është administruar CD-ja e incizimit të mbledhjes se Kuvendit dhe nga video incizimi është konstatuar se Kuvendi pasi është njoftuar nga drejtori i urbanizmit me tërë materialin e Planit Zhvillimor Komunal, në fund të seancës pro aprovimit te PZHK kanë qenë 20 këshilltar, kundër aprovimit te këtij plani nuk ka qenë asnjë, kurse 6 këshilltar kane abstenuar.

Prokurori i shtetit gjatë fjalës së tij përfundimtare në tërësi ka përshkruar rrjedhën e procedurës penale nga fillimi deri në përfundim të saj, duke përshkruar provat materiale për të cilat edhe vetë konstaton se nuk kanë qenë kontestuese, por shumica e provave materiale të administruara janë shkresa të komunikimit në mes drejtorisë së urbanizmit dhe Ministrisë së planifikimit hapësinor të cilat janë paraparë me Ligjin për Planifikimin Hapësinor. Në thelb

2019:233146

prokurori nuk ka arritur që të paraqes ndonjë provë të themeltë që do të bënte të besueshëm se i akuzuari është kryerës i veprës penale për të cilën akuzohet, por shumica e pretendimeve të tij kanë mbetur në suaza të supozimeve, pa arritur që ta tejkalojnë kufirin e dyshimit të arsyeshëm.

Trupi gjykues konstaton se nenet: 9, 11, 15,26 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor e rregullojnë në mënyrë obligative raportin në mes të Komunës dhe Ministrisë që nga momenti i marrjes së vendimit nga ana e Kuvendit për aprovimin e ndonjë dokumenti të planifikimit hapësinor, deri te aprovimi i tij, dhe trupi gjykues vlerëson se në procedurën e aprovimit të PZHK, janë respektuar të gjitha procedurat ligjore, për faktin se pa marrjen e pëlqimit nga ana e Ministrisë nuk ka mundur Kuvendi të aprovon Planin Zhvillimor Komunal, ku një gjë të tillë e ka bërë pas marrjes së pëlqimit nga Ministria dhe pas aprovimit të këtij dokumenti, Vendimi i Kuvendit sërish iu është nënshtruar vlerësimit ligjor nga ana e Ministrisë dhe tek pas këtij vlerësimi ky Vendim ka filluar të prodhoj efektet e tij.

Në rastin konkret edhe po të supozohet se nuk janë respektuar procedurat gjer te aprovimi i Planit Zhvillimor Komunal, respektivisht se janë shkelur ndonjë dispozitë ligjore e ndonjë ligji (P.sh .Ligjit mbi planifikimin hapësinor ose ndonjë ligji tjetër) ashtu siç pretendon prokurori, ky mosrespektim i procedurës nuk mund t'i atribuohet të akuzuarit si vepër penale, ngase siç është theksuar më lartë, keqpërdorimin e përcakton veprimi i caktuar dhe qëllimi i caktuar dhe çdo keqpërdorim nuk përbën vepër penale, duke qenë se kjo vepër penale kryhet vetëm kur keqpërdorimi i pozitës ose i autoritetit zyrtar bëhet me qëllim të sjelljes së dobisë apo shkaktimit të dëmit apo shkeljes së të drejtave të personit tjetër, elemente këto që nuk janë argumentuar me provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore**.**

Trupi gjykues konstatoi se nga dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar nuk mund të nxirret ndonjë konkluzion relevant konkret që do të mbështeste ndonjë përfundim inkriminues për të akuzuarin, e po ashtu një përfundim i tillë nuk mundë të nxirret as nga provat materiale që janë shqyrtuar dhe vlerësuar në shqyrtimin gjyqësor, me që nuk është arritur që të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar, se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohet.

Prandaj pretendimi i prokurorit të shtetit të paraqitur në fjalën përfundimtare, se në rastin konkret në veprimet e te akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, sipas bindjes së trupit gjykues është hipotetik, i pa bazuar dhe i pa vërtetuar me prova.

2019:233146

Andaj nga e gjithë kjo që u theksua më lartë, e duke marrë parasysh faktin se Gjykata me rastin e vlerësimit dhe vendosjes, ka obligim ligjor që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, pra faktet që shkojnë në favor apo në disfavor të akuzuarit, e në veçanti duke u ndërlidhur me nenin 3 të KPPRK-së, parimin **e prezumimit të pafajësisë së të pandehurit** dhe parimin **"in dubio pro reo"** se të gjitha mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal, interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë në dëmë të akuzuarit, duhet të vërtetohen me siguri të plotë, përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm *(beyond reasonable doubt)* dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet të konsiderohen se nuk ekzistojnë, kurse për argumentet që janë në favor (*in favorem)* ndaj të akuzuarit, merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohej si e kundërt, dhe në këtë mënyrë lëvizja e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarin, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Prandaj, sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret me provat e propozuara dhe të zbatuara në shqyrtim gjyqësor, nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata në kuptim të nen. 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par.3 të KPPK-së gjykata ka udhëzuar të dëmtuarit: I.H., B.H. dhe O.B., që kërkesën pasurore - juridike mund ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nen. 454 par.1. të KPPK-së.

II.

Sa i përket pjesës së dytë të këtij aktgjykimi, përkatësisht pjesës së aktgjykimit refuzues, prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarit **A.K.**, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, meqë nga

2019:233146

provat e prezantuara në shqyrtimet gjyqësore, me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë.

Shpenzimet e procedurës penale konform nenit 454 par.1 të KPPK-së edhe për ketë pjesë të aktgjykimit bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Nga arsyet e lartcekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TE RENDA PKR.204/17 dt. 05.01.2021

Zyrtare Ligjore, **Kryetari i trupit gjykues,**

Lavdije Brahimi Aliu Sahit Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

2019:233146